



INSPEKTIMI DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I KOPSHTIT

(UDHËZUES PËR INSPEKTIMIN E PLOTË TË KOPSHTIT)

TIRANË, 2011

Botimi u përgatit nga:

- | | |
|--------------------|----------------------|
| 1. Pranvera Kamani | 7. Engjellushe Bregu |
| 2. Robert Gjedia | 8. Jonida Matohiti |
| 3. Bukurie Haxhia | 9. Felek Kraja |
| 4. Aurela Zisi | 10. Sabrie Madani |
| 5. Edlira Sina | 11. Ema Kasapi |
| 6. Ermioni Cekani | 12. Arta Remaçka |

Ky botim u konsultua dhe u mbështet nga ekspertët ndërkombëtarë të fushës së kurrikulës dhe të inspektimit, të ardhur në IKAP gjatë periudhës 2010-2011, në kuadër të programit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”.

1. Alexandru Crishan
2. Giseele Desseux
3. Alain Michel

1. Redaktimi shkencor Majlinda Xhamo
2. Redaktimi letrar Antoneta Ramaj

Falënderojmë për kontributin, idetë, sugjerimet e vlefshme që kanë dhënë në takimet e posaçme të punës për këtë udhëzues, specialistët e MASH-it, të IZHA-s , të DAR-it Tiranë, pedagogët e fushës së vlerësimit nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, drejtuese dhe mësuese të kopshteve në qytete dhe fshatra të ndryshme të vendit.

Ky botim u mbështet edhe nga UNICEF-i.

© Copyright: IKAP

PËRMBATJA

INSPEKTIMI DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I KOPSHTIT	7
FUSHA 1. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS	10
FUSHA 2. VEPRIMTARIA MËSIMORE-EDUKATIVE	27
FUSHA 3. MENAZHIMI I KOPSHTIT	41
FUSHA 4. KUJDESI NDAJ FËMIJËS NË KOPSHT	53
FUSHA 5. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE	68
FUSHA 6. BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI	75
FUSHA 7. VLERËSIMI	83
FJALORTH	90
BIBLIOGRAFIA	93
NË VEND TË MBYLLJES	94

Të nderuara mësuese dhe drejtuese të kopshteve,

Arsimi parashkollor është një hallkë e rëndësishme e sistemit arsimor parauniversitar. Ky cikël arsimor zbaton një kurrikulë të re, bazuar në standarde përmbajtjeje, standarde arritjeje, si dhe në programe studimi tërësisht të reformuara, të cilat synojnë ta integrojnë natyrshëm fëmijën në procesin e edukimit dhe të zhvillimit, duke e motivuar për të vijuar natyrshëm rrugën e gjatë të të nxënit.

Modele të shumta mësimore zbatohen në kopshtet tona. Ato mbështeten në traditat më të mira, por dhe në modele të suksesshme perëndimore, të cilat i kanë pasuruar përvojat pozitive të procesit mësimor në kopshte, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Projekti i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës po përfshin nga viti në vit të gjithë fëmijët 5-6 vjeçarë në kopshtet apo në klasat parapërgatitore pranë shkollave 9-vjeçare. Kjo është një përpjekje e madhe, që synon t'u garantojë shanse të barabarta të gjithë fëmijëve për të vijuar suksesshëm më tej shkollën.

Kopshtet po mbështeten dita-ditës me literaturë bashkëkohore shkencore, letrare dhe argëtuese, por edhe me mjete didaktike të përshtatshme për fëmijët.

Tashmë, jemi në fazën e sigurimit të cilësisë në kopsht. Kjo është një rrugë e gjatë, plot sfida dhe jeni ju, mësueset dhe drejtueset e kopshteve, që po e përballoni me sukses atë, duke e shndërruar kopshtin në një mjedis të dashur e tërheqës që ofron një shërbim cilësor për fëmijët.


Udhëzuesi "Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit" vjen për herë të parë tek ju, me tregues arsimorë të qartë e të matshëm, me instrumente vëzhgimi e vlerësimi, të cilat kanë si qëllim themelor, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së punës së mësueseve dhe drejtueseve të kopshtit.

Ky është një proces që kërkon kohë, përpjekje dhe angazhim profesional, por mbi gjithçka kërkon një kombinim të frytshëm të vlerësimit të brendshëm që ju do të zhvilloni vit pas viti në kopsht, me vlerësimin e jashtëm që zhvillohet nga institucionet e specializuara të MASH-it.

Gjej rastin që të përshëndes gjithë stafin e IKAP-it për punën serioze që ka nisur. Ky institucion i ri po bën përpjekjet e duhura për mbështetjen dhe rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor që ju ofroni.

Ju uroj të gjithave suksese dhe mbarësi!

MYQEREM TAJAJ
MINISTËR



INSPEKTIMI¹ DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I KOPSHTIT

Procesi i vlerësimit të brendshëm dhe ai i vlerësimit të jashtëm të kopshtit kërkon përdorimin e një metodologjie shkencore, të qartë, të besueshme dhe bashkëkohore, e cila siguron të dhëna reale dhe mundësi për të pasqyruar pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë që kopshti ka për të ofruar një shërbim arsimor cilësor, dhe në mënyrë të veçantë, nevojat për përmirësimin e tij në të ardhmen.

Nga ana tjetër, përdorimi i së njëjtës metodologjie dhe i të njëjtëve tregues, si nga ekipi i vlerësimit të brendshëm të kopshtit, por edhe nga ekipi i vlerësimit të jashtëm, (Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar) është një mënyrë që përaftron këto dy vlerësime që synojnë përmirësimin e punës së kopshtit, por edhe përcaktimin e nivelit të cilësisë dhe të meritave të saj. I rëndësishëm është qëllimi i IKAP-it për të zhvilluar në kopsht, hap pas hapi, kulturën e vlerësimit të brendshëm. Kjo është një rrugë profesionale dhe sfiduese që kërkon njohje dhe zotërim të standardeve profesionale dhe etike të vlerësimit, angazhim, dhe përgjegjësi të të gjithë personave të përfshirë në vlerësim, të ekipeve të vlerësimit të brendshëm, të autoriteteve dhe organizmave drejtues të kopshtit.

Po cilat janë elementet e metodologjisë së vlerësimit të brendshëm dhe të vlerësimit të jashtëm të kopshtit?

Fusha nënkupton një drejtim apo dimension themelor të veprimtarisë së kopshtit. Fusha lidhet drejtpërdrejt me gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit, qëllimet e arsimit, dokumentet kurrikulare. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vlerësimit:

- **Planifikimi i kurrikulës;**
- **Veprimtaria mësimore-edukative;**
- **Menazhimi i kopshtit;**
- **Kujdesi ndaj fëmijës;**
- **Zhvillimi i burimeve njerëzore;**
- **Bashkëpunimi dhe partneriteti;**
- **Vlerësimi.**

¹Inspektimi në këtë material nënkupton vlerësimin e jashtëm të kopshtit.

Nënfusha është një nëndarje, detajim dhe element i domosdoshëm që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar, për të cilën punon kopshti. Konkretisht, nëse një nga fushat e kopshtit është “Planifikimi i kurrikulës”, nëndarjet për të janë: “Kurrikula”, “Regjimi ditor”, “Planifikimi vjetor” etj. Këto detajime synojnë të identifikojnë se çfarë ndodh me planifikimin e kurrikulës së zbatuar në kopsht dhe të plotësojnë të gjitha elementet që ka kjo fushë. Këto nëndarje apo detajime konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh në kopsht. Pra, ato kryejnë dy funksione:

- a) zbërthejnë fushën në elemente organike dhe të domosdoshme për të,
- b) mundësojnë një njohje dhe vlerësim real të situatës në kopsht.

Treguesi është një fjali e matshme, pohuese që tregon si është dhe si duhet të jetë niveli i fushave. Nëpërmjet treguesve arrijmë të vlerësojmë sesi është kopshti i vetëvlerësuar dhe i inspektuar. Treguesi:

- hartohet për secilën nënfushë dhe mund të jetë një apo disa;
- është gjithnjë i matshëm, që do të thotë se lehtëson procesin e vetëvlerësimit dhe të inspektimit;
- paraqet pohime që cilësojnë fushën që do të vlerësohet.

P.sh.:

Nr.	Fusha	Nënfusha	TREGUESIT (shembuj)
I	Planifikimi i kurrikulës	Kurrikula	1. Në zbatimin e kurrikulës përzgjidhen veprimtari mësimore- edukative të përshtatshme për moshën dhe interesat e fëmijëve.
II	Veprimtaria mësimore-edukative	Regjimi ditor	1. Në përputhje me grupmoshën e fëmijëve, mjedisin dhe kohën që është në dispozicion, respektohen oraret e regjimit ditor, të përcaktuara në standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor.
III	Menazhimi i kopshtit	Plani vjetor i kopshtit	1. Kopshti ndërton veprimtarinë mësimore-edukative, duke u mbështetur në objektivat dhe rubrikat e planit vjetor.
IV	Kujdesi ndaj fëmijës	Siguria për jetën dhe shëndetin	1. Kopshti ka krijuar një mjedis fizik të brendshëm dhe të jashtëm, të organizuar në funksion të sigurisë së jetës dhe shëndetit të fëmijëve.

V	Bashkëpunimi dhe partneriteti	Marrëdhënia e kopshtit me prindërit.	1. Drejtoria e kopshtit dhe mësueset e grupeve i shohin prindërit si partnerë në realizimin e objektivave vjetore të kopshtit, duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me ta.
VI	Zhvillimi i burimeve njerëzore	Trajnimi dhe kualifikimi i stafit	1. Drejtoria e kopshtit identifikon vazhdimisht nevojat për trajnimin e stafit dhe bën përpjekje të vazhdueshme për realizimin e tyre, duke bashkëpunuar me MASH-in; DAR/ZA-në apo institucione të tjera që ofrojnë trajnime.
VII	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve	Vetëvlerësimi i kopshtit	1. Drejtoria e kopshtit dhe mësueset e grupeve realizojnë vazhdimisht vetëvlerësimin e veprimtarisë së kopshtit në të gjitha aspektet e tij.

Instrument i vëzhgimit² është një fjali që përcakton se si zbatohet, si zhvillohet apo në ç'gjendje paraqitet treguesi i synuar. Nëpërmjet instrumenteve/përshkruesve mblidhen informacione dhe të dhëna për plotësimin e treguesve nga kopshti.

Shkallë vlerësimi janë nivelet që përdoren për të vlerësuar kopshtin përmes fushave të tij. Nivelet e vlerësimit janë katër: *shumë mirë* që i takon numrit 1, *mirë* që i takon numrit 2, *mjaftueshëm* që i takon numrit 3 dhe *dobët* që i takon numrit 4. Skema me katër shkallë vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet që u bëhen institucioneve arsimore në vendet evropiane. Po ashtu, ky sistem me katër shkallë mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijë kopshti sipas treguesve.

Standardi i vlerësimit është përshkrimi i gjendjes së kopshtit për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të përmendura më lart. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave nga instrumentet e vëzhgimit dhe të vlerësimit që i bëhet secilit tregues, por dhe i të dhënave të siguruar nga metodologjia e zbatuar gjatë vetëvlerësimit apo inspektimit në përgjithësi. Vlerësimi përfundimtar për fushën bazohet gjithnjë në peshën dhe rëndësinë që ka zbatimi i secilit tregues në gjendjen e kopshtit.

2) Instrumenti i vëzhgimit është përshkrues i treguesit.

FUSHA I. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Arsimi parashkollor është hallka e parë e sistemit tonë arsimor parauniversitar, edhe pse jo pjesë e detyrueshme e tij. Kurrikula e zbatuar është tërësia e veprimtarive të organizuara nga kopshti, të cilat kanë për qëllim përmbushjen e synimeve të këtij cikli edukimi, siç përshkruhen në Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe në dokumentet zyrtare kurrikulare për këtë cikël. Në veprimtarinë e tij, kopshti i fëmijëve synon:

- 1. të zhvillojë personalitetin e fëmijës parashkollor dhe ta parapërgatisë atë për shkollë;*
- 2. të sigurojë për secilin fëmijë shanse të barabarta edukimi;*
- 3. të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme dhe të aftë të krijojë marrëdhënie me të tjerët;*
- 4. të zgjerojë përvojën, njohjen, aftësitë ndijore, aftësinë për të vepruar, folur, menduar dhe imagjinuar nëpërmjet ushtrimeve të vazhdueshme.*

Këto synime pasqyrohen në të gjitha dokumentet që përbëjnë një kurrikulë të arsimit parashkollor, të cilat duhet të sigurojnë arsimim cilësor dhe të barabartë të të gjithë fëmijëve parashkollorë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, pozita shoqërore apo dhe ndryshime të tjera.

Qëllimi i kurrikulës është nxitja e fëmijëve për t'u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e të mësuarit, për të marrë pjesë në veprimtari të larmishme, për të përdorur materiale të përshtatshme zhvillimi, për të përmbushur interesat vetjake në jetën e përbashkët komunitare etj.

Kurrikula e arsimit parashkollor ka të bëjë me atë se *çfarë* duhet të dinë dhe *të jenë në gjendje* të bëjnë fëmijët parashkollorë, me ç'vlera qytetarie duhen pajisur, si të bashkëjetojnë me të tjerët paqësisht dhe të përfitojnë nga të drejtat që kanë për edukim dhe formim cilësor. Pra, me fjalë të tjera, në kurrikul gjejmë prioritetet për edukimin e këtij brezi fëmijësh, mënyrat si drejtohet të nxënë, sjellja dhe zhvillimi i tyre tërësor, burimet, materialet, pajisjet dhe mjetet didaktike, rolin e prindërve si partnerë në edukim, si dhe mënyrat e vlerësimit të arritjeve të fëmijëve në të gjitha fushat e zhvillimit.

Një kurrikul mund të jetë e shkruar mirë, por suksesi i saj varet nga mënyra sesi zbatohet. Roli i mësueses në zbatimin e kurrikulës është i rëndësishëm, pasi ai është personi i vetëm që zbaton kurrikulën e shkruar. Një kurrikulë që njeh dhe vlerëson nivelet e ndryshme të zhvillimit, të rritjes dhe të interesave të fëmijëve mund të jetë e përshtatshme dhe efektive për t'u zbatuar në institucionet parashkollore.

Kurrikula e zbatuar duhet të mbështetet në parimet e mëposhtme:

- Të parashikojë edukimin e fëmijëve në të gjitha fushat e zhvillimit;
- Të përmbajë njohuritë e duhura, të vlefshme dhe të kuptimshme për t'u zotëruar nga fëmijët e kësaj moshe;

- T'i shërbejë një mjedisi multikulturor;
- Të ketë pritshmëri dhe rezultate të qarta për çdo fëmijë;
- Të jetë lehtësisht e përshtatshme nga mësuesja, në mjedisin ku zhvillohet veprimtaria mësimore- edukative.

Një kurrikul e zbatuar, cilësore dhe e suksesshme në kopshte është atëherë kur në të zhvillohen të gjitha **nënfushat** e saj, si:

- I. Zbatimi i standardeve të përmbajtjes;
- II. Zbatimi i standardeve të arritjes;
- III. Zbatimi i programit të edukimit;
- IV. Planifikimi vjetor.

Nënfushat

I. Zbatimi i standardeve të përmbajtjes. Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor janë dokumenti kryesor ku mbështetet organizimi i gjithë veprimtarisë mësimore-edukative të kopshtit. Standardet e përmbajtjes përcaktojnë se çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët e kësaj moshe, çfarë njohuri, aftësi, shprehi, vlera dhe qëndrime duhet të fitojnë ata në kopsht. Të gjitha këto aspekte janë të lidhura ngushtë me 8 fushat më të rëndësishme, që përmbajnë standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor, si:

1. Bashkëveprimi i rritur-fëmijë;
2. Kurrikula;
3. Partneriteti familje-kopsht;
4. Kualifikimi i grupit të mësueseve;
5. Administrimi;
6. Mjedisi fizik;
7. Siguria, shëndeti dhe ushqimi;
8. Vlerësimi.

II. Zbatimi i standardeve të arritjes. Standardet e arritjes janë një nga dokumentet bazë ku mbështetet, hartohet, organizohet dhe vlerësohet puna në kopsht. Ato u shërbejnë njerëzve që: kanë interesa dhe janë të lidhur me arsimin parashkollor; jetojnë mes fëmijëve të vegjël; punojnë me fëmijët parashkollorë; vlerësojnë punën e kopshteve; hartojnë politikat arsimore kombëtare dhe lokale; trajnojnë mësueset e këtij cikli; përgatiten për të qenë të tillë etj. Standardet e arritjes në arsimin parashkollor përcaktojnë aftësitë, shprehitë dhe njohuritë që duhet të fitojë një fëmijë 3, 4 dhe 5-vjeçar, sipas linjave dhe drejtimeve. Linjat kryesore të standardeve të arritjes janë:

1. **Shëndeti fizik** i organizuar në 2 nënlinja: *Shëndeti fizik dhe Mirëqënia fizike*;
2. **Përqasja ndaj të nxëniet** e organizuar në 3 nënlinja: *Kërshëria dhe dëshira për të njohur; Këmbëngulja-përqendrimi, Krijimtaria dhe aftësia për të shpikur*;
3. **Zhvillimi social dhe emocional** i organizuar në 4 nënlinja: *Pikëpamja për veten; Vetëkontrolli; Bashkëveprimi me të tjerët; Zgjidhja e problemeve sociale*;
4. **Zhvillimi gjuhësor dhe komunikimi** i organizuar në 4 nënlinja: *Dëgjimi; Të folurit; Librat dhe leximi; Shkrimi*;
5. **Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme** i organizuar në 5 nënlinja: *Proceset matematike; Modelet, marrëdhëniet dhe funksionet; Koncepti i numrit dhe veprimet; Gjeometria dhe orientimi në hapësirë; Masat, matja, mbledhja e të dhënave dhe probabiliteti*;

6. **Zhvillimi motorik** i organizuar në 2 nënlinja: *Zhvillimi i motorikës së madhe; Zhvillimi i motorikës fine*.

III. Zbatimi i programit të edukimit. Programet e edukimit janë ndërtuar mbi bazën e standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes të arsimit parashkollor. Krahas kujdesit për mirëqënien dhe zhvillimin fizik, social, personal, gjuhësor, intelektual, programi i edukimit synon edhe zhvillimin akademik të fëmijëve parashkollorë. Programet janë ndërtuar mbi bazën e 6 fushave kurrikulare, si: *Zhvillimi gjuhësor, Zhvillimi matematikor, Zhvillimi shkencor, Zhvillimi social dhe personal, Edukimi artistik, Edukimi shëndetësor dhe fizik*. Secila fushë kurrikulare është e organizuar në linja, të cilat kanë synime të caktuara në formimin e përgjithshëm të fëmijëve. Çdo linjë ka objektivat që përcaktojnë njohuritë, aftësitë apo shprehitë që duhet të përfitojnë fëmijët nga një fushë e caktuar kurrikulare.

IV. Planifikimi vjetor. Çdo mësuese bën planifikimin vjetor të veprimtarisë mësimore-edukative. Në këtë plan shënohen **synimet dhe objektivat vjetorë** të punës me fëmijët e grupit, duke u fokusuar në arritjet e tyre sociale, personale dhe akademike. Më pas, përcaktohen **tematikat mujore dhe nëntemat javore**. Planifikimi vjetor përshkallëzohet duke u detajuar në planifikimin mujor, javor dhe ditor. Tematikat mujore u përgjigjen fushave të veprimtarisë edukative, njësisive tematike ose projekteve dhe miniprojekteve. Për zgjedhjen e tyre nevojitet një bashkëpunim i frytshëm ndërmjet mësueses dhe fëmijëve në përshtatje me nevojat, dëshirat dhe interesat e këtyre të fundit. Për secilën temë mujore përcaktohen **objektivat kurrikularë**, nëpërmjet të cilëve fëmijët do të përfitojnë njohuritë³, aftësitë⁴ dhe shprehitë⁵ e synuara nga programet dhe standardet e arritjes për grupmoshën përkatëse. Objektivat duhet të jenë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe të përcaktuar në kohë.

Veprimtaritë mësimore-edukative që përzgjidhen për t'u realizuar përgjatë ditëve të muajit, duhet të

3) **Njohuritë** kanë të bëjnë me konceptet dhe informacionet që marrin fëmijët në kopsht.

4) **Aftësitë** kanë të bëjnë me frekuencën me të cilën fëmijët kryejnë veprime e lëvizje të caktuara sipas programit.

5) **Shprehitë** lidhen me aftësitë për t'i kryer veprimet në mënyrë të menjëhershme.

jenë në përshtatje me temat dhe të mundësojnë përmbushjen e objektivave të synuar. Për realizimin e tyre, mësuesja planifikon materialet dhe mjetet e nevojshme për çdo veprimtari; kërkesat që duhen plotësuar dhe përgatitjet paraprake të mësueseve; parashikimin e situatave të papritura që mund të ndodhin⁶; përshtatjen e mjedisit; parashikimin e ndihmesës që sigurohet prej prindërve etj.

Për të lehtësuar realizimin e veprimtarive, mësueset mund të shënojnë në planifikimin vjetor edhe miniprojektet që do të realizojnë përgjatë muajit. Gjatë hartimit të planit, mësuesja parashikon nevojat dhe ndihmën që do të kërkojë nga prindërit, sipas mundësive që kanë dhe punës vullnetare që mund të bëjnë. Në kopsht, si në asnjë institucion tjetër, partneriteti mësues-prind është çelësi i suksesit të punës me fëmijën. Kjo është edhe arsyeja që planin vjetor, mësuesja e diskuton me prindërit e fëmijëve të grupit dhe e përmirëson mbi bazën e sugjerimeve të tyre.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Zbatimi i standardeve të përmbajtjes	1. Kopshti⁷ realizon një bashkëveprim të vijueshëm mësuese-fëmijë.	1.1.1. Stafi pedagogjik bashkëbisedon me fëmijët dhe transmeton dashuri e respekt.				
		1.1.2. Stafi pedagogjik përdor metoda të larmishme mësimdhënieje.				
		1.1.3. Stafi pedagogjik përdor forma pune që e mbështetin fëmijën gjatë procesit të veprimtarisë mësimore-edukative.				
		1.1.4. Pjesa më e madhe e aktiviteteve zhvillohet në punë me grupe.				
		1.1.5. Stafi pedagogjik trajton në mënyrë të barabartë të gjithë fëmijët.				
		1.1.6. Stafi pedagogjik nxit fëmijët të jenë të pavarur.				
		1.1.7. Stafi pedagogjik u krijon mundësi fëmijëve që të ndër marrin nisma në përshtatje me moshën.				

6) Gjatë zhvillimit të veprimtarisë mësimore-edukative, mësuesja mund të kuptojë se tema e planifikuar nuk i tërheq më fëmijët dhe nuk ka prurje të reja. Për këtë arsye, ajo mund ta ndërpresë zhvillimin e temës dhe të vazhdojë me një temë tjetër, e cila është më tërheqëse për fëmijët e grupit të saj. Ky ndryshim shënohet në planin mujor dhe miratohet nga drejtuesja e kopshtit.

7) *Kopshti* nënkupton gjithë personelin mësimor-edukativ të institucionit.

		1.1.8. Stafi pedagogjik ndihmon fëmijët të identifikojnë dhe të përjetojnë emocione pozitive.				
		1.1.9. Stafi pedagogjik tregon respekt për çdo fëmijë dhe familjen e tij, pavarësisht prejardhjes dhe kulturës së tyre.				
2. Kurrikula në kopsht planifikohet në përputhje me moshën dhe interesat e fëmijëve.	1.2.1.	Stafi pedagogjik ka planifikuar kurrikulën, duke u mbështetur në të gjitha dokumentet zyrtare (standarde, program, udhëzime të MASH-it).				
	1.2.2.	Stafi pedagogjik ka hartuar kurrikulën në përputhje me zhvillimin moshor, psikologjik, interesat dhe nevojat e fëmijëve parashkollorë.				
	1.2.3.	Stafi pedagogjik ka zbatuar kurrikulën, duke u mbështetur në të gjitha dokumentet zyrtare (standarde, program, udhëzime të MASH-it).				
	1.2.4.	Stafi pedagogjik përzgjedh modelin e VME-së që do të realizojë në kopsht.				
	1.2.5.	Stafi pedagogjik i ka planifikuar aktivitetet sipas fushave kurrikulare.				
	1.2.6.	Stafi pedagogjik ka bërë ndryshime në planifikim në dobi të interesave të fëmijëve (nëse ka lindur nevoja).				
	1.2.7.	Stafi pedagogjik ka planifikuar aktivitetet sipas fushave kurrikulare.				
	1.2.8.	Stafi pedagogjik ka planifikuar aktivitetet sipas nevojave dhe interesave individuale të fëmijëve.				
	1.2.9.	Stafi pedagogjik ka përzgjedhur materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e aktiviteteve.				
	1.2.10.	Stafi pedagogjik ka siguruar mjete mësimore, përfshirë: TV, DVD, video, kompjutera, lodra lëvizore të nevojshme për realizimin e kurrikulës.				
	1.2.11.	Stafi pedagogjik ruan raportet mes aktiviteteve, brenda e jashtë kopshtit.				
	1.2.12.	Stafi pedagogjik ruan raportet mes veprimtarive të qeta dhe aktive.				

		1.2.13. Stafi pedagogjik ruan raportet mes veprimtarive individuale, në grup të vogël dhe në grup të madh.				
		1.2.14. Kalimi nga njëra veprimtari në tjetrën bëhet natyrshëm.				
3. Kopshti i jep përparësi partneritetit kopsht-familje.	1.3.1.	Stafi pedagogjik shkëmben çdo ditë informacione me prindërit.				
	1.3.2.	Stafi pedagogjik i mirëpret prindërit në çdo moment të ditës.				
	1.3.3.	Stafi pedagogjik i ka bërë prindërit pjesë të vendimeve që kanë lidhje me veprimtarinë e kopshtit.				
	1.3.4.	Stafi pedagogjik informon prindërit rreth programit të edukimit të kopshtit.				
	1.3.5.	Stafi pedagogjik ka kërkuar nga prindërit sugjerime për aktivitetet që do të zhvillojnë në grup apo në kopsht.				
	1.3.6.	Stafi pedagogjik ka bashkëpunuar me prindërit, në mënyrë që aktivitetet që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëri-tjetrin.				
	4. Stafi pedagogjik merr pjesë vazhdimisht në veprimtari të ndryshme trajnuese dhe kualifikuese.	1.4.1.	Mësueset kanë marrë pjesë në seminare dhe trajnime sistematike të lidhura me edukimin dhe kujdesin ndaj fëmijës.			
1.4.2.		Mësueset kanë shkëmbyer vizita me mësueset e kopshteve të tjera, brenda ose jashtë rrethit.				
1.4.3.		Në kopsht janë zhvilluar trajnime apo shkëmbim përvoja midis stafit pedagogjik.				
1.4.4.		Stafi pedagogjik shfrytëzon literaturë profesionale, internetin, si dhe burime të tjera informacioni, për të përmirësuar rezultatet e punës me fëmijët.				
1.4.5.		Stafi pedagogjik përshtat metodat dhe format e mësimdhënies sipas fushave të zhvillimit dhe stileve të të nxënit të fëmijëve.				
5. Drejtuesja e kopshtit dhe mësueset zbatojnë ligjshmë-	1.5.1.	Kopshti funksionon mbi bazën e Ligjit "Për arsimin parauniversitar" dhe akteve nënligjore e udhëzimeve të nxjerra nga MASH-i.				

	rinë zyrtare që lidhet me institucionin e tyre.	1.5.2. Kopshti zbaton politikat që lidhen me problemet fiskale.				
		1.5.3. Kopshti zbaton politikat që lidhen me situatat emergjente.				
	6. Mjedisi fizik i kopshtit mundëson zbatimin e kurrikulës.	1.6.1. Hapësirat fizike të grupeve krijojnë mundësi që fëmijët të lëvizin lirshëm nga njëra qendër në tjetrën.				
		1.6.2. Fëmijët orientohen lehtësisht në mjediset e grupit.				
		1.6.3. Mjedisi fizik është organizuar në mënyrë të tillë që të gjithë fëmijët nxiten të marrin pjesë, të ndërveprojnë, të luajnë dhe të mësojnë.				
		1.6.4. Mjedisi i brendshëm është organizuar në mënyrë të tillë që fëmijët të kenë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh.				
		1.6.5. Mjedisi fizik i jashtëm u krijon mundësi fëmijëve që të qëndrojnë dhe të luajnë në ajër të pastër.				
		1.6.6. Mjedisi fizik i brendshëm është i pasur me materiale, libra e pajisje didaktike, që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të larmishme.				
		1.6.7. Mësuesja ka përshtatur mjedisin e të nxënësve sipas nevojave të çdo fëmije.				
		1.6.8. Mjedisi fizik i kopshtit është i aksesueshëm për të gjithë fëmijët.				
	7. Kopshti ka kushte të përshtatshme që mundëson sigurinë e jetës, shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijëve.	1.7.1. Personeli pedagogjik njih dhe zbaton "Rregullorja e shërbimit shëndetësor në institucionet parashkollore".				
		1.7.2. Drejtuesja e kopshtit ka të dokumentuar informacionin e nevojshëm për gjendjen fizike dhe mendore të secilit fëmijë, të lëshuar nga instancat përkatëse shëndetësore.				
		1.7.3. Kopshti ka siguruar shërbimin shëndetësor.				
		1.7.4. Tualetet higjienizohen çdo ditë.				
		1.7.5. Kopshti ka ujë të ngrohtë dhe të ftohtë gjatë gjithë ditës.				
		1.7.6. Kopshti i ka të gjitha mjediset të sigurta për jetën e fëmijëve.				
		1.7.7. Mjediset e tualetit, uji i pijshëm dhe mjetet e larjes së duarve janë lehtësisht të arritshme nga ana e fëmijëve.				
		1.7.8. Personeli i kopshtit dhe fëmijët njohin procedurat				

		që ndiqen në raste emergjente: rënie zjarri, përmytje, stuhi.				
		1.7.9. Dezinfektantët dhe detergjentët janë në mjedise të pakapshme nga fëmijët.				
		1.7.10. Fëmijët mbahen nën vëzhgim kur përdorin gjëra të rrezikshme, si: tel, gërshërë, pinceta, ngjitësa, thumba.				
		1.7.11. Krahas rregullave të ngrënies, përdorimit të thikës, pirunit mësueset u tregojnë fëmijëve edhe si përdoren pa u dëmtuar.				
	8. Mësueset kryejnë vlerësimin e fëmijëve.	1.8.1. Stafi pedagogjik përdor instrumente vlerësimi për të vlerësuar progresin e përgjithshëm të fëmijës.				
		1.8.2. Mësueset e kopshtit kanë dokumentacion të pasur që tregon zhvillimin intelektual të çdo fëmije.				
		1.8.3. Shënimet e mësueses nxjerrin në dukje anët e forta, vështirësitë dhe problemet që mund të paraqesin fëmijët.				
		1.8.4. Mësueset kryejnë vlerësim formal një herë në tre muaj.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e			
			1	2	3	4
Zbatimi i standardeve të arritjes	1. Stafi pedagogjik kujdeset për shëndetin dhe mirëqenien fizike të fëmijëve të kopshtit.	2.1.1. Mësueset e kopshtit njohin karakteristikat e <i>shëndetit të mirë fizik</i> të një fëmije parashkollor.				
		2.1.2. Fëmijët janë të informuar për çështje të shëndetit, të sigurisë dhe të kujdesit personal.				
		2.1.3. Fëmijët kryejnë të pavarur detyrat e kujdesit vetjak.				
	2. Mësueset motivojnë fëmijët për të njohur botën dhe njerëzit që i rrethojnë.	2.2.1. Stafi pedagogjik ka krijuar mjedisin e nevojshëm fizik, materialet dhe mjetet që inkurajojnë “shpikjet” apo zbulimet e fëmijëve.				
		2.2.2. Mësuesja transmeton saktë te fëmijët njohuritë për karakteristikat, nevojat themelore dhe ciklin e jetës së qenieve të gjalla.				
		2.2.3. Fëmijët shfaqin interes për veprimtaritë që zhvillohen në kopsht.				
		2.2.4. Fëmijët vëzhgojnë dhe eksplorojnë materiale të ndryshme në mjedisin përreth.				

		2.2.5. Fëmijët i kërkojnë ndihmë mësueses për të mbaruar një detyrë të caktuar.				
		2.2.6. Fëmijët evidentojnë karakteristikat fizike personale dhe të tjerëve.				
		2.2.7. Fëmijët shfaqin interes për marrëdhëniet mes njerëzve dhe vendit ku jetojnë.				
3. Fëmijët demonstrojnë besim e siguri individuale, si dhe bashkëpunojnë me të tjerët.		2.3.1. Fëmijët shfaqin vlerësime pozitive për veten.				
		2.3.2. Fëmijët janë të aftë të zgjedhin veprimtaritë nëpër qendrat e aktivitetit.				
		2.3.3. Fëmijët njohin rregullat e grupit dhe procedurat rutinë të përditshme.				
		2.3.4. Fëmijët kujdesen për mbrojtjen e mjeteve dhe të materialeve të klasës.				
		2.3.5. Fëmijët bashkëveprojnë lirshëm me mësuesen dhe fëmijët e tjerë.				
		2.3.6. Fëmijët shfaqin interes për jetën dhe veprimtaritë që zhvillohen në grup.				
		2.3.7. Fëmijët kujdesen dhe i ndihmojnë shokët kur kanë nevojë.				
4. Fëmijët shfaqin interes për librat, për të lexuarit, të shkruarit, duke zbatuar dhe rregulla të caktuara.		2.4.1. Fëmijët dëgjojnë me vëmendje mësuesen dhe shokët.				
		2.4.2. Fëmijët shfaqin interes për leximin dhe librat.				
		2.4.3. Fëmijët veprojnë sipas udhëzimeve që dëgjojnë.				
		2.4.4. Fëmijët bëjnë sikur lexojnë ose tentojnë të lexojnë pjesë të historive të pëlqyera për ta.				
		2.4.5. Fëmijët përgjigjen duke respektuar strukturat gjuhësore.				
		2.4.6. Fëmijët shprehin atë që mendojnë.				
		2.4.7. Fëmijët përdorin <i>gjuhën</i> për të krijuar atë që pretendojnë.				
		2.4.8. Fëmijët përdorin komunikimin gojor për qëllime të ndryshme.				
		2.4.9. Biblioteka e kopshtit (apo e grupit) është e pasur me libra të fëmijëve sipas grupmoshës.				
		2.4.10. Fëmijët janë të familjarizuar me procedurat e leximit të një libri.				

		2.4.11. Fëmijët flasin lirshëm për librat që duan t'u lexohen.				
		2.4.12. Fëmijët shfaqin interes për leximin e librave, fjalët dhe shkronjat, edhe për t'i shkruar ato.				
		2.4.13. Fëmijët ndihmohen nga mësuesja të interpretojnë një rol.				
	5. Fëmijët zotërojnë koncepte matematikore sipas standardeve dhe përdorin artin për të shprehur botën e tyre të brendshme.	2.5.1. Fëmijët janë të aftë të zgjidhin situata problemore dhe problema të thjeshta matematikore duke përdorur numrat.				
		2.5.2. Fëmijët i kuptojnë marrëdhëniet dhe funksionet në mjedisin që i rrethon, brenda mundësive të tyre moshore.				
		2.5.3. Mësuesja shpjegon saktë konceptet për numrin, numërimin dhe sasinë.				
		2.5.4. Mësuesja shpjegon saktë konceptet për figurat dy dhe tredimensionale.				
		2.5.5. Fëmijët shpjegojnë vendndodhjen e sendeve dhe të objekteve në hapësirë.				
		2.5.6. Fëmijët përdorin fjalë krahasuese.				
		2.5.7. Fëmijët matin saktë me mjete jo standarde.				
		2.5.8. Fëmijët renditin, krahasojnë dhe përshkruajnë sende në bazë të madhësisë, gjatësisë, vëllimit dhe peshës.				
	6. Fëmijët kryejnë lëvizje fizike dhe koordinojnë vetveten për të realizuar detyra të ndryshme.	2.6.1. Fëmijët kryejnë lëvizje të ekuilibruara në përshtatje me moshën dhe mundësitë fizike.				
		2.6.2. Fëmijët koordinojnë lëvizjet për të kryer një detyrë.				
		2.6.3. Fëmijët koordinojnë sytë dhe dorën në realizimin e detyrave të thjeshta.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Zbatimi i programit të edukimit sipas gjashtë fushave kurrikulare	1. Programet zyrtare të fushave të studimit orientojnë punën e stafit pedagogjik dhe zbatimin e veprimtarive mësimore edukative.	3.1.1. Stafi pedagogjik mbështetet në programet e parashkollorit për të hartuar veprimtaritë mësimore- edukative.				
		3.1.2. Stafi pedagogjik përdor programet e parashkollorit për formimin e përgjithshëm të fëmijëve.				
		3.1.3. Zbatimi i programeve të parashkollorit mbështetet në parimet e integritit dhe të gjithëpërfshirjes.				
		3.1.4. Programet realizohen nëpërmjet planifikimeve vjetore, mujore, javore dhe ditore në interes të fëmijëve.				
	2. Programet zyrtare të fushave të studimit zbatohen në përshtatje me kushtet specifike të çdo institucioni parashkollor.	3.2.1. Stafi pedagogjik është i qartë për kërkesat e diferencuara të programeve për secilën grupmoshë.				
		3.2.2. Stafi pedagogjik ka parashikuar realizimin e programeve përgjatë gjithë vitit akademik.				
		3.2.3. Programet realizohen në përshtatje me interesat e komunitetit ku ndodhet kopshti, me synimet dhe nivelin e pritshmërisë së fëmijëve.				
		3.2.4. Objektivat e programeve janë të përshtatur në më shumë se një tematikë.				
		3.2.5. Zbatimi i programeve mbështetet në parimin e rimarrjes dhe të përforcimit të njohurive e aftësive, nga njëra temë në tjetrën.				
		3.2.6. Stafet pedagogjike ndërhyjnë në realizimin e kërkesave të programeve kur e shohin të arsyeshme.				
	3. Metodologjia e zbatimit të programeve zgjidhet nga stafi pedagogjik dhe mbështetet mbi	3.3.1. Stafi pedagogjik zbaton programet në përshtatje me metodologjinë dhe programin edukativ të kopshtit.				
		3.3.2. Stafi pedagogjik përzgjedh metodologjinë e zbatimit të programeve sipas kapaciteve profesionale, mjedisit fizik, personelit.				

përvoja të suksesshme bashkëkohore.	3.3.3. Mësueset sigurojnë materiale ndihmëse për realizimin e aktiviteteve, të miniprojekteve ose projekteve të një teme.				
	3.3.4. Mësueset e reja i nënshtrohen trajnimeve profesionale, për të njohur metodologjinë që përdoret në këtë institucion.				
	3.3.5. Zbatimi i programeve lidhet me sigurimin e mjeteve dhe materialeve didaktike, të pajisjeve dhe orendive sipas kërkesave që shtrohen në programin e çdo fushe kurrikulare.				
	3.3.6. Metodot, teknikat dhe strategjitë që përzgjidhen nga stafi pedagogjik, garantojnë cilësinë e realizimit të programit.				
4. Zbërthimi dhe zbatimi i programeve bëhet duke ruajtur veçoritë e grupmohave ose me grup të përzier.	3.4.1. Stafi pedagogjik zotëron programet e parashkollorit për çdo grupmoshë.				
	3.4.2. Mësuesja përdor shumëllojshmëri praktikash dhe burimesh për të nxitur zhvillimin individual të fëmijës.				
	3.4.3. Stafi pedagogjik është në gjendje të nxjerrë specifikat e çdo programi nga njëri vit parashkollori në tjetrin.				
	3.4.4. Mësueset që punojnë me grupe të përzierra, i përshtatin veprimtaritë e programeve sipas moshave të fëmijëve që kanë në grup.				
	3.4.5. Në secilin program, mësueset përzgjedhin konceptet dhe aftësitë bazë që duhet të përfitojnë fëmijët.				
	3.4.6. Mësuesja përdor gjuhë të kuptueshme për t'i mësuar fëmijës konceptet kryesore.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Planifikimi vjetor i VME - së	1. Planifikimi vjetor bëhet duke marrë parasysh dokumentet zyrtare dhe nevojat e fëmijëve.	4.1.1. Stafi pedagogjik ka hartuar planin vjetor mbi bazën e dokumenteve zyrtare të arsimit parashkollor.				
		4.1.2. Në planin vjetor janë pasqyruar konceptet, idetë, faktet kryesore të fushave të programit që duhet të zotërohen nga fëmijët e një grupmoshe të caktuar.				
		4.1.3. Në planin vjetor është parashikuar edhe harta e koncepteve për secilën grupmoshë, vlerat edukative të qytetarisë dhe të bashkëjetesës.				
		4.1.4. Stafi pedagogjik ka bashkëpunuar për hartimin e planit vjetor, pavarësisht grupit me të cilin punojnë.				
		4.1.5. Plani vjetor është shkruar sipas formatit të përcaktuar në hyrjen e kësaj fushe.				
		4.1.6. Mësuesja ka në dosje planifikimet e detajuara mujore, javore dhe ditore.				
		4.1.7. Planifikimi mujor përmban objektivat kurrikularë, aktivitetet javore (ose dyjavore) dhe parashikimin për produktin ⁸ final të temës.				
	2. Zbatimi i planit vjetor ruan fleksibilitetin dhe nevojën për të bërë ndryshime.	4.2.1. Çdo mësuese ka hartuar planin vjetor në përputhje me zhvillimin moshor.				
		4.2.2. Çdo mësuese ka planifikuar veprimtarinë mësimore-edukative mbi bazën e një kurrikule të integruar.				
		4.2.3. Në planifikimin vjetor/mujor/javor janë bërë ndryshime në përshtatje me aktualitetin.				
3. Në hartimin e planit vjetor janë marrë parasysh da-	4.3.1. Çdo mësuese ka identifikuar aftësitë, inteligjencat e shumëfishta, stilet e të nxëniet të fëmijëve të grupit dhe i ka marrë parasysh në planifikimin e VME-së.					

8) Te produkti futet realizimi i një maketi, dramatizimi i një përralle, përgatitja e një albumi me fotografi, herbariumi, punimi i një libri nga vetë fëmijët, përgatitja e një posteri, kolazhi etj.

llimet ndërmjet fëmijëve.	4.3.2. Në hartimin e veprimtarive javore dhe ditore, mësuesja e çdo grupi ka marrë parasysh përshtatjen e veprimtarive dhe nevojave individuale të fëmijëve.				
	4.3.3. Në hartimin e planit vjetor, mësuesja ka bashkëpunuar me koleget e tjera të stafit, me mjekun, punonjësen sociale, psikologun dhe prindërit, me qëllim që të zhvillojnë strategji të përshtatshme ndërhyrjeje për fëmijën me nevoja të veçanta.				
	4.3.4. Në hartimin e planit vjetor, mësuesja ka futur tema mësimore që kanë lidhje me mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës në situata të vështira, dëmtime apo tragjedi të mundshme.				
	4.3.5. Mësuesja ka hartuar planin edukativ individual (PEI) për fëmijët me nevoja të veçanta që ka në grup, bazuar në një listë kontrolli.				
	4.3.6. Stafi pedagogjik stimulon entuziazmin e fëmijëve, interesat, dëshirat dhe kuriozitetin e tyre moshor nëpërmjet veprimtarive të planifikuara.				
	4.3.7. Në planin mujor dhe ditor, mësuesja ka përcaktuar aktivitete të veçanta, ku fëmijët mund të shfaqin anët e forta dhe të kuptojnë nevojat e tyre për përmirësim.				

STANDARDI

Stafi pedagogjik i kopshtit mbështetet në dokumentet zyrtare të arsimit parashkollor për planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e kurrikulës, duke respektuar të gjitha kërkesat dhe kriteret. Hartimi i kurrikulës bëhet mbi bazën e 5 elementeve: vendosja e objektivave, përcaktimi i përmbajtjes, përzgjedhja e metodave, përcaktimi i mënyrës së organizimit dhe zhvillimit të përmbajtjes, vlerësimi i kurrikulës së zbatuar. Në kurrikulën e arsimit parashkollor mbahen parasysh aspekte të tilla të kurrikulës, si **shtrirja** e përmbajtjes në gjerësi dhe në thellësi e asaj që ka më shumë vlerë për t'u mësuar nga fëmijët në kopsht, **renditja** dhe lidhja vertikale ndërmjet fushave kurrikulare nga grupi i parë në të tretin, duke respektuar parime të tilla, si: kalimi nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e njohura te e panjohura, nga të mësuarit e së tërës në të mësuarit e pjesëve të veçanta, të mësuarit kronologjik etj., **vazhdimësia** që ka të bëjë me përsëritjen e vazhdueshme të gjërave të mësuar, **integrimi** i njohurive, por edhe i fushave kurrikulare, baraspesha në kurrikul si në shtrirjen përgjatë një viti, ashtu edhe në shtrirjen në të tria vitet e arsimit parashkollor. Zbatimi i kurrikulës bëhet nëpërmjet planifikimit vjetor, mujor, javor dhe ditor. Planifikimi vjetor është fleksibël dhe mund të ndryshohet në dobi të interesave të përgjithshme të fëmijëve, të udhëzimeve të reja që dalin, të aktualizimit, të informacioneve të reja që gjen mësuesja etj. Zbatimi i kurrikulës bëhet duke përdorur materiale dhe mjete didaktike, për mësuesen dhe fëmijët, të sugjeruara në dokumentet zyrtare, në funksion të cilësisë së veprimtarisë mësimore-edukative. Vlerësimi i kurrikulës së përvetësuar nga fëmijët bëhet mbi bazën e standardeve të arritjes, kurse vlerësimi i përgjithshëm i veprimtarisë mësimore-edukative bëhet mbi bazën e treguesve të dhënë në këtë udhëzues.

NIVELI 1

Stafi pedagogjik i kopshtit ka respektuar *të gjitha* kërkesat dhe kriteret që përmbajnë dokumentet zyrtare të arsimit parashkollor në planifikimin e kurrikulës. Kurrikula që zbatohet në kopsht, nga grupi i parë në grupin e tretë, ka reflektuar *çdo* aspekt të hartimit të kurrikulës (**shtrirjen** e përmbajtjes në gjerësi dhe në thellësi, **lidhjen vertikale** të fushave kurrikulare nga njëra grupmoshë në tjetrën, ka respektuar **parime** të tilla, si: kalimi nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e njohura te e panjohura, nga të mësuarit e së tërës në të mësuarit e pjesëve të veçanta, të mësuarit kronologjik etj., jepen dhe **rimërren** tema dhe koncepte të mësuar, **integrimi** i njohurive, **baraspesha** dhe shtrirja e kurrikulës nga njëri vit në tjetrin). Planifikimi vjetor *është bërë në përputhje të plotë* me kërkesat e dokumenteve zyrtare dhe *konform* rubrikave të kërkuara

(me tematika mujore të parashikuara, me objektiva nga secila fushë kurrikulare, me veprimtari të parashikuara javore, duke respektuar etapat në regjimin ditor, sipas metodologjisë që ka programi që zbaton kopshti). Në zbatimin e kurrikulës, stafi pedagogjik ka parashikuar dhe përdor *pjesën më të madhe* të materialeve dhe mjeteve didaktike të sugjeruara në dokumentet zyrtare, duke zhvilluar një veprimtari cilësore mësimore-educative. Stafi pedagogjik *është i qartë* për kriteret dhe treguesit e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në kopsht, të dhëna në këtë udhëzues.

NIVELI 2

Stafi pedagogjik i kopshtit ka respektuar *pothuajse* të gjitha kërkesat dhe kriteret që përmbajnë dokumentet zyrtare të arsimit parashkollor në planifikimin e kurrikulës. Kurrikula që zbatohet në kopsht, nga grupi i parë në grupin e tretë, i ka reflektuar, *në përgjithësi*, aspektet e kurrikulës (**shtrirjen** e përmbajtjes në gjerësi dhe në thellësi, **lidhjen vertikale** të fushave kurrikulare nga njëra grupmoshë në tjetrën, ka respektuar **parime** të tilla, si: kalimi nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e njohura te e panjohura, nga të mësuarit e së tërës në të mësuarit e pjesëve të veçanta, të mësuarit kronologjik etj., jepen dhe **rimerren** tema dhe koncepte të mësuara, **integrimi** i njohurive, **baraspesha** dhe shtrirja e kurrikulës nga njëri vit në tjetrin). Planifikimi vjetor respekton kërkesat e dokumenteve zyrtare, *por jo në të gjitha* rubrikat e kërkuara. Në zbatimin e kurrikulës, *jo i gjithë* stafi pedagogjik ka parashikuar dhe përdor materiale dhe mjete didaktike të sugjeruara në dokumentet zyrtare, për të zhvilluar një veprimtari cilësore mësimore-educative. Stafi pedagogjik *nuk është plotësisht i qartë* për kriteret dhe treguesit e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në kopsht, të dhëna në këtë Udhëzues.

NIVELI 3

Stafi pedagogjik i kopshtit ka respektuar *pjesërisht* kërkesat dhe kriteret që përmbajnë dokumentet zyrtare të arsimit parashkollor në planifikimin e kurrikulës. Gjithashtu, edhe kurrikula që zbatohet në kopsht, nga grupi i parë në grupin e tretë, i ka reflektuar *pjesërisht* aspektet e kurrikulës (**shtrirjen** e përmbajtjes në gjerësi dhe në thellësi, **lidhjen vertikale** të fushave kurrikulare nga njëra grupmoshë në tjetrën, ka respektuar **parime** të tilla, si: kalimi nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e njohura te e panjohura, nga të mësuarit e së tërës në të mësuarit e pjesëve të veçanta, të mësuarit kronologjik etj., jepen dhe **rimerren** tema dhe koncepte të mësuara, **integrimi** i njohurive, **baraspesha** dhe shtrirja e kurrikulës nga njëri vit në tjetrin).

Planifikimi vjetor respekton deri diku kërkesat e dokumenteve zyrtare, *por jo në të gjitha* rubrikat e kërkuara. Në zbatimin e kurrikulës, *jo i gjithë* stafi pedagogjik ka parashikuar dhe përdor materiale dhe mjete didaktike të sugjeruara në dokumentet zyrtare për të zhvilluar një veprimtari cilësore mësimore-edukative. Stafi pedagogjik *nuk është i qartë* për kriteret dhe treguesit e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në kopsht, të dhëna në këtë udhëzues.

NIVELI 4

Stafi pedagogjik i kopshtit nuk ka respektuar *pjesën më të madhe* të kërkesave dhe kriterëve që përmbajnë dokumentet zyrtare të arsimit parashkollor në planifikimin e kurrikulës. Kurrikula që zbatohet në kopsht, nga grupi i parë në grupin e tretë, i ka reflektuar *përciptazi* aspektet e kurrikulës (**shtrirjen** e përmbajtjes në gjerësi dhe në thellësi, **lidhjen vertikale** të fushave kurrikulare nga njëra grupmoshë në tjetrën, ka respektuar **parime** të tilla, si: kalimi nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e njohura te e panjohura, nga të mësuarit e së tërës në të mësuarit e pjesëve të veçanta, të mësuarit kronologjik etj., jepen dhe **rimerren** tema dhe koncepte të mësuara, **integrimi** i njohurive, **baraspesha** dhe shtrirja e kurrikulës nga njëri vit në tjetrin). Planifikimi vjetor respekton *disi* kërkesat e dokumenteve zyrtare, *por jo në të gjitha* rubrikat e kërkuara. Në zbatimin e kurrikulës, *jo i gjithë* stafi pedagogjik ka parashikuar dhe përdor materiale dhe mjete didaktike të sugjeruara në dokumentet zyrtare. Stafi pedagogjik *nuk është i qartë* për kriteret dhe treguesit e vlerësimit të kurrikulës së zbatuar në kopsht, të dhëna në këtë udhëzues.

FUSHA II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-EDUKATIVE

Zhvillimi i fëmijës është rezultat i procesit të bashkëveprimit të dy ose më shumë aktorëve: të rriturit nga njëra anë dhe fëmijës nga ana tjetër. Sot, gjithmonë e më shumë, mbështetet teoria e zhvillimit ndërveprues sipas të cilit, fëmija si mbartës i një trashëgimie të lindur zhvillon aftësitë në ndërveprim me moshatarët dhe të rriturit. Psikologjia ndërvepruese (interaktive) e vlerëson fëmijën si një subjekt aktiv dhe i aftë, i pajisur me aftësi njohëse të veçanta, me mekanizma vetërregullues dhe aftësi komplekse funksionale, i aftë të shkëmbejë informacion me mjedisin që e rrethon.

Fëmija konsiderohet si aktori kryesor i zhvillimit të vet, i aftë të ndërveprojë me të rriturit dhe bashkëmoshatarët, proces ky që është shumë i rëndësishëm për të dy palët. Në moshën e kopshtit, fëmija është një subjekt që di të orientohet në realitetin që e rrethon mbi bazën e skemave që nuk janë akoma të përcaktuara. Fëmija dhe i rrituri përbëjnë një mekanizëm të përbashkët që nuk ka elemente të pavarura. Të dy së bashku, edhe pse nga këndvështrime të ndryshme, zhvillojnë veprimtari, ndërtojnë modele sjelljesh, dialogojnë dhe komunikojnë duke i dhënë kuptim veprimeve dhe ngjarjeve, ndërtojnë kodin gjuhësor të mirëkuptimit dhe krijojnë sistemin e tyre të bashkëveprimit.

Në këtë proces, fëmija përballë me strukturat e të kuptuarit, të të menduarit të vlerave shoqërore dhe kulturore që të gjitha së bashku ndikojnë në procesin e formimit dhe njohjes së tij. Në këtë mënyrë, fëmija integrohet në mjedisin shoqëror dhe kulturor të shoqërisë që i përket nëpërmjet procesit të nxënies, të kuptuarit dhe të ushtruarit të njohurive që merr për realitetin fizik dhe social.

Kopshti i fëmijëve zë një vend të veçantë në formimin harmonik të personalitetit të fëmijës 3-6 vjeç. Veprimtaria edukative e kopshtit si plotësuese e veprimtarisë familjare dhe parapërgatitore për shkollën fillore, përbën një përvojë të rëndësishme që ndihmon fëmijën të rritet.

Qëllimi i veprimtarisë mësimore-edukative në parashkollor orientohet në:

- edukimin dhe formimin e individit të lirë, të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës në jetën shoqërore;
- përvetësimin e aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese;
- zhvillimin e aftësive psikomotorë, njohëse, emocionale, shoqërore dhe morale të personalitetit;
- respektimin e barazisë së shanseve për të gjithë fëmijët.

Për të pasur një vlerësim dhe vetëvlerësim sa më frytshëm të punës mësimore-edukative në kopsht, kjo fushë është organizuar në **3 nënfusha**:

- I. Organizmi dhe shfrytëzimi i kohës për realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative;
- II. Regjimi ditor dhe respektimi i ritmeve në një mjedis nxitës dhe bashkëveprues;
- III. Metodologjia e përdorur për zbatimin e veprimtarisë mësimore-edukative.

Nënfushat

I. Organizmi dhe shfrytëzimi i kohës për realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative

Organizimi dhe shfrytëzimi i kohës në kopsht mbështetet në ritmet e përshtatshme të veprimtarive që kryhen me fëmijët në përshtatje me veprimtaritë ditore, javore dhe mujore, duke iu përgjigjur zhvillimit individual dhe rrethor të fëmijëve. Treguesit e mëposhtëm evidentojnë nevojat e fëmijëve që duhet të plotësohen dhe respektohen. Rezultatet e studimeve kronobiologjike, kronopsikologjike kanë evidentuar lidhjen që ekziston midis rezultateve vjetore, javore dhe ditore të fëmijëve dhe kohës së organizimit të veprimtarive.

II. Regjimi ditor dhe respektimi i ritmeve në një mjedis nxitës dhe bashkëveprues. Sugjerimet për regjimin ditor dhe përshtatjen e tij me ritmet dhe nevojat e fëmijës kanë vlerë orientuese në organizimin e jetës dhe të veprimtarisë së kopshtit. Rregullimet dhe përshtatja e tyre në përputhje me profilin e çdo kopshti është e nevojshme dhe e domosdoshme. Qëllimi i tyre kryesor është *që çdo fëmijë t'i sigurojë një, mjedis në të cilin ai percepton drejt se çfarë di, çfarë ka dëshirë të mësojë, veprimtaritë për të cilat ka nevojë, përgjegjësitë që mund të mbajë për të organizuar kohën që qëndron në kopsht.*

Ritmet e organizimit ditor përfshijnë tërësinë e momenteve të çlodhjes, të argëtimit, të rigrupimit të fëmijëve, në funksion të realizimit të veprimtarisë edukative, të përmbushjes së nevojave individuale të fëmijëve, të momenteve të bashkëveprimit midis fëmijëve të moshave të ndryshme etj. Të gjitha këto modifikojnë ose pasurojnë veprimtarinë mësimore-edukative në përputhje me regjimin ditor dhe ritmet e fëmijëve. E rëndësishme është që fëmija gradualisht të ndërjegjësohet për kohën që ka në dispozicion, mjedisin dhe arsyen e zhvillimit të veprimtarisë.

III. Metodologjia e përdorur për zbatimin e veprimtarisë mësimore-edukative. Qëllimi i veprimtarisë mësimore edukative është motivimi i fëmijëve. Për fëmijën, *të rritet* do të thotë të veprojë si bashkëmohatarët dhe të rriturit që bëjnë pjesë në mjedisin social-kulturor të tij. Fëmijët e kopshtit kanë nivele të ndryshme zhvillimi në varësi të kulturës familjare. Për të organizuar një veprimtari të dobishme për fëmijën është e rëndësishme të vlerësohen aftësitë e veçanta, të cilat spikatin gjatë vëzhgimit të veprimtarive të organizuara dhe të lira të secilit fëmijë, si p.sh.: kurioziteti që shfaqin, mënyra se si veprojnë etj.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Organizmi dhe shfrytëzimi i kohës për realizimin e veprimtarisë mësimore-educative	1. Në veprimtaritë ditore respektohen rregullat e alternimit të veprimtarive dhe të kombinimit të tyre.	1.1.1. Mësuesja zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: në grup të madh; në grup të vogël dhe individuale.				
		1.1.2. Mësuesja zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të lira; të sugjeruara dhe të drejtuara.				
		1.1.3. Mësuesja zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si ato që kërkojnë përqendrim e vëmendje apo çlodhëse.				
		1.1.4. Mësuesja zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, në mjedise të ndryshme (ulur, në këmbë, në pozicion çlodhës, në të njëjtin vend apo në vende të ndryshme); në një mjedis tjetër të kopshtit, brenda apo jashtë kopshtit.				
		1.1.5. Mësuesja zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të udhëhequra nga mësuesja e grupit apo të udhëhequra nga një person tjetër (prindi).				
		1.1.6. Mësuesja zbaton kohëzgjatjen e veprimtarive duke sugjeruar përdorimin e këndeve dhe lodrave, në funksion të moshës së fëmijëve.				
		1.1.7. Mësuesja zbaton veprimtari individuale të vëzhgueshme, duke dalluar shenjat e dukshme të lodhjes, të mungesës së interesit; zbehje, gogësima, shtriqje etj.				
	2. Në kopsht respektohen nevojat biologjike të fëmijëve.	1.2.1. Mësuesja zhvillon veprimtari për dhënien e njohurive të reja që kërkojnë përqendrim të vëmendjes dhe të kujtesës.				
		1.2.2. Njohuritë e reja dhe konceptet janë rrjedhojë e veprimtarive/eksperimenteve/investigimeve në vazhdimësi, duke e finalizuar informacionin e ri kryesisht në fund të javës, në fund të dy javëve apo në fund të muajit.				

		1.2.3. Mësuesja kërkon gjatë veprimtarive të përditshme mësimore angazhimin tërësor psikologjik të fëmijës, kryesisht në orarin 09:00-11:00.				
		1.2.4. Në kopshtin me drekë, mësuesja i organizon pasdite veprimtaritë që kërkojnë përdorim të theksuar të kujtesës për një kohë të gjatë.				
		1.2.5. Mësuesja organizon kohën e pushimit dhe gjumit ditor për më të vegjëlit, në mënyrë të tillë që: - të mos ngrihen herët nga gjumi, - të mos flenë vonë.				
		1.2.6. Mësuesja planifikon një pushim pas marrjes së ushqimit dhe rutinës higjienike, duke iu përshtatur ritmeve fiziologjike të fëmijëve, në funksion të nevojave individuale të tyre.				
		1.2.7. Mësuesja merr masa për të siguruar mirëqenien fizike të fëmijëve, duke krijuar kushte të përshtatshme të fjetjes dhe higjienës personale.				
		1.2.8. Mësuesja organizon një mjedis të përshtatshëm emocional dhe afektiv, duke i ofruar fëmijëve rehati, çlodhje, mjedis pa zhurmë, temperaturë të përshtatshme të mjedisit, zgjedhje personale e vendit nga vet fëmija apo praninë e një sendi apo lodre familjare për fëmijën.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Regjimi ditor dhe respektimi i ritmeve në një mjedis nxitës dhe bashkëpunues	1. Mjedisi fizik i modeluar është edukativ, nxitës dhe bashkëpunues.	2.1.1. Mësuesja ka përzgjedhur mjete, lodra dhe materiale të riciklueshme që nxitin interesin e fëmijëve për zbulim.				
		2.1.2. Mësuesja ka ekspozuar punën dhe produktet e fëmijëve në mjediset e grupit.				
		2.1.3. Mësuesja ka krijuar <i>Këndin e librit</i> me libra tërheqës dhe të pranueshëm për fëmijët.				

		2.1.4. Mësuesja ka ekspozuar në vende të ndryshme të grupit, libra dhe materiale të shkruara nga vet fëmijët.				
		2.1.5. Mësuesja përdor materiale alfabetike, etiketa pranë objekteve dhe sendeve, tabelën manjetike me shkronjat e alfabetit etj.				
		2.1.6. Mësuesja ka përzgjedhur materialet në përshtatje me moshën dhe prirjet e fëmijëve.				
		2.1.7. Mësuesja përdor një gamë të gjerë materialesh të dobishme për zhvillimin e të shprehurit krijues të fëmijëve, p.sh.: materiale për vizatim, për lojën simbolike etj.				
	2. Në zhvillimin e veprimtarive mësimore respektohen marrëdhëniet e sistemit, mjedisit dhe kohës.	2.2.1. Mësuesja ka përcaktuar zhvillimin e veprimtarive të ditës duke patur parasysh: a) kushtet e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të grupit, b) kohën që fëmijët kalojnë në kopsht, c) ndarjen dhe emërtimin e mjediseve të përbashkëta dhe të veçanta të kopshtit dhe ato jashtëklase.				
2.2.2. Mësuesja ka organizuar mjedisin e klasës në bazë të këndeve/qendrave të veprimtarisë, si: - Këndi/qendra e lexim-shkrimit, - Këndi/qendra e matematikës/shkencës (këndi/qendra e rërës, ujit), - Këndi/qendra e shtëpisë së kukullës, - Këndi/qendra e pushimit, - Këndi/qendra e kuzhinës etj. dhe i pasuron në vazhdimësi me mjete dhe materiale të ndryshme, sipas tematikave mësimore, projekteve që realizohen gjatë vitit mësimor-edukativ.						
2.2.3. Mësuesja shfrytëzon hapësirat e përcaktuara për veprimtarinë mësimore-edukative, p.sh.: përdor oborrin e kopshtit, gropën e rërës, lisharëset (nëse ka) për veprimtari të ndryshme fizike mësimore-edukative; lojëra						

	të ndryshme që lidhen me veprimtari të organizuara dhe të lira në dobi të veprimtarisë mësimore edukative.				
	2.2.4. Mësuesja përdor mjedisin e ngrënies për: <ul style="list-style-type: none"> - edukimin e zakoneve dhe stereotipeve që lidhen me përvetësimin e aftësive të shëndetshme të të ushqyerit; - shfrytëzimin e situatave kontekstuale në dobi të përvetësimit të shprehive dhe njohurive mësimore-edukative. 				
	2.2.5. Mësuesja përdor këndin e pushimit, të pajisur me jastëkë, dyshek dhe tapet për: <ul style="list-style-type: none"> - veprimtari shprehëse trupore; - dëgjim muzikor; - lexim; - fëmijën që nuk do ta lërë vetëm nëse e zë gjumi; - lojëra me lodra të madhësive të ndryshme. 				
	2.2.6. Mësuesja përdor këndin/qendrën e rërës dhe ujit për: <ul style="list-style-type: none"> - lojëra me ujë për fëmijët e vegjël; - eksperimente me ujin për zhvillimin shkencor të fëmijëve. 				
	2.2.7. Mësuesja përdor këndin/qendrën e kukullës për: <ul style="list-style-type: none"> - lojëra që lidhen me tualetin e kukullës, larjen e rrobave, gatimin; - interpretimin e përrallave; - shoqërizimin e fëmijëve. 				
	2.2.8. Mësuesja përdor atelienë e kopshtit (në rast se ka), për të gjitha veprimtaritë ekspresive dhe manipulative të fëmijëve në funksion të projekteve që zhvillohen.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Metodologjia e përdorur për zbatimin e veprimtarisë mësimore-educative	1. Kopshti zbaton planin vjetor, mujor dhe ditor për zhvillimin e kurrikulës.	3.1.1. Mësuesja harton planin vjetor në zbatim të objektivave, duke identifikuar konceptet themelore, aftësitë specifike dhe shprehitë.				
		3.1.2. Mësuesja synon në planifikimin kurrikular arritjen e objektivave nga të gjithë fëmijët.				
		3.1.3. Mësuesja planifikon duke u krijuar mundësi fëmijëve që të punojnë në nivele të ndryshme dhe në veprimtari të ndryshme, duke mos pritur që të gjithë fëmijët të bëjnë të njëjtat gjëra në të njëjtën kohë.				
		3.1.4. Mësuesja planifikon veprimtarinë mësimore-educative, duke u mbështetur në të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijës, si: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillimi social-personal; - zhvillimi gjuhësor; - zhvillimi matematikor; - zhvillimi shkencor; - zhvillimi artistik; - zhvillimi fizik-shëndetësor. 				
		3.1.5. Mësuesja e përgatit planifikimin, duke reflektuar për zbatimin e projekteve ose mësimëve tematike sipas: <ul style="list-style-type: none"> - fushave të veprimtarive; - njohurive, aftësive dhe kompetencave të integruara që duhen përvetësuar në këto fusha. 				
		3.1.6. Mësuesja organizon planifikimin ditor të punës me fëmijët, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - të gjithë fëmijët e grupit; - fëmijët në grupe të vogla; - ndërveprimin individual. 				
	2. Veprimtaritë mësimore-educative të zhvilluara në grupe/klasa orien-	3.2.1. Mësuesja ka krijuar klimë e zakone pozitive që në fillim të vitit e në vazhdimësi, duke bërë një pritje të ngrohtë dhe miqësore për fëmijët.				
		3.2.2. Mësuesja u ka krijuar mundësi fëmijëve, për veshje dhe zhveshje të qetë.				

tohen sipas standardeve dhe programeve të arsimit parashkollor.	3.2.3. Mësuesja ka vendosur tabela të kuptueshme me rregullat që duhet të respektohen për të mos krijuar konfuzion dhe çrregullime.				
	3.2.4. Mësuesja u kërkon vazhdimisht fëmijëve ruajtjen e të gjitha mjeteve dhe materialeve ku të gjithë të ndihen të përgjegjshëm.				
	3.2.5. Mësuesja u ka krijuar mundësi fëmijëve që të njihen me të gjitha mjediset e kopshtit dhe të rriturit që veprojnë në të.				
	3.2.6. Fëmijët njohin grupet e tjera nëpërmjet veprimtarive të zhvilluara për këtë qëllim (përveç njohjes spontane në oborrin e kopshtit).				
	3.2.7. Pjesën më të madhe të punës ditore, mësuesja ia kushton punës me grupe të vogla fëmijësh.				
	3.2.8. Mësuesja mban shënime për vëzhgimet që kryen dhe i përdor për planifikimin e veprimtarive edukative.				
	3.2.9. Mësuesja mban shënime për vëzhgimet që kryen dhe i përdor për çështje të përparimit të fëmijës.				
	3.2.10. Mësuesja zhvillon veprimtari edukative të nisura nga fëmijët dhe të strukturuar nga ajo.				
	3.2.11. Mësuesja organizon veprimtari të lira për grupin e parë të tilla, si: lojëra edukative, vizatim, shfletim i librave dhe i albumeve, kujdesi për lulet, vëzhgime të ndryshme, plotësim i tabelës për fëmijët që mungojnë etj.				
	3.2.12. Mësuesja organizon veprimtari të lira për grupin e dytë të tilla, si: identifikim i dëshirave spontane të fëmijëve, lojëra edukative, vizatim, shfletim i librave dhe i albumeve, kujdesi për lulet, vëzhgime të ndryshme, plotësim i tabelës për fëmijët që mungojnë etj.				
	3.2.13. Mësuesja organizon veprimtari të lira për grupin e tretë të tilla, si: vizatim i lirë, frekuentimi i këndit të librit, lojëra edukative, vizatim, shfletim i librave dhe i albumeve, kujdesi për lulet, vëzhgime të ndryshme, plotësimi i tabelës për fëmijët që mungojnë, plotësimi i kalendarit të ditës dhe motit etj.				
	3.2.14. Mësuesja zbaton veprimtari të organizuara për				

		takimin e mëngjesit, duke biseduar se çfarë do të bëjnë fëmijët gjatë ditës.				
		3.2.15. Mësuesja zbaton veprimtari të organizuara për plotësimin e kalendarit ditor dhe të motit.				
		3.2.16. Mësuesja zbaton veprimtari të organizuara në këndet e aktiviteteve dhe në atelie të tilla, si: veprimtari grafike, artistike, shkencore në fusha të ndryshme, veprimtari vëzhguese.				
		3.2.17. Mësuesja zbaton veprimtari të organizuara për zhvillimin e të folurit, të shkruarit, lojëra didaktike etj.				
		3.2.18. Mësuesja organizon veprimtari për zhvillimin e të menduarit, duke përdorur pyetje të hapura dhe të mbyllura me të gjithë fëmijët për të zhvilluar të menduarit e tyre.				
		3.2.19. Mësuesja drejton dhe lehtëson bashkëbisedimin midis fëmijëve, duke siguruar pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve në bashkëbisedim.				
		3.2.20. Mësuesja nxit fëmijët të marrin pjesë në veprimtari manipulative.				
		3.2.21. Mësuesja nxit fëmijët të bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët dhe me më të rriturit.				
		3.2.22. Mësuesja zhvillon lojëra duke u lejuar fëmijëve kohë dhe hapësira të mjaftueshme.				
		3.2.23. Mësuesja siguron objekte teatrale për lojërat e pretenduara.				
		3.2.24. Mësuesja i zhvillon veprimtaritë mësimore- edukative me materiale mbështetëse				
		3.2.25. Mësuesja tregon ose aktron histori të cilat janë familjare për fëmijët në mënyrë që ata ta "ritregojnë" vetë historinë.				
		3.2.26. Mësuesja ka siguruar një mjedis të pajisur mirë për lojën me kukulla, figura njerëzish dhe kafshësh, pranë këndit të caktuar etj.				
		3.2.27. Mësuesja ka pajisur këndet me mjete të lejueshme riciklimi për fëmijët, në mënyrë që ata të krijojnë vetë mjetet apo objektet teatrale.				

		3.2.28. Mësuesja u lë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme veprimtarive lëvizëse.				
		3.2.29. Mësuesja parashikon veprimtari lëvizëse në planifikimin e veprimtarive ditore.				
		3.2.30 Mësuesja përdor muzikën dhe këngën në planin dhe veprimtaritë ditore.				
		3.2.31. Mësuesja siguron vegla dhe instrumente të ndryshme, në mënyrë që fëmijët të luajnë.				
		3.2.32. Mësuesja u ka siguruar materiale fëmijëve për të krijuar veglat dhe instrumentet e tyre.				
		3.2.33. Mësuesja organizon lojëra ritmike, p.sh.: duke trokitur duart etj.				
		3.2.34. Mësuesja ka pajisur këndin e muzikës me varietete kasetash dhe kufjesh.				
		3.2.35. Mësuesja përdor muzikë apo këngë për sinjalet e përkohshme.				
		3.2.36. Mësuesja u krijon kohë dhe hapësirë të mjaftueshme fëmijëve, të ndërtojnë me materiale të ndryshme, po aq sa dhe të bëjnë punime artistike.				
		3.2.37. Mësuesja lejon fëmijët të eksplorojnë dhe të krijojnë me materialet artistike, si dhe i angazhon në projekte.				
		3.2.38. Mësuesja siguron një shumëllojshmëri letrash, tabelash, pajisjesh artistike ngjyruese etj., në mënyrë që të jenë të mjaftueshme dhe të arritshme për fëmijët.				
		3.2.39. Mësuesja siguron shumëllojshmëri lodrash, kubash në mënyrë që të jenë të mundshme për t'u përdorur nga një numër sa më i madh fëmijësh.				
		3.2.40. Mësuesja i fillon bisedat me fëmijët me çështje të rëndësishme për ta.				
		3.2.41. Mësuesja inkurajon ndërveprimin me fëmijët përgjatë gjithë ditës.				
		3.2.42. Mësuesja prezanton vazhdimisht tema të ndryshme për të inkurajuar pjesëmarrjen gojore të fëmijëve.				
		3.2.43. Mësuesja organizon në klasë veprimtari të tilla,				

	si: për të zgjidhur konfliktet, për të bërë listën e ushqimeve, për të votuar etj.				
	3.2.44. Mësuesja i orienton fëmijët se si duhet të pyesin dhe të përgjigjen.				
	3.2.45. Mësuesja këndon këngë ku fëmijët mund të shtojnë fjalë në to.				
	3.2.46. Mësuesja lexon dhe diskuton histori në grupe të vogla fëmijësh (2-3 fëmijë për grup).				
	3.2.47. Mësuesja siguron materiale për të prezantuar fjalë të reja e të kuptueshme për fëmijët.				
	3.2.48. Mësuesja krijon kushte që fëmijët të bashkëveprojnë më njëri-tjetrin përgjatë gjithë ditës.				
	3.2.49. Mësuesja vlerëson vazhdimisht pyetjet dhe përgjigjet e fëmijëve.				
	3.2.50. Mësuesja angazhon fëmijët në bashkëbisedime kokë më kokë.				
	3.2.51. Mësuesja ka organizuar një qendër shkrimi me shumë pajisje shkrimi.				
	3.2.52. Mësuesja ka vendosur shumëllojshmëri mjetesh të lejueshme për të shkruar (ngjyrues, lapsa me ngjyra, shkumësa, çfarëdo lloj letre, zarfe, fletore vizatimi, letra me magnet etj.).				
	3.2.53. Mësuesja përdor këmbalecë për të vizatuar, pikturuar dhe shkruar.				
	3.2.54. Mësuesja u krijon mundësi fëmijëve që të shkruajnë për qëllime të kuptimshme, si lista, letra falënderimi etj.				
	3.2.55. Mësuesja kompozon <i>librin e klasës</i> së bashku me fëmijët.				
	3.2.56. Mësuesja u kërkon fëmijëve të përshkruajnë vizatimet dhe i shkruan fjalët që fëmijët diktojnë, duke i lexuar disa herë.				
	3.2.57. Mësuesja i inkurajon fëmijët për t'iu përgjigjur historive, duke i lejuar të bëjnë pyetje të hapura ose të mbyllura.				
	3.2.58. Mësuesja angazhon fëmijët në bashkëbisedime rreth historive.				

		3.2.59. Mësuesja mban në bibliotekën e klasës për një vit të tërë, kopje të librave të pëlqyeshëm për fëmijët.				
		3.2.60. Mësuesja angazhon fëmijët në "të lexuarit e figurave" zinxhir.				
		3.2.61. Mësuesja lexon të njëjtin libër në kohë të ndryshme, duke përdorur teknika alternative.				
		3.2.62. Mësuesja u tregon fëmijëve rrjedhën e leximit nga e majta në të djathtë, duke treguar sesi kthehet faqja.				
		3.2.63. Mësuesja lexon histori në grupe të vogla fëmijësh, duke i dhënë secilit fëmijë kopjen e librit të tij për ta ndjekur.				
		3.2.64. Mësuesja organizon një kohë të "qetë" leximi të programuar në planin dhe veprimtarinë ditore.				
		3.2.65. Mësuesja përdor etiketa dhe nxit ndërgjegjësimin nëpërmjet etiketave dhe shenjave në mjedisin rrethues dhe përtej tij.				
		3.2.66. Mësuesja organizon "kohën e librit" për të nxjerrë librat që duhen lexuar apo duhen marrë në shtëpi.				
		3.2.67. Mësuesja siguron materiale me shenja për t'i eksploruar dhe ndërvepruar.				
		3.2.68. Mësuesja, bashkë me fëmijët, shkruan ditarin e klasës dhe e vendos në bibliotekën e klasës, por ai mund të merret nga fëmijët në shtëpi për të biseduar me familjarët e tyre.				
		3.2.69. Mësuesja krijon lojëra fjalësh.				
		3.2.70. Mësuesja përfshin fëmijët në të mësuarit e këngëve të ndryshme, lojërave nëpërmjet gishtave dhe rimave për fëmijë.				
		3.2.71. Mësuesja u mëson fëmijëve vjersha, duke ua përsëritur me zë të lartë.				
		3.2.72. Mësuesja luan bashkë me fëmijët lojëra me tinguj të ndryshëm, në mënyrë që të mësohen për të identifikuar tingujt.				
		3.2.73. Mësuesja vëzhgon çdo ditë fëmijët duke përfshirë dhe lojën.				
	3. Informimi dhe marrëdhëniet më-	3.3.1. Mësuesja këshillon prindërit për përdorimin në mjedisin familjar të librave dhe materiale të tjera didaktike.				

mesues-fëmijë-prind dhe anasjelltas janë pjesë e natyrshme e mbështetjes dhe e progresit të fëmijës.	3.3.2. Mësuesja i nxit prindërit t'u lexojnë libra fëmijëve të tyre, duke u rekomanduar disa mënyra leximi.				
	3.3.3. Mësueset e grupit bëjnë vizita në shtëpitë e fëmijëve, në përshtatje me qëllimet edukative të programit.				
	3.3.4. Mësuesja mirëpret informacionin e prindërve rreth vëzhgimeve të tyre për zhvillimin gjuhësor dhe njohës të fëmijës dhe e përdor këtë informacion për vlerësimin dhe planifikimin e punës në vazhdimësi.				
	3.3.5. Mësuesja fton prindërit, në varësi të profesionit, për veprimtari të përbashkëta.				

STANDARDI

Mësuesja programon planifikimin vjetor në zbatim të objektivave, duke identifikuar konceptet themelore, aftësitë specifike dhe shprehite që rekomandohen në programin shtetëror të kopshteve për grupmoshën përkatëse, si edhe duke respektuar rekomandimet e udhëzuesve zyrtarë të MASH-it. Mësuesja, në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarisë mësimore-edukative, mbështetet në arritjen e objektivave nga të gjithë fëmijët, duke i mundur të punojnë në nivele dhe në veprimtari të ndryshme dhe, duke mos pritur që ata të bëjnë të njëjtat gjëra në të njëjtën kohë. Veprimtaria mësimore-edukative mbështetet në të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijës, duke reflektuar për zbatimin e projekteve ose mësimëve tematike sipas fushave të veprimtarive, njohurive, aftësive dhe kompetencave të integruara që duhen përvetësuar në këto fusha. Mësuesi organizon planifikimin ditor të punës me fëmijët duke përfshirë të gjithë klasën, grupin e vogël dhe ndërveprimin individual në një mjedis nxitës dhe bashkëpunues, në përputhje me regjimin ditor dhe ritmet individuale të fëmijëve.

NIVELI 1

Mësuesja paraqet në planifikimin ditor konceptet themelore, aftësitë specifike dhe shprehite që do të fitojnë fëmijët, të lidhura ngushtë me fushat e zhvillimit kurrikular për grupmoshën përkatëse. Mësuesja bashkëvepron gjatë gjithë ditës me fëmijët duke respektuar nevojat e tyre individuale. Krijon një klimë të ngrohtë dhe miqësore për sigurimin e kushteve të mirërritjes dhe zhvillimit social, intelektual dhe emocional të fëmijëve. Zhvillon veprimtari të ndryshme për të nxitur dhe për të ndërtuar një vetëvlerësim pozitiv të fëmijës.

Ndihmon fëmijët për të identifikuar ndjenjat dhe emocionet që ata kanë, për të kapërcyer ndjenjat negative (zemërimin, trishtimin, egoizmin, izolimin etj.). Mësuesja ndihmon fëmijët të pasurojnë njohuritë e tyre rreth botës që i rrethon, si dhe të fitojnë aftësi dhe pavarësi në veprimet e tyre të jetës së përditshme, përgjatë vëzhgimeve të regjistruara dhe të sistemuara në dosjen e vlerësimit për secilin fëmijë, duke i përdorur rregullisht.

NIVELI 2

Pasqyrimet në planifikimin vjetor japin ide të qarta për konceptimin mujor dhe javor. Metodatat e përdorura për mësimdhënien janë të larmishme dhe përgjithësisht mbajnë parasysh gjendjen e fëmijëve dhe veçoritë psiko-individuele të tyre. Në përgjithësi, mësuesja bashkëvepron me fëmijët, por jo në të gjitha rastet respekton nevojat dhe dëshirat individuale të tyre. Zhvillon veprimtari të ndryshme për të nxitur dhe për të ndërtuar një vetëvlerësim pozitiv të fëmijës. Ka përpjekje të mira edhe për të nxitur fëmijët të bashkëpunojnë, të cilat në përgjithësi vlerësohen. Mjedisi fizik i klasës është në funksion të zhvillimit të veprimtarive të përzgjedhura. Mësuesja lidh në mënyrë të natyrshme bazën didaktike me veprimtarinë mësimore-edukative për pjesëmarrje aktive të fëmijëve. Mësuesi përpiqet për krijimin e mjedisit mësimor nxitës dhe bashkëpunues për fëmijët, por këto përpjekje nuk janë sistematike dhe të vazhdueshme. Vëzhgimet për fëmijët regjistrohen rregullisht, por nuk përdoren për të përmirësuar dhe përshtatur punën mësimore-edukative me secilin fëmijë.

NIVELI 3

Pasqyrimet në planifikimin vjetor janë të sakta, por nuk lidhen me veprimtaritë mësimore-edukative të zbatuara gjatë javës dhe ditës. Metodatat e mësimdhënies dhe të të nxënies nuk janë të tilla që të ndihmojnë fëmijët për arritjen e objektivave mësimore-edukative, duke krijuar gjendje monotone në klasë. Megjithatë mësuesja bashkëvepron herë pas here me të gjithë fëmijët, në grupe të vogla apo individë, në përgjithësi nuk nxit të mësuarit bashkëpunues, duke sjellë apati tek fëmijët, pasi kërkon të njëjtën punë të realizohet në të njëjtën kohë nga të gjithë. Mjedisi fizik i klasës nuk është i përshtatshëm në funksion të veprimtarive dhe tematikave që do të realizojë. Nuk i lehtëson fëmijët për të eksploruar duke ua frenuar iniciativën dhe ndërveprimin. Tërësia e veprimtarive përputhet rastësisht me interesat dhe prirjet e fëmijëve. Mësuesja vëzhgon spontanisht dhe nuk shënon në kohën dhe momentin e duhur. Informacioni i regjistruar është i papërshtatshëm dhe jo shumë i dobishëm.

NIVELI 4

Nuk ka përpjekje për të pasqyruar në planifikimin vjetor konceptet themelore, aftësitë specifike dhe shprehjet që do të fitojnë fëmijët, të lidhura ngushtë me fushat e zhvillimit kurrikular për grupmoshën përkatëse. Metodatat e mësimdhënies dhe të të nxënies nuk ndihmojnë fëmijët për arritjen e objektivave mësimorë-educativë, duke krijuar gjendje monotone në klasë. Nuk ka dinamikë në realizimin e veprimtarive, pasi nuk përputhet me interesat dhe prirjet e fëmijëve. Mungon bashkëveprimi dhe dialogu me fëmijët apo me grupet e vogla, duke kërkuar të njëjtën punë të realizohet në të njëjtën kohë nga të gjithë. Mungojnë përpjekjet për krijimin e një klime pozitive në klasë. Mjedisi fizik i klasës nuk është i përshtatshëm në funksion të veprimtarive dhe tematikave që do të realizohen. Nuk i lehtëson fëmijët për të eksploruar duke ua frenuar iniciativën dhe ndërveprimin. Vëzhgimi është rastësor dhe i pasistemuar. Informacioni i grumbulluar është jo vetëm i pamjaftueshëm, por edhe i pavlefshëm për të përgjithësuar zhvillimin e fëmijës për grupmoshën përkatëse.

FUSHA III. DREJTIMI/MENAZHIMI I KOPSHTIT

Kopshti është një institucion arsimor që administron shumë probleme dhe në veçanti, zbatimin e kurrikulës së arsimit parashkollor. Që të kemi një arsim parashkollor cilësor, rol të pazëvendësueshëm luan drejtimi apo menazhimi profesional i një kopshti. Për vetë natyrën e funksionimit të kopshtit, edhe menazhimi i tij është i veçantë. Fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç që frekuentojnë arsimin parashkollor, gjatë periudhës së kopshtit, jo vetëm marrin njohuritë fillestare dhe bazë për një të nxënë cilësor, por përvetësojnë edhe elementet e para të sjelljes, të shoqërizimit, të etikës së të ngrënit, të higjienës, të fjetjes etj. Një menazhim do të quhet i suksesshëm, kur përfshihen të gjithë aktorët e interesuar dhe kur realizohet një bashkëpunim midis:

- 1) drejtueses, mësueseve dhe fëmijëve;
- 2) mësueseve të kopshtit me njëra-tjetrën;
- 3) drejtueses, mësueseve dhe prindërve të fëmijëve.

Menazhimi i mirë i kopshtit vihet re kur realizohen objektivat e parashikuara në planifikimin vjetor. Fusha e menazhimit të kopshtit përfshin 7 nënfusha të tjera, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën dhe, nëpërmjet kombinimit të tyre, realizohet një menazhim i mirë i kopshtit.

Nënfushat

I. Plani vjetor i kopshtit nënkupton një planifikim vjetor për të gjitha aspektet e funksionimit të një institucioni parashkollor. Plani vjetor ndërtohet pas analizës së vitit të kaluar, duke patur parasysh arritjet dhe mangësitë e vitit të mëparshëm. Plani vjetor duhet të hartohet sipas rubrikave të rekomanduara nga institucionet përgjegjëse, si DAR/ZA-ja. Objektivat e vendosura duhet të jenë të matshëm dhe të realizueshëm. Drejtuesja e një kopshti duhet të ketë të paktën planet vjetore të 2-3 viteve të fundit. Kështu, ajo mund të krahasojë objektivat dhe të bëjë bilancin se çfarë kanë realizuar dhe çfarë nuk kanë mundur të realizojnë, për ta marrë parasysh në vitin në vazhdim.

II. Plani i vëzhgimeve të procesit mësimor dhe edukativ përfshin realizimin e objektivave për mbarëvajtjen e veprimtarisë njohëse-edukative, evidentimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme të tyre, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës aty ku mendohet se ky përmirësim është i mundshëm dhe duhet zbatuar. Format që do të ndiqen duhet të jenë të larmishme dhe të studiuara. Ndër to mund të përmendim:

- a. *Vëzhgime* gjatë aktivitetit ditor dhe veprimtarive edukative;
- b. *Testime*, sondazhe gojore, anketime e pyetësorë;
- c. *Kontrolle* sistematike të përgatitjes ditore;
- d. *Tërheqja e mendimeve* të mësueseve, të komunitetit të prindërve dhe të Bordit të Kopshtit;
- e. *Kontrolle të dokumentacionit* të mësueseve (plane, ditare, regjistra, fletore vëzhgimi etj.).

III. Dokumentacioni i regjistrimit, statistikave dhe transferimet e fëmijëve kanë të bëjnë me dokumentacionin e regjistrimit sipas standardit të regjistrimit të DAR/ZA-së dhe Dispozitave Normative (certifikata e lindjes; kartela e vaksinimit; analizat e përcaktuara nga mjekja). Gjithashtu, drejtuesja e kopshtit duhet të mbajë të sakta dhe të rregullta statistikave dhe transferimet e ndryshme të fëmijëve.

IV. Zhvillimi profesional i stafit. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së mësimdhënies kërkon trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit pedagogjik dhe atij ndihmës në kopshte. Kjo punë do të synojë që mësueset të zhvillojnë një veprimtari mësimore-edukative, të konceptuar si përpjekje e përbashkët mësuese-fëmijë-prindër. Zhvillimi profesional i stafit do të realizohet nëpërmjet trajnimit të brendshëm në kopsht, por edhe përmes veprimtarive me aktorë dhe institucione të specializuara. Trajnimi mbështetet dhe përmes pjesëmarrjes së mësueseve dhe drejtueseve të kopshtit në rrjetet lokale të zhvillimit profesional, përmes trajnimeve të organizuara nga DAR/ZA-ja, përmes studimit të botimeve profesionale, por dhe përmes materialeve didaktike apo informacionet e revistës "Mësuesi".

V. Bashkëpunimi me psikologun, mjekun dhe punonjës social. Trajtimi dhe kujdesi i fëmijës nga psikologu dhe mjeku është i nevojshëm në këtë cikël arsimor. Në kuadrin e përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2005-2015, ndër masat që parashikohen janë: "...*instalimi i shërbimit psiko-social me specialistë të mirëfilltë dhe krijimi i ekipeve me mësuese me reputacion, të udhëhequra nga specialistë të shërbimit psikologjik me prindër dhe përfaqësues të pushtetit....*". Përveç shërbimit të mjekut, në vitin 2005, në arsimin parashkollor u fut për herë të parë shërbimi i psikologut dhe punonjës social. Monitorimi i këtij shërbimi do të shihet në disa aspekte:

- Çfarë kanë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë (por sidomos mënyra se si kanë përfituar) fëmijët e këtyre grupmohave nga këto lloj shërbimesh?

- Përfitimet që kanë stafet pedagogjike (drejtueset dhe mësueset) dhe ato ndihmëse.

- Çfarë ndryshimesh vënë re prindërit te fëmijët e tyre, pas futjes së këtij shërbimi?

- Ndikimet pozitive që vihen re në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë, në procesin e të mësuarit dhe përvetësimit të njohurive fillestare për fëmijët e grupmohave 3-6 vjeç.

VI. Menazhimi i të ardhurave të kopshtit ka të bëjë me mënyrën e menazhimit të të ardhurave që mund të ketë kopshti, nga kontributi vullnetar i prindërve apo donacione nga të tretë. Është një pikë shumë e debatueshme ndaj së cilës janë të ndjeshëm të gjithë pjesëmarrësit në jetën e kopshtit. Prandaj monitorimi (inspektimi) i saj duhet të jetë në të gjitha aspektet e menazhimit të këtyre të ardhurave.

VII. Dokumentacioni i inventarit të kopshtit. Çdo institucion parashkollor ka inventarin e bazës materiale, që shërben për realizimin sa më mirë të veprimtarisë mësimore-edukative. Për të gjitha këto mbahet një inventar i detajuar, në bashkëpunim me pushtetin vendor.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Plani vjetor i kopshtit	1. Kopshti ndërton veprimtarinë e tij duke u mbështetur në planin vjetor.	1.1.1. Drejtuesja ka hartuar planin vjetor.				
		1.1.2. Drejtuesja ka hartuar planin edukativ.				
		1.1.3. Planet janë miratuar nga DAR/ZA-ja dhe nga Bordi i Kopshtit.				
		1.1.4. Plani vjetor është hartuar në përputhje me formatin e rekomanduar.				
		1.1.5. Është përcaktuar motoja që do të ndjekë kopshti.				

		1.1.6. Synimi kryesor i kopshtit është përcaktuar qartë.				
		1.1.7. Në plan është bërë një vlerësim i përgjithshëm i situatës së kopshtit.				
		1.1.8. Plani vjetor përmban në mënyrë të qartë dhe të hollësishme analizën SWOT (pikat e forta; pikat e dobëta; mundësitë për ndryshim dhe rrisqet).				
		1.1.9. Përparësitë (ose prioritet) e parashikuara në plan përputhen me nevojat reale të kopshtit për përmirësim të mëtejshëm.				
		1.1.10. Objektivat e planit vjetor janë të matshëm dhe në përputhje me gjendjen aktuale të kopshtit.				
		1.1.11. Objektivat e planit vjetor të kopshtit janë hartuar duke patur parasysh arritjet dhe dobësitë e vitit të kaluar.				
		1.1.12. Objektivat e planit janë njohur nga personeli dhe prindërit.				
		1.1.13. Plani vjetor është njohur nga personeli pedagogjik, personeli ndihmës dhe prindërit.				
		1.1.14. Në zbatimin e planit vjetor të kopshtit janë përfshirë personeli pedagogjik, personeli ndihmës dhe prindërit e fëmijëve.				
		1.1.15. Janë parashikuar aktivitetet sipas fushave për të realizuar objektivat kryesorë të kopshtit.				
		1.1.16. Janë parashikuar aktivitetet për bashkëpunimin me komunitetin e prindërve.				
		1.1.17. Në planin vjetor janë parashikuar tema kualifikimi për çdo muaj, nga stafi i kopshtit ose të tjerë.				
		1.1.18. Drejtuesja ka hartuar rregulloren e brendshme të kopshtit.				
		1.1.19. Në planin vjetor janë parashikuar temat e vëzhgimit tematik dhe operativ sipas muajve.				
		1.1.20. Plani vjetor është zbrëthyer në plane mujore.				
		1.1.21. Plani vjetor është i zbatueshëm.				
		1.1.22. Në kopsht janë planet vjetore të 2-3 viteve të fundit.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Plani i vëzhgimeve të procesit mësimor-educativ	1. Drejtuesja e kopshtit kryen vëzhgime në vijimësi, sipas planit.	2.1.1. Sasia e orëve të vëzhgimeve, të planifikuara nga drejtuesja, përputhet me udhëzimet e MASH-it dhe DAR/ZA-së (12 orë vëzhgime tematike + 12 orë vëzhgime të orientuara).				
		2.1.2. Temat e vëzhgimit tematik, të parashikuara nga drejtuesja, lidhen drejtpërdrejt me objektivat e planit vjetor.				
		2.1.3. Drejtuesja ka realizuar sasinë e orëve të parashikuara të vëzhgimit tematik dhe të orientuar.				
		2.1.4. Bëhet rregullisht analiza dhe vlerësimi i vëzhgimeve tematike dhe të orientuara.				
		2.1.5. Drejtuesja ka dhënë sugjerime me shkrim për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.				
		2.1.6. Është ndjekur puna për përmirësimin e dobësive të konstatuara.				
		2.1.7. Drejtuesja ka kontrolluar planifikimin vjetor, mujor dhe ditor të mësueseve.				
		2.1.8. Drejtuesja e kopshtit kontrollon vazhdimisht plotësimin e regjistrave të grupeve sipas formatit të rekomanduar.				
		2.1.9. Drejtuesja kontrollon përputhjen e numrit të fëmijëve në grupe me <i>forcën</i> e deklaruar në kuzhinë.				
		2.1.10. Drejtuesja e kopshtit përdor një format standard për vëzhgimin e veprimtarisë mësimore-educative të mësueseve.				
		2.1.11. Drejtuesja e kopshtit ka identifikuar mësueset e suksesshme dhe ka ndarë përvojën e tyre pozitive me stafin.				
		2.1.12. Drejtuesja përdor të dhënat e mbledhura gjatë vëzhgimeve për vlerësimin e veprimtarisë së kopshtit.				
		2.1.13. Drejtuesja kontrollon vazhdimisht higjienën në të gjithë kopshtin.				
		2.1.14. Drejtuesja monitoron pagesat e fëmijëve, vijueshmërinë e tyre dhe përputhjen e numrit të fëmijëve me regjistrin.				

		2.1.15. Librezat shëndetësore të personelit pedagogjik dhe ndihmës janë brenda afatit të lejuar.				
		2.1.16. Drejtuesja kontrollon vazhdimisht zbatimin me korrektësi të menusë (është gatuar sipas menusë së përcaktuar; gramaturës së ushqimit) dhe cilësinë e gatimit.				
		2.1.17. Drejtuesja kontrollon vazhdimisht cilësinë e ushqimeve dhe raporton për probleme ose e kthen ushqimin nëse nuk është sipas standardeve.				
		2.1.18. Drejtuesja bën testime të herëpashershme për përputhjen e <i>forcës</i> së kuzhinës me numrin e fëmijëve në grupe dhe me sasinë e ushqimit të gatuar, sipas gramaturave të përcaktuara për një fëmijë.				
		2.1.19. Drejtuesja monitoron dhe firmos procesverbalet e tepricave të ushqimeve.				
		2.1.20. Drejtuesja kontrollon vazhdimisht mbajtjen e kampioneve të ushqimeve në kuzhinë.				
		2.1.21. Menuja ditore është e afishuar në mjediset e përbashkëta të kopshtit.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Dokumentacioni i regjistrimit, statistikat dhe transferimet e fëmijëve	1. Drejtuesja e kopshtit mban dokumentacion të rregullt të regjistrimeve, statistikave, gjendjes sociale të fëmijëve, ditëngrënies, transferimeve etj.	3.1.1. Drejtuesja e kopshtit ka të plotë dokumentacionin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht: certifikatë; kartelë vaksinimi dhe analizat e përcaktuara nga mjekja.				
		3.1.2. Drejtuesja ka nga një kopje të parashikimeve (planeve) vjetore e mujore, sipas grupeve.				
		3.1.3. Drejtuesja ka ruajtur regjistrat, të paktën, e 2 viteve të fundit.				
		3.1.4. Drejtuesja ka të dokumentuara ditëngrëniet e fëmijëve (gjatë dy viteve të fundit).				
		3.1.5. Drejtuesja ka statistika të sakta për fëmijët e kopshtit (meshkuj-femra; fëmijë me AK; fëmijë me një prind; romë; egjiptianë etj.).				
		3.1.6. Drejtuesja ka dokumente të rregullta për				

		transferimet, pranimet e reja apo largimet e fëmijëve nga kopshti.				
		3.1.7. Drejtuesja ka një listë me të dhënat e bordit dhe dokumentimin e takimeve me Bordin e Prindërve.				
		3.1.8. Drejtuesja ka dosje me të dhënat personale të mësueseve të kopshtit (CV; fotokopje diplome; fotokopje certifikatash të ndryshme etj.).				
		3.1.9. Drejtuesja ka përpunuar të dhënat statistikore të fëmijëve, sipas formatit të kërkuar nga DAR/ZA-ja dhe i ka dërguar ato brenda afatit në institucionet që i kanë kërkuar.				
		3.1.10. Drejtuesja ka të plotë dosjen e komunikimeve me MASH-in dhe DAR/ZA-në (posta; shkresa të hyra ose të dala; informacione etj.).				
		3.1.11. Drejtuesja ka të dokumentuar komunikimin me pushtetin lokal për probleme të ndryshme, që kanë lidhje me kompetencat e pushtetit lokal në kopshte.				
		3.1.12. Drejtuesja ka krijuar një dosje me materiale të komunikimit me prindërit.				
		3.1.13. Drejtuesja ka krijuar dosjen e bashkëpunimeve me OJF-të (nëse ka bashkëpunime).				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Zhvillimi profesional i stafit	1. Drejtorja e kopshtit zhvillon trajnime dhe mbështet kualifikimin e stafit.	4.1.1. Kopshti ka identifikuar nevojat që ka personeli pedagogjik për trajnim dhe kualifikim.				
		4.1.2. Drejtorja e kopshtit ka hartuar një plan për trajnimin e stafit pedagogjik apo atij ndihmës.				
		4.1.3. Drejtuesja përdor forma për të nxitur bashkëpunimin dhe punën në grup midis mësueseve.				
		4.1.4. Mësueset janë të trajnuara për zhvillimin e fëmijërisë së hershme.				
		4.1.5. Mësueset i njohin dokumentet bazë ku mbështetet veprimtaria e kopshtit (Dispozitat Normative; standardet				

		e përmbajtjes dhe të arritjes; programet e arsimit parashkollor; udhëzimet e MASH-it etj.).				
		4.1.6. Mësueset janë të trajnuara për vëzhgimin dhe vlerësimin e fëmijëve të grupit.				
		4.1.7. Drejtuesja ndjek zhvillimin e trajnimeve çdo muaj, sipas temave dhe personave përgjegjës (të përcaktuar në planin vjetor të drejtorisë).				
		4.1.8. Drejtuesja mbështet dhe inkurajon mësueset e reja për zhvillimin profesional të tyre.				
		4.1.9. Drejtuesja përfshin në trajnime specifike edhe personelin ndihmës, si: kuzhinierë, ndihmëskuzhinierë dhe punëtorë.				
		4.1.10. Stafi pedagogjik kryen rregullisht takime një herë në javë, për të diskutuar për zhvillimin e fëmijëve dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Bashkëpunimi me psikologun, mjekun dhe punonjës social	1. Drejtorja e kopshtit bashkëpunon ngushtë me mjekun, psikologun dhe punonjës social të kopshtit, për të rritur cilësinë e mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve.	5.1.1. Kopshti ka mjedisin që shfrytëzohet nga mjekja, psikologjia apo punonjësja sociale.				
		5.1.2. Drejtuesja e kopshtit dhe mësueset, në bashkëpunim me mjekun, ndjekin rregullisht ecurinë e fëmijëve (libri i të dhënave mjekësore të fëmijëve të kopshtit, si: gjatësia, lartësia, pesha, perimetri i kokës, kraharorit etj.).				
		5.1.3. Drejtuesja dhe mësueset, në bashkëpunim me mjekun, kanë zhvilluar takime informuese ose trajnuese (të dokumentuara) me prindërit e fëmijëve.				
		5.1.4. Drejtuesja dhe mësueset, në bashkëpunim me mjekun, kanë zhvilluar trajnime me stafin pedagogjik për zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve.				

		5.1.5. Drejtuesja dhe mësueset, në bashkëpunim me mjeken, kanë zhvilluar trajnime me stafin ndihmës për higjienën e cilësinë e gatimit (në kopshtet me ushqim).				
		5.1.6. Psikologjia e kopshtit ka bërë vlerësimin e fëmijëve të kopshtit.				
		5.1.7. Psikologjia e kopshtit ka identifikuar fëmijët me probleme (nëse ka të tillë) dhe ka hartuar PEI-n për çdo fëmijë, i cili njihet nga drejtuesja, mësuesja dhe prindi.				
		5.1.8. Psikologjia ka zhvilluar takime informuese me prindërit e fëmijëve dhe mësueset e kopshtit.				
		5.1.9. Psikologjia ka zhvilluar tema trajnime me stafin dhe prindërit.				
		5.1.10. Drejtuesja, në bashkëpunim me punonjësen sociale të kopshtit, ka identifikuar fëmijët me probleme sociale.				
		5.1.11. Punonjësja sociale ka hartuar një plan bashkëpunimi me prindërit, drejtuesen dhe mësueset për zbutjen e këtyre problemeve.				
		5.1.12. Drejtuesja e kopshtit ka miratuar planin vjetor dhe mujor të psikologes dhe punonjësës sociale.				
		5.1.13. Mjekja, psikologjia dhe punonjësja sociale bashkëpunojnë me mësueset dhe prindërit, duke shkëmbyer informacion mes tyre.				
		5.1.14. Mjekja, psikologjia dhe punonjësja sociale kanë ndërtuar në kopsht standën me materiale informuese për prindërit dhe të interesuarit e tjerë.				
		5.1.15. Drejtuesja ka zhvilluar pyetësorë, anketime apo intervista me prindërit për të matur cilësinë e shërbimit të ofruar nga mjekja, psikologjia apo punonjësja sociale.				
		5.1.16. Drejtuesja monitoron zbatimin e planeve të psikologes e punonjësës sociale dhe realizimin e objektivave të tyre.				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Menazhimi i të ardhurave të kopshtit	1. Drejtoria e kopshtit, në bashkëpunim me Bordin e Prindërve, menazhon të ardhurat e kopshtit.	6.1.1. Plani për mbledhjen dhe menazhimin e të ardhurave sipas prioriteteve të kopshtit ka marrë miratimin e Bordit të Prindërve.				
		6.1.2. Drejtoria e kopshtit dhe kryetari i Bordit të Prindërve kanë dokumentacion të rregullt (me fatura ose numër llogarie) me anën e të cilit vërtetojnë mbledhjen e kontributit vullnetar nga prindërit apo donacionet nga të tretë.				
		6.1.3. Shpenzimet janë kryer me procesverbale dhe fatura blerjeje.				
		6.1.4. Në blerje ka marrë pjesë një anëtar i Bordit të Prindërve, një mësuese dhe drejtuesja e kopshtit.				
		6.1.5. Në mjediset e përbashkëta të kopshtit është vendosur “Këndi i transparencës”.				
		6.1.6. Janë identifikuar nevojat e kopshtit dhe të grupeve.				
		6.1.7. Drejtuesja, në bashkëpunim me mësueset dhe Bordin e Prindërve, ka hartuar listën me materialet që duhen për një fëmijë gjatë një viti shkollor.				
		6.1.8. Nga Bordi i Prindërve është marrë vendimi për pagesën e rojes, të shoqëruara me procesverbalet e pagesave të çdo muaji.				
		6.1.9. Me vendimin e Bordit të Prindërve është krijuar komisioni i blerjeve të vogla.				
		6.1.10. Drejtuesja ka dokumentuar shpenzimet e kryera me procesverbalet dhe faturat përkatëse, të firmosura nga komisioni i blerjeve të vogla dhe nga kryetari i Bordit të Prindërve (këto blerje nuk duhet ta kalojnë vlerën e 10.000 lekëve).				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Dokumentacioni i inventarit të kopshtit	1. Drejtoria e kopshtit mban të rregulltë dhe të saktë dokumentacionin e inventarit të kopshtit.	7.1.1. Kopshti ka inventarin e tij, të dokumentuar.				
		7.1.2. Inventari bëhet çdo vit nga një komision i posaçëm.				
		7.1.3. Inventari paraqitet në librin e inventarit (një kopje e ka drejtuesja).				
		7.1.4. Libri i inventarit ruhet për 10 vjet në kopsht.				
		7.1.5. Libri i inventarit përfshin të gjitha materialet që gjenden në mjediset e brendshme apo të jashtme të kopshtit.				
		7.1.6. Drejtuesja bashkëpunon me pushtetin lokal dhe DAR/ZA-në për plotësimin e inventarit.				
		7.1.7. Drejtuesja ka përgjegjësi juridike për ruajtjen e inventarit të kopshtit.				
		7.1.8. Libri i inventarit është dokument transparent për çdo të interesuar.				
		7.1.9. Zhdëmtimet e materialeve të ndryshme janë bërë sipas ligjit.				
		7.1.10. Dorëzimi i inventarit nga një drejtuese në një tjetër është bërë me procesverbal dhe me komision.				
		7.1.11. Drejtuesja ka hartuar inventarin e grupeve, të kuzhinës dhe të mjediseve të tjera dhe ia dorëzon me firmë personave përgjegjës (mësuese; kuzhinierë; punëtorë etj.).				
		7.1.12 Të gjitha materialet që janë blerë nga kontributi vullnetar i prindërve kanë hyrë në librin e inventarit.				

STANDARDI

Kopshti shfaq dukshëm një kulturë të menazhimit profesional. Kopshti zbaton planin vjetor, i cili hartohet në përputhje me nevojat e tij, pas një analize të hollësishme të objektivave dhe problematikave të realizuara ose jo në vitin e kaluar. Në menazhimin e kopshtit përfshihen të gjithë aktorët e interesuar për veprimtarinë e tij, si: mësueset, komuniteti i prindërve, Bordi i Prindërve dhe pushteti lokal. Drejtorja e kopshtit monitoron në mënyrë të vazhdueshme realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative dhe plotësimin e regjistrave, statistikave, librit të kuzhinës, procesverbalet e ushqimeve etj., sipas udhëzimeve përkatëse. Kopshti ka statistika të rregullta dhe dokumente të plota për fëmijët e regjistruar në të apo për lëvizjet e tyre. Dokumentet e drejtueses apo të mësueseve duhet të jenë të sakta dhe sipas udhëzimeve të MASH-it dhe DAR/ZA-së.

NIVELI 1

Kopshti duket qartë që menazhohet me profesionalizëm. Harton planin vjetor sipas formatit të kërkuar nga DAR/ZA-ja. Kopshti ka bërë analizën “SWOT”, duke identifikuar nevojat dhe duke përcaktuar prioritetet. Kopshti i ka të qarta objektivat që do të realizojë për vitin akademik. Kopshti ka listën dhe dokumentet e regjistrimit të fëmijëve nga DAR/ZA-ja. Numri i fëmijëve të regjistruar përputhet me numrin e fëmijëve në grupe. Drejtuesja e kopshtit ka realizuar numrin e orëve të përcaktuara për vëzhgimin e procesit mësimor-edukativ. Janë bërë konkluzione me shkrim për dobësitë e vërejtura. Ndihet dukshëm puna në grup e stafit të kopshtit me komunitetin e prindërve dhe aktorë të tjerë të interesuar për jetën e kopshtit.

NIVELI 2

Kopshti zbaton planin vjetor dhe ka realizuar objektivat e parashikuara në të. Kopshti, në bashkëpunim me stafin pedagogjik dhe Bordin e Prindërve, ka përcaktuar nevojat dhe ka hartuar prioritetet e viti akademik. Drejtuesja e kopshtit ka realizuar orët e inspektimit tematik dhe operativ dhe ka mbikëqyrur në vazhdimësi realizimin e dobësive të vërejtura. Drejtuesja kontrollon vazhdimisht dokumentet që duhet të ketë mësuesja, si: regjistrin, planin vjetor, mujor e ditor, dokumentacionin e Bordit të Prindërve etj. Drejtuesja ka plotësuar me saktësi dhe brenda afateve statistikat e kërkuara nga DAR/ZA-ja. Bordi i Kopshtit përfshihet në jetën dhe në veprimtarinë e kopshtit rastësisht dhe jo vazhdimisht.

NIVELI 3

Kopshti bën përpjekje të vazhdueshme për realizimin e planit vjetor, por ka paqartësi në hartimin e objektivave dhe si rrjedhim edhe në realizimin e tyre. Kopshti nuk ka identifikuar qartë nevojat dhe prioritetet e

tij. Është realizuar plani i vëzhgimit tematik dhe të orientuar, por vërjetjet e bëra nuk janë në përputhje me normat zyrtare apo me temën e vëzhgimit të përcaktuar që më parë. Në veprimtarinë e kopshtit nuk janë përfshirë dhe nuk japin kontribut Bordi i Prindërve dhe të interesuar të tjerë për jetën e kopshtit. Nuk stimulohet puna në grup dhe kopshti nuk bën përpjekje për të krijuar një klimë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis prindërve dhe mësueseve. Kopshti ka nevojë për një plan masash për përmirësim të mëtejshëm të veprimtarisë së tij.

NIVELI 4

Kopshti ka dobësi të theksuara në hartimin e planit vjetor. Objektivat e përcaktuar në planin vjetor nuk janë të qartë, të matshëm dhe nuk përputhen me nevojat reale të kopshtit. Megjithëse kopshti përpiqet për të zbatuar planin vjetor, ka shumë mangësi në zbatimin e këtij plani. Drejtuesja e kopshtit është autoritare dhe jo bashkëpunuese me stafin e saj apo me prindërit. Planin e vëzhgimeve të procesit mësimor edukativ, drejtuesja e përdor si mjet kontrolli ose presioni ndaj mësueseve të kopshtit. Prindërit nuk janë të përfshirë në jetën e kopshtit dhe nuk kanë dijeni për aktivitetet që zhvillohen. Drejtuesja e kopshtit nuk mban statistika të rregullta dhe nuk ka dokumente të sakta për fëmijët e regjistruar.

FUSHA IV. KUJDESI NDAJ FËMIJËS NË KOPSHT

Jeta dhe shëndeti janë parësore në mirërritjen e fëmijës gjatë arsimit parashkollor. Prindërit, kur çojnë fëmijët në kopsht, presin që jo vetëm të edukohen, por më shumë që të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur. Në radhë të parë, kopshti duhet të kujdeset për shëndetin e tyre. Edhe në standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor theksohet se *krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe të shëndetshëm është prioritar. Asnjë kurrikul cilësore, asnjë bashkëveprim i rritur-fëmijë nuk mund të kompensojë një mjedis që është i rrezikshëm për fëmijët. Synimi kryesor i programeve të fëmijërisë së hershme është parandalimi i aksidenteve dhe i sëmundjeve, përgatitja e personelit të kopshtit, për të zgjidhur situatat e emergjencës dhe edukimin e fëmijëve në funksion të praktikave të sigurisë dhe të shëndetit*".⁹

Për vetë natyrën e funksionimit të kopshteve, ku fëmijët jo vetëm mësojnë, por edhe hanë apo flenë, kujdesi ndaj fëmijëve duhet të përfshijë edhe parandalimin e aksidenteve apo sëmundjeve. Nga ana tjetër, stafi i kopshteve duhet të jetë i përgatitur që t'i përballojë me qetësi dhe në mënyrë të organizuar, situatat

9). Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor, Tiranë 2002, faqe 31.

urgjente që mund të ndodhin dhe të dinë të japin ndihmën e parë në rast rreziku. Për të parandaluar këto situata, duhet të sigurohemi që mjedisi është i sigurtë, fëmijët mund të mësojnë dhe të luajnë lirshëm etj. Për të realizuar këtë, duhet që të ndërtohen marrëdhënie bashkëpunimi dhe besimi midis drejtueses së kopshtit, stafit pedagogjik dhe ndihmës, prindërve të fëmijëve, DAR/ZA-së dhe pushtetit vendor. Këtu nuk duhet harruar roli i mjekes, psikologes dhe punonjësës sociale të kopshtit. Siguria e jetës së fëmijëve duhet parashikuar edhe në rregulloren e brendshme të kopshtit. Kujdesi që duhet të tregojmë ndaj fëmijës në kopsht, përmbledh disa **nënfusha**:

- I. Siguria për jetën dhe shëndetin;
- II. Cilësia e ushqimit dhe e higjienës;
- III. Kujdesi për fëmijët që hyjnë për herë të parë në kopsht;
- IV. Kujdesi për fëmijët që kalojnë nga kopshti në klasë të parë;
- V. Kujdesi për fëmijët me prirje dhe nevoja të veçanta;
- VI. Respektimi i individualitetit të çdo fëmije;
- VII. Mjedisi i brendshëm fizik i kopshtit;
- VIII. Mjedisi i jashtëm fizik i kopshtit.

I. Siguria për jetën dhe shëndetin nënkupton një mjedis fizik të brendshëm dhe të jashtëm, të organizuar në funksion të sigurisë së jetës së fëmijëve. Mjedisi ku do të qëndrojnë fëmijët gjatë të gjithë ditës, ku do të zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor, duhet të ketë dritë të mjaftueshme, temperaturë të përshtatshme dhe ajër të pastër. Nëse konstatohet se mjedisi ku janë fëmijët paraqet rrezik, qoftë edhe për një çast të vetëm, atëherë gjithë vëmendja dhe energjitë e mësueseve duhet të përqendrohen, *së pari*, në ndihmën ndaj fëmijëve, sesa në punën për t'i mësuar se si të mbrohen. Kjo s' mund të lihet për më vonë.

II. Cilësia e ushqimit dhe e higjienës ka lidhje vetëm me kopshtet që janë me ushqim. Mënyra se si gatuhet ushqimi në kuzhinën e kopshtit, mënyra se si shërbehet dhe ngrënia nga fëmijët, nuk ka të bëjë thjesht me plotësimin e nevojave të ushqyerjes. Ky proces merr edhe një përmasë sociale, ngaqë gjatë vakteve të ngrënies, fëmijët komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me të rriturit, duke forcuar marrëdhëniet midis tyre. Rëndësi të veçantë stafet e kopshteve duhet t'i kushtojnë edhe servirjes së ushqimit dhe etikës së të ngrënit.

III. Kujdesi për fëmijët që hyjnë për herë të parë në kopsht. Momenti i kalimit nga çerdhja në kopsht ose i fëmijëve që vijnë për herë të parë në kopsht, është shumë i rëndësishëm në jetën e fëmijëve, pasi është një etapë e re në jetën e tyre. Përshtypja e parë zgjat përgjithnjë, kështu që, nëse kjo përshtypje do të

jetë e gabuar, mund të krijohen probleme individuale dhe psikologjike që ndikojnë thellë në personalitetin e fëmijës. Momenti i ardhjes për herë të parë në kopsht mund të shkaktojë stres e ankth, jo vetëm tek fëmijët, por edhe tek prindërit e tyre. Në mënyrë që kjo gjë të ndodhë sa më natyrshëm, duhet bërë një përgatitje e kujdesshme. Duhet bërë përpjekje për t' i ndihmuar fëmijët që të përshtaten lehtësisht në mjedisin e ri, me shokët e shoqet e reja dhe me rutinën e re të kopshtit. Ka një fazë përshtatjeje nga 3-7 javë. Gjatë kësaj kohe, nëna mund ta shoqërojë fëmijën në periudha të ndryshme të ditës .

IV. Kujdesi për fëmijët që kalojnë nga kopshti në shkollë. Momenti i kalimit nga kopshti në shkollë konsiderohet shumë i mirëpritur nga fëmija, por mund të krijojë edhe probleme individuale, psikologjike të cilat ndikojnë thellë në personalitetin e tij. Periudha tranzitore e kalimit nga loja e mirëfilltë e kopshtit në institucionin shkollë, ku të nxënë të është parësor, është sfidues dhe mund të shkaktojë stres dhe ankth. Që ky tranzicion të jetë sa më i lehtë dhe i natyrshëm, nevojitet një planifikim dhe përgatitje e kujdesshme. Për këtë hartohen programet tranzitore. Çdo kopsht duhet të ketë një plan të shkruar tranzicioni, i cili hartohet nga stafi i mësueseve të kopshtit, në bashkëpunim me prindërit dhe mësueset e shkollës fillore.

V. Kujdesi ndaj fëmijëve me prirje e nevoja të veçanta. Kopshti ka edhe fëmijë me nevoja të veçanta, për të cilët ai kujdeset, i mbështet i përfshin në program dhe arrin rezultate dhe progres në zhvillimin e tyre. *Nevoja të veçanta* nënkuptojmë vështirësitë fizike, mendore, emocionale, vështirësitë e ndryshme që fëmija i has në procesin e të nxënimit. Mësueset duhet të përpqen t' i integrojnë këta fëmijë sa më natyrshëm në grup me fëmijët e tjerë. Bashkëpunimi midis psikologut, mësueses dhe mjekut është një mundësi për t' iu ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve. Shërbimi i psikologut në kopsht duhet të jetë i planifikuar. Psikologu përgatit për çdo fëmijë kartelën përkatëse dhe evidenton përmirësimin e sjelljes së tij. Edhe mjeku i kopshtit kur është pjesë e stafit të kopshtit, ka rolin e vet në drejtim të kujdesit ndaj fëmijës. Mjeku zbaton planin e punës, i cili parashikon identifikimin e problemeve shëndetësore për secilin fëmijë (kartelat shëndetësore, me të cilat ndjek vijimësinë e shëndetit). Mjeku luan rol në edukimin shëndetësor të fëmijës. Përveç fëmijëve me nevoja të veçanta, në kopsht mund të ketë edhe fëmijë me prirje të veçanta. Fëmijët me prirje të veçanta janë ata që shfaqin talent në një ose disa fusha të caktuara. Kopshti nga ana e tij duhet të krijojë mundësi që këta fëmijë t' i zhvillojnë prirjet e tyre, duke krijuar edhe plane që parashikojnë veprimtari të veçanta.

Fëmijët me AK hyjnë në kopsht me një vlerësim të hartuar nga mjeku specialist dhe mbi bazën e tij, grupi në kopsht harton PEI-et, të cilat i përshtaten aftësisë dhe potencialit që ka fëmija.

VI. Respektimi i individualitetit të çdo fëmije. Kopshti zë një vend të rëndësishëm në formimin e personalitetit të fëmijës 3-6 vjeç. Ai është vendi i parë dhe më i rëndësishëm ku zë fill procesi i integritimit social të fëmijëve parashkollorë. Pasuria dhe larmishmëria e përvojave edukative i ndihmon fëmijët të ndërtojnë dhe

të zhvillojnë personalitetin dhe individualitetin e vet. Falë situatave të pasura të komunikimit me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, fëmija mëson të identifikojë ndjenjat dhe emocionet e veta, të kontrollojë veprimet e tij për t'iu përshtatur më mirë kohës, vendit dhe mjedisit social. Veprimtaria e kopshtit u përgjigjet nevojave fiziologjike, emocionale dhe intelektuale të fëmijës, duke i krijuar kushte që të zërë vendin e tij në shoqërinë e kopshtit. Mësueset e kopshtit kanë detyrën delikate të njohin dhe të respektojnë ritmet e jetës dhe të mësuarit e fëmijëve, interesat dhe shijet e tyre. Me anë të vëzhgimit të vëmendshëm, mësuesja përdor teknika të ndryshme, për t'iu përshtatur ritmeve të të mësuarit të fëmijëve, ndryshimeve dhe interesave individuale. Në vitet e fëmijërisë së hershme ka shumë rëndësi zhvillimi i vetëvlerësimit dhe i aftësive të veçanta të fëmijëve. Një nga qëllimet e procesit të edukimit është të zhvilluarit e ndjenjës së respektit për veten dhe të tjerët. Ndërtimi i aftësive sociale dhe i marrëdhënieve emocionale të shëndetshme të fëmijët e vegjël, është shumë më i lehtë se përpjekja për të përmirësuar problemet e mëvonshme të sjelljes.

VII. Mjedisi fizik i brendshëm i kopshtit. Mjedisi fizik ndikon në sjelljen dhe zhvillimin e njeriut, të rriturve dhe fëmijëve që jetojnë dhe punojnë në të. Pra, mjedisi fizik përshpejton rritjen dhe zhvillimin optimal, përmes mundësive që u krijojnë fëmijëve për të mësuar. Mjedisi i brendshëm i kopshtit ndahet në mjedise mësimore dhe mjedise ndihmëse që i shërbejnë të njëjtit qëllim, mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve. Cilësia e hapësirës fizike dhe e materialeve të ofruara ndikojnë në nivelin e përfshirjes së fëmijëve dhe në cilësinë e bashkëveprimit të tyre me moshatarët dhe të rriturit. Hapësirat duhet të pajisen në mënyrë të tillë që të sigurojnë akomodimin e çdo fëmije në grup të madh e të vogël. Materialet duhet të jenë të përshtatshme dhe të vlefshme për t'iu përdorur nga fëmijët. Brenda kopshtit duhet të ketë qendra, ku fëmijët të luajnë vetëm dhe me fëmijët e tjerë. Qendrat janë të etiketuara në mënyrë që fëmijët t'i kuptojnë lehtësisht rregullat. Mjediset ndihmëse janë mjedise të ndërvarura nga ato të veprimtarisë ditore, por nxitin dhe respektojnë pavarësinë e fëmijëve. Çdo fëmijë duhet të ketë hapësirën e vet për mjetet individuale. Mjedisi i brendshëm duhet të jetë gjithmonë në kushte higjienike shumë të mira.

IVIII. Mjedisi fizik i jashtëm i kopshtit. Mjedisi i jashtëm u krijon mundësi fëmijëve të përdorin forcën e muskujve në veprimtaritë dhe lojërat në natyrë, të zhvillojnë shfaqje teatrale, ku të përfshihen sa më shumë pjesëmarrës. Ky mjedis ka një ndikim të madh tek fëmijët, me mesazhet që u transmeton dhe ndikon në rritjen dhe zhvillimin e tyre. Në mjedisin e jashtëm duhet të respektohet balanca diell-hije-gjelbërim, në mënyrë që të përdoret si për aktivitete ditore, ashtu edhe për bashkëveprimet sociale. Edhe hapësirat në mjedisin e jashtëm duhet të jenë të përshtatshme për të zhvilluar një larmi veprimtarish. Për këtë duhet të ketë larmi sipërfaqesh, asfalt ose pllaka për aktivitete fizike, bar për t'iu rrotulluar, rërë për të luajtur. Kopshti është një vend ku mjedisi i brendshëm ka lidhje të ngushtë me atë të jashtëm.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Siguria për jetën dhe shëndetin	1. Kopshti ka një mjedis fizik të brendshëm dhe të jashtëm, të organizuar në funksion të sigurisë së jetës dhe shëndetit të fëmijëve.	1.1.1. Personeli pedagogjik dhe ndihmës është i pajisur me libra shëndetësore brenda afateve të lejuara.				
		1.1.2. Kopshti ka dalje emergjence.				
		1.1.3. Kopshti është i pajisur me sistemin MKZ.				
		1.1.4. Korridoret, shkallët dhe sheshpushimet janë të lira, për lëvizjen normale të fëmijëve dhe personelit në raste të jashtëzakonshme (rënie të zjarrit).				
		1.1.5. Gjendja teknike e pajisjeve që punojnë me gaz ose energji elektrike dhe e instalimeve elektrike është brenda standardeve të lejuara.				
		1.1.6. Depoja e karburantit që furnizon sistemin e ngrohjes qendrore është e siguruar.				
		1.1.7. Personeli pedagogjik dhe ai ndihmës janë të trajnuar për radhën e veprimeve në rast të ndonjë emergjence (zjarr, tërmet etj.).				
		1.1.8. Në një vend të dukshëm janë afishuar numrat e emergjencës në rast nevoje (nr. e policisë, zjarrfikëseve, urgjencës etj.).				
		1.1.9. Kopshti është pajisur me shenja dalluese që tregojnë rrugën për të dalë në raste emergjente.				
		1.1.10. Dritaret, dyert, ballkonet etj. janë të siguruara.				
		1.1.11. Në mjediset ku ka gaz për gatim ose ngrohje, është e instaluar pajisja që njofton rrjedhjen e gazit.				
		1.1.12. Mësueset kanë parashikuar tema edukimi, me qëllim që fëmijët të dinë si të veprojnë në situata të caktuara që rrezikohet jeta e tyre.				
		1.1.13. Fëmijët njohin numrat e emergjencës, për të njoftuar në rast rreziku.				
		1.1.14. Është kryer dezinfektimi dhe lysterja e mjediseve të brendshme dhe të jashtme të kopshtit.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Cilësia e ushqimit dhe e higjienës	1. Kopshti ka marrë masa për një ushqim cilësor dhe higjienë shumë të mirë.	2.1.1. Cilësia e gatimit të ushqimit në kuzhinë është shumë e mirë.				
		2.1.2. Sasia e ushqimit përputhet me faturën e furnizimit dhe numrin e fëmijëve në kopsht.				
		2.1.3. Zbatohet etika në ndarjen edhe servirjen e ushqimit sipas grupeve (mbulesa në tavolinat e ngrënies, pjata dhe lugë për çdo fëmijë, pjatë për çdo gjellë, peceta letre etj.).				
		2.1.4. Personeli është me uniformën përkatëse, sipas detyrës që kryen në kopsht.				
		2.1.5. Kampionet e 3 vakteve të ushqimit dhe frutave të një dite më parë janë në frigorifer.				
		2.1.6. Menuja e përcaktuar zbatohet në mënyrë korrekte.				
		2.1.7. Mjediset e brendshme të grupit janë të higjienizuara.				
		2.1.8. Kopshti ka një higjienë të mirë në kuzhinë (lavamani; soba; frigoriferi).				
		2.1.9. Enët e kuzhinës janë të lara, të ziera dhe të mbuluara.				
		2.1.10. Ushqimet e fëmijëve janë brenda datës së skadencës.				
		2.1.11. Dollapët ku ruhen ushqimet, plotësojnë kushtet e përcaktuara.				
		2.1.12. Tualetet e grupeve janë të higjienizuara.				
		2.1.13. Higjiena në tualetet e personelit është e mirë.				
		2.1.14. Mjediset e përbashkëta (korridor, shkallë, sheshpushime, oborr etj.) plotësojnë kushtet e higjienës.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Kujdesi për fëmijët që hyjnë për herë të parë në kopsht	1. Kopshti zbaton një plan informimi për përshtatjen e fëmijëve të rinj që vijnë nga çerdhet apo nga shtëpia.	3.1.1. Drejtuesja ka organizuar takime informuese midis stafit pedagogjik dhe prindërve të fëmijëve që vijnë për herë të parë në kopsht.				
		3.1.2. Prindërit kanë dijeni për regjimin ditor dhe programin edukativ që do të zbatohet në kopsht.				
		3.1.3. Janë plotësuar formularët me të dhënat për fëmijën që pranohet në kopsht.				
		3.1.4. Mësueset kanë një kopje të vlerësimeve të fëmijëve që vijnë nga çerdhet.				
		3.1.5. Fëmijët që vijnë për herë të parë në kopsht, kanë vizituar grupet dhe mjediset e kopshtit dhe janë familjarizuar me to.				
		3.1.6. Të gjithë fëmijët që vijnë për herë të parë në kopsht janë të pajisur me kartela vaksinimi dhe me analizat e përcaktuara në DN.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
K u j d e s i për fëmijët që kalojnë në klasën e parë.	1. Kopshti zbaton programe tranzitore për kalimin e fëmijëve nga kopshti në shkollë.	4.1.1. Mësueset ndjekin zhvillimin social-emocional të fëmijëve parashkollorë.				
		4.1.2. Mësueset ndjekin rezultatet e fëmijëve nëpërmjet vëzhgimeve të rregullta me shkrim.				
		4.1.3. Prindërit marrin informacion të rregullt për progresin e fëmijëve.				
		4.1.4. Për fëmijët minoritarë, romë, egjiptianë përcaktohen dhe zbatohen nevojat e tyre gjuhësore.				
		4.1.5. Fëmijët parashkollorë vizitojnë klasat e para, për t'u njohur me mjediset e klasës dhe të shkollës.				
		4.1.6. Fëmijët parashkollorë vëzhgojnë edhe orë mësimi në shkollë.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Kujdesi për fëmijët me nevoja e prirje të veçanta	1. Kopshti zbaton një plan të veçantë pune, për fëmijët me nevoja të veçanta.	5.1.1. Mësueset e kopshtit të të gjitha grupeve kanë identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta.				
		5.1.2. Fëmijë me nevoja të veçanta janë shpërndarë nëpër grupe në mënyrë të barabartë.				
		5.1.3. Kopshti ka hartuar dhe zbaton programe të veçanta, sipas nevojave të secilit fëmijë.				
		5.1.4. Secili fëmijë me nevoja të veçanta ka portofolin e tij të zhvillimit individual, të plotësuar me materialet e domosdoshme.				
		5.1.5. Mësueset përdorin forma pune të përshtatshme për të mbështetur fëmijët në vështirësitë e tyre të të nxënit.				
		5.1.6. Kopshti përfshin edhe prindërit në trajtimin dhe kujdesin ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë.				
	2. Kopshti zbaton një plan të veçantë pune, për fëmijët me prirje të veçanta.	5.2.1. Kopshti ka identifikuar fëmijët me prirje të veçanta.				
		5.2.2. Kopshti ka identifikuar fushën e zhvillimit të prirjeve të këtyre fëmijëve.				
		5.2.3. Kopshti ka hartuar programe të ndryshme nga fëmijët e tjerë (më të përparuara) për fëmijët me prirje të veçanta.				
		5.2.4. Kopshti promovon fëmijët me prirje të veçanta në veprimtari të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.				
		5.2.5. Kopshti krijon grupe për fëmijët me prirje të veçanta, sipas prirjeve të tyre (p.sh.: grupi i kërcimit; grupi i pikturës etj.).				
		5.2.6. Kopshti bashkëpunon me personalitete apo me institucione për t'i ndihmuar fëmijët në zhvillimin më tej të prirjeve të tyre.				

		5.2.7. Kopshti promovon fëmijët me prirje të veçanta, duke i përdorur si model për bashkëmoshatarët e tyre.				
		5.2.8. Kopshti mbështet këta fëmijë me mjete didaktike të përshtatshme sipas prirjeve të tyre.				
		5.2.9. Kopshti ekspozon punët e fëmijëve me prirje të veçanta, duke i vlerësuar ata.				
3. Kopshti ofron shërbimin e psikologut dhe të mjekut.		5.3.1. Mësueset janë njohur me planifikimin e shërbimit që ofrojnë mjeku, psikologu dhe punonjësi social gjatë gjithë vitit.				
		5.3.2. Mjeku, psikologu, mësuesja, drejtuesja dhe prindi kanë hartuar plane edukative individuale për secilin fëmijë (PEI).				
		5.3.3. PEI-et janë të firmosura edhe nga prindërit e fëmijëve.				
		5.3.4. Mësuesja e kopshtit njih dhe zbaton PEI-et në vazhdimësi.				
		5.3.5. Psikologu dhe mjeku (nëse është pediatër zhvillimi) punojnë individualisht me secilin fëmijë, rreth 45 min në ditë.				
		5.3.6. Psikologu, mjeku dhe stafi i kopshtit ruajnë konfidencialitetin e çdo fëmije që trajtojnë.				
		5.3.7. Psikologu dhe mjeku bashkëpunojnë dhe përfshijnë në punën e tyre prindërit dhe mësueset.				
		5.3.8. Kopshti ka sistem pune për zhvillimin e testeve diagnostikuese nga ekspertët dhe shkëmbimin e informacionit mes tyre.				
		5.3.9. Mjeku përgatit kartelat shëndetësore me të cilat ndjek vijimësinë e shëndetit për secilin fëmijë.				
		5.3.10. Mjeku mbikëqyr vazhdimisht situatën sanitare në kopsht.				
		5.3.11. Psikologu dhe mjeku bashkëpunojnë me prindërit dhe mësueset për fëmijët me nevoja të veçanta (me prirje dhe AK).				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Respektimi i individualitetit të çdo fëmije	1. Mësueset i trajtojnë fëmijët si të barabartë.	6.1.1. Mësueset i thërrasin të gjithë fëmijët me emër.				
		6.1.2. Mësueset i dëgjojnë fëmijët dhe u japin mundësi të dëgjohen.				
		6.1.3. Mësueset nuk bëjnë komente për pamjen apo karakterin e fëmijëve.				
		6.1.4. Mësueset shmangin të qenit komik apo tallës me fëmijët.				
		6.1.5. Mësueset nuk bëjnë dallime të panevojshme ndërmjet fëmijëve.				
		6.1.6. Mësueset nuk tregojnë shenja antipatie ndaj fëmijëve.				
		6.1.7. Mësueset nuk tregojnë simpati ndaj disa fëmijëve, në mënyrë që të tjerët të ndihen keq.				
		6.1.8. Mësueset përdorin të njëjtat kritere vlerësimi për të gjithë fëmijët.				
	2. Klima në kopsht, në klasë/grupe është pozitive dhe optimiste.	6.2.1. Mësueset shfaqin mirësjellje në komunikimin me fëmijët.				
		6.2.2. Mësueset stimulojnë fëmijët që të zbatojnë rregullat e mirësjelljes.				
		6.2.3. Mësueset stimulojnë fëmijët të respektojnë njëri-tjetrin, pavarësisht nga dallimet raciale apo kushtet sociale.				
		6.2.4. Mësueset i stimulojnë fëmijët të kontrollojnë sjelljet e tyre dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.				
	3. Vlerësimi i fëmijëve është motivues, dashamirës dhe real.	6.3.1. Mësueset mbajnë qëndrim pozitiv ndaj pyetjeve, komenteve dhe përgjigjeve të fëmijëve.				
		6.3.2. Mësueset nuk bëjnë komente demoralizuese gjatë veprimtarive të ndryshme.				
		6.3.3. Mësueset mbajnë qëndrim pozitiv ndaj punimeve të fëmijëve.				

		6.3.4. Mësueset shprehin vlerësim për përpjekjet që bëjnë fëmijët.				
		6.3.5. Mësueset organizojnë veprimtaritë mësimore- edukative në përputhje me nivelin dhe moshën e fëmijëve.				
		6.3.6. Mësueset nxitin fëmijët që të japin përgjigje të qarta dhe të plota.				
		6.3.7. Mësueset ndihmojnë fëmijët që të korrigjojnë gabimet e tyre.				
		6.3.8. Çdo fëmijë ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i dashur nga të tjerët.				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Mjedisi fizik i brendshëm i kopshtit	1. Mjedisi i brendshëm i kopshtit është informues dhe nxitës.	7.1.1. Mjedisi i përshtatet qëllimeve të kurrikulës.				
		7.1.2. Mjedisi i brendshëm është transparent (krijon mundësi për të parë gjithçka).				
		7.1.3. Në hyrje të kopshtit është vendosur rregullorja e brendshme e kopshtit.				
		7.1.4. Në hyrje të kopshtit prezantohet stafi dhe objektivat e punës.				
		7.1.5. Në një vend të dukshëm është vendosur menuja javore dhe ditore e ushqimit.				
		7.1.6. Në mjediset e përbashkëta të kopshtit janë vendosur të drejtat dhe detyrat e fëmijëve, mësueseve dhe prindërve.				
		7.1.7. Në mjediset e përbashkëta dhe në grup prezantohen punimet individuale të fëmijëve (të cilat ndërrohen herë pas here).				
		7.1.8. Hapësirat janë të organizuara në mënyrë të tillë, që nxitin investigimin dhe eksperimentimin.				

		7.1.9. Qendrat e aktivitetit janë të pajisura me materiale që nxitin zbulimin.				
		7.1.10. Mjediset e kopshtit janë të hapura, tërheqëse dhe miqësore.				
2. Mjediset fizike janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë në kopsht.	7.2.1. Raporti fëmijë-hapësirë është në përputhje me normat zyrtare të mjediseve fizike të kopshtit.					
	7.2.2. Cilësia e ndriçimit është brenda normave zyrtare për zhvillimin normal të veprimtarisë në kopsht.					
	7.2.3. Kopshti siguron ngrohjen e të gjitha mjediseve të tij.					
	7.2.4. Cilësia e ajrit në kopsht është brenda normave fizike dhe e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore-edukative.					
3. Kopshti zbaton udhëzimet zyrtare për numrin e fëmijëve në klasa.	7.3.1. Në regjistrimin e fëmijëve në kopsht është zbatuar ndarja territoriale e vendbanimit të tyre, sipas miratimit të DAR-it.					
	7.3.2. Është zbatuar kriteri zyrtar për numrin e fëmijëve në klasa.					
4. Kopshti siguron mjedise të sigurta, të përshtatshme dhe funksionale për fëmijët.	7.4.1. Mjedisi i kopshtit është në përputhje me standardet zyrtare për sigurinë fizike të fëmijëve (gjerësia e shkallëve, fikëse zjarri, kutia e ndihmës së shpejtë).					
	7.4.2. Kopshti zbaton një plan edukativ me fokus veprimtaritë edukuese kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.					
	7.4.3. Mjetet dhe lodrat që luajnë fëmijët janë të përshtatshme për moshën e tyre dhe të parrezikshme.					
	7.4.4. Mësueset kanë etiketuar qendrat e aktivitetit, në mënyrë që fëmijët të orientohen dhe të lëvizin lehtësisht nga njëra qendër tek tjetra.					
	7.4.5. Secili fëmijë ka vendin e tij personal me shenjë personale për vendosjen e sendeve të tij.					
	7.4.6. Secili fëmijë ka dosjen e tij personale me punimet përkatëse.					

Nënfusha 8	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Mjedisi fizik i jashtëm	1. Mjedisi i jashtëm është i sigurtë dhe ndihmon në zhvillimin e veprimtarisë së kopshtit.	8.1.1. Kopshti ka oborr me mur rrethues me kangjella, ku fëmijët janë të sigurtë.				
		8.1.2. Në oborr ka mjedise të qeta për çlodhjen e fëmijëve (stola për t'u ulur, bar për të pushuar).				
		8.1.3. Në oborr ka mjedise natyrale të gjelbëruara, ku fëmijët krijojnë kontakt me natyrën.				
		8.1.4. Në mjedisin e jashtëm ka hapësira me asfalt apo pllaka, të planifikuara për lojëra lëvizore.				
		8.1.5. Në oborr ka lodra që ndihmojnë në zhvillimin fizik të fëmijëve.				
		8.1.6. Në oborr ka mjedise ku fëmijët mund të eksperimentojnë.				
		8.1.7. Në oborr janë krijuar këndet e aktivitetit, si: - këndi i rërës dhe i ujit, - këndi i gjallë, - këndi i luleve, - këndi i lodrave etj.				
	2. Mjediset e jashtme janë të rregullta dhe higjienike.	8.2.1. Mjedisi i jashtëm është në kushte të mira higjienike.				
		8.2.2. Në mjedisin e jashtëm janë siguruar kosha për mbeturinat.				
		8.2.3. Kopshti punon për gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të jashtëm.				

STANDARDI

Kopshti kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për fëmijët që e frekuentojnë atë, duke patur në qendër të kujdesit sigurinë për jetën e tyre. Kujdesi ndaj fëmijëve në kopsht është i planifikuar dhe shtrihet gjatë gjithë vitit akademik. Për të siguruar një kujdes sa më të mirë për fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç, kopshti siguron një bashkëpunim të pandërprerë gjatë gjithë vitit akademik me mësueset; prindërit; mjeket e kopshteve; psikologët (ose punonjëset sociale etj.), pushtetin qendror dhe atë lokal. Kopshti mbështet të gjithë fëmijët që vijnë për herë të parë, ata që shkojnë për herë të parë në shkollë, fëmijët me nevoja të veçanta apo edhe ata me prirje të veçanta. Për t' i shërbyer sigurisë së jetës së fëmijëve, çdo kopsht ofron shërbimin e mjekut dhe të psikologut.

NIVELI 1

Kopshti rrezaton kulturë të kujdesjes dhe përkushtimit ndaj secilit fëmijë. Ai zbaton rregullisht plane pune për informimin dhe këshillimin e fëmijëve dhe prindërve për arritjet dhe shëndetin e tyre. Fëmija ndihet i sigurtë në mjedisin e kopshtit. Ai gjen lehtësitë dhe mbështetjen e duhur në veprimtarinë mësimore, është i lirë të përfshihet aktivisht në diskutime, në shkëmbime pyetje-përgjigjesh. Fëmija ndihet i respektuar, pavarësisht përkatisë së tij kulturore. Kopshti mendon se fëmijët me nevoja të veçanta mund të jenë pjesë e tij dhe i mbështet me programe dhe asistencën e duhur për zhvillimin e tyre. Fëmijët me prirje gjejnë hapësira dhe mbështetje për të thelluar më tej talentin e tyre. Veprimtaritë edukative zhvillohen rregullisht sipas një planifikimi që ka marrë në konsideratë interesat dhe dëshirat e fëmijëve, por dhe nevojat e mjedisit social të kopshtit. Shërbimi psikologjik dhe mjekësor në kopsht është i frytshëm dhe i vijueshëm, në funksion të secilit fëmijë.

NIVELI 2

Kopshti ofron kujdesje ndaj fëmijëve. Kujdesja është e planifikuar dhe përfshin të gjithë fëmijët, si ata me nevoja të veçanta dhe fëmijët që kanë prirje. Kopshti bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin. Ofron këshillime për prindërit e fëmijëve. Fëmijët mbështeten kur kalojnë nga njëri grup në tjetrin. Ata ndihen mirë, por duhet punuar më shumë për respektimin e vlerave dhe aspekteve kulturore dhe ndryshimeve që ata përfaqësojnë. Kopshti zhvillon veprimtari edukative që mbështetin interesat e fëmijëve. Shkolla ofron shërbim psikologjik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjithë fëmijët si individë në problemet e tyre. Shërbimi mjekësor është i pranishëm dhe mbështet shëndetin e fëmijëve.

NIVELI 3

Kopshti bën përpjekje për t'u kujdesur për fëmijët, por në këtë proces nuk janë përfshirë të gjithë. Kopshti nuk tregon dëshirë për të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta në veprimtarinë e tij. Fëmijët me prirje nuk gjejnë mbështetje dhe kujdesi ndaj tyre është spontan dhe jo i organizuar. Fëmijët ndiejnë nevojën që të respektohen dhe të mbështeten për të zhvilluar prirjet e tyre. Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin është i pakoordinuar dhe nuk është i frytshëm në kujdesjen ndaj fëmijëve. Veprimtaritë edukative që zhvillohen nuk marrin parasysh interesat dhe nevojat e fëmijëve. Shërbimi psikologjik dhe ai mjekësor nuk është në nivelin e duhur për të mbështetur secilin fëmijë. Kopshti ka nevojë që të mbështetet dhe të përmirësohet për këtë fushë.

NIVELI 4

Kopshti nuk ofron kujdesin e duhur për fëmijët. Kujdesi ofrohet në mënyrë spontane dhe nuk është i planifikuar. Kopshti nuk i dëshiron fëmijët me nevoja të veçanta dhe shfaqen qëndrime jokorrekte ndaj kulturave dhe vlerave që fëmijët përfaqësojnë. Prindërit përfshihen me raste dhe nuk janë pjesë e lehtësimit apo kujdesjes së fëmijëve në kopsht. Veprimtaritë edukative nuk planifikohen. Edhe kur ato zhvillohen, janë të rastësishme dhe jo në mbështetje të fëmijëve. Fëmijët me prirje nuk identifikohen dhe nuk mendohet për ta. Shërbimi psikologjik dhe ai mjekësor nuk ofrohet në kopsht. Kopshti ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e kësaj fushe.

FUSHA V. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Kopshti është një mjedis social dhe edukativ për fëmijët, të cilët vijnë nga familje dhe kultura të ndryshme, duke përfaqësuar kështu një diversitet të plotë. Që një mjedis i tillë të jetë motivues, mikpritës dhe zhvillues për fëmijët 3-6 vjeçarë, është e domosdoshme që burimet njerëzore që drejtojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë mësimore në kopsht, të jenë të arsimuara dhe të kualifikuara. Në këtë kuptim, një nga elementet kyç të planifikimit strategjik për kopshtin mbetet ndërtimi i një infrastrukture të nevojshme që mbështet trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore. Personeli i një kopshti ka rëndësi jetësore në suksesin dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies. Pa punonjës të frytshëm, çdo kopsht do të rrezikonte mbijetesën e tij.

Nga cilësia dhe efektiviteti i këtij personeli varet edhe sukcesi i hapave të para që hedhin fëmijët në rrugën e gjatë dhe të vështirë të zhvillimit dhe formimit. Nga funksionimi i mirë i marrëdhënieve midis drejtueses, mësueseve, prindërve dhe fëmijëve dallohet një kopsht cilësor. Problemet që shoqërojnë kopshtin, për vetë natyrën e funksionimit të tij, janë tepër komplekse dhe të vështira, prandaj përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve njerëzore dhe i financave të kopshtit, mund të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të kurrikulës së arsimit parashkollor dhe zhvillimin e suksesshëm të fëmijëve.

Fusha e zhvillimit të burimeve njerëzore, përfshin tri **nënfusha**:

- I. Efektiviteti i personelit;
- II. Efektiviteti i financave;
- III. Dokumentacioni i kopshteve.

I. Efektiviteti i personelit nënkupton një menazhim të mirë të stafit pedagogjik, stafit ndihmës, të psikologes ose punonjësës sociale. Personeli i kopshtit mund të jetë i frytshëm në punën e tij atëherë kur ai është kualifikuar në bazë të kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga MASH-i, për formimin fillestar pedagogjik dhe universitar, por edhe kur janë marrë parasysh normat e përcaktuara në udhëzimet zyrtare, ku secili prej tyre ka hapësirën e domosdoshme për të zhvilluar veprimtarinë e tij.

II. Efektiviteti i financave lidhet me menazhimin dhe transparencën e të ardhurave që siguron kopshti nga fondi i përcaktuar për të nga MASH-i, DAR/ZA-ja, kontributi vullnetar financiar i prindërve, donacione të ndryshme apo edhe të ardhura nga të tretë.

III. Dokumentacioni i kopshteve përfshin dokumentet që duhet të ketë një kopsht për të gjitha fushat e veprimtarisë së tij. Dokumentacioni i kopshteve duhet të hartohet sipas udhëzimeve që janë dhënë nga MASH-i dhe nga DAR/ZA-ja. Dokumentet duhet të përditësohen me të dhënat më të fundit dhe të pasqyrojnë të gjitha udhëzimet zyrtare.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Efektiviteti i personelit	1. Personeli mësimor dhe ndihmës i kopshteve është i kualifikuar dhe zbaton normën mësimore zyrtare.	1.1.1. Drejtueset, stafi mësimor pedagogjik dhe ndihmës i kopshtit është i kualifikuar.				
		1.1.2. Drejtuesja e kopshtit kryen normën e saj javore drejtpërdrejt në mësimdhënie në grupet e fëmijëve.				
		1.1.3. Zëvendësdrejtoret e kopshtit zbatojnë normën javore të punës.				
		1.1.4. Mësueset e kopshtit zbatojnë normën javore të punës.				
		1.1.5. Kopshti ka psikolog për trajtimin e fëmijëve të tij.				
		1.1.6. Kopshti ka punonjës social.				
		1.1.7. Grupet e fëmijëve janë krijuar sipas kriterëve zyrtarë që lidhen me grupmoshat 3-4 vjeçare, 4-5 vjeçare dhe 5-6 vjeçare.				
		1.1.8. Kopshti respekton normat zyrtare të ngarkesës së drejtuesëve, bazuar: <ul style="list-style-type: none"> - në numrin e grupeve të fëmijëve, - nëse kopshti është me ushqim. 				
		1.1.9. Personeli ndihmës zbaton normën javore zyrtare.				
		1.1.10. Numri i personelit ndihmës është në përputhje me normën zyrtare.				
		1.1.11. Kopshtet jopublike respektojnë normat zyrtare për kualifikimin dhe normat zyrtare të stafit mësimor pedagogjik dhe ndihmës.				
		1.1.12. Në rast mungese të personelit mësimor ose ndihmës, kopshti komunikon me DAR/ZA-në dhe siguron personelin e nevojshëm për zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore-edukative.				
		2. Kopshti identifikon nevojat për trajnimin e stafit të tij.	1.2.1. Personeli i kopshtit e dëshiron trajnimin.			
1.2.2. Është bërë identifikimi i nevojave reale të stafit për trajnime.						

		1.2.3. Janë përcaktuar drejtimet dhe kërkesat e mësueseve për trajnim.				
		1.2.4. Nuk ka ndryshime midis nevojave për trajnim të identifikuar nga drejtoria dhe atyre të kërkuara nga mësueset.				
		1.2.5. Kopshti ka të dhëna të sakta të shkallëve të kualifikimit, të fituara nga personeli i saj mësuesor.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Efektiviteti i financave	1. Kontributi vullnetar i prindërve menazhohet me efektivitet.	2.1.1. Kopshti siguron të ardhura edhe nga kontributi vullnetar i prindërve, duke u mbështetur në urdhrat dhe udhëzimet e MASH-it dhe DAR/ZA-së.				
		2.1.2. Sasia e kontributit financiar të prindërve është vendosur me vendim të Bordit të Prindërve.				
		2.1.3. Në vendimin e Bordit të Prindërve është përcaktuar që kontributi është mbi baza vullnetare, duke bërë përjashtime për prindërit që nuk kanë mundësi.				
		2.1.4. Për vendosjen e sasisë së kontributit vullnetar është tërhequr mendimi i personelit dhe i grupeve të interesit.				
		2.1.5. Kopshti ka përcaktuar nevojat për materiale didaktike, pasi ka bërë analizën e nevojave reale të tij.				
		2.1.6. Personeli i kopshtit dhe grupet e interesit (prindër; gjyshër; komuniteti) janë përfshirë në hartimin e prioritetëve të kopshtit.				
		2.1.7. Prioritetet e shpenzimeve janë hartuar në mënyrë të saktë dhe janë në përputhje me gjendjen e kopshtit.				
		2.1.8. Është hapur një numër llogarie në bankë, në të cilin derdhet kontributi vullnetar i prindërve.				
		2.1.9. Të drejtën e firmës në numrin e llogarisë e ka				

		drejtuesja e kopshtit bashkë me kryetarin e Bordit të Prindërve.				
		2.1.10. Faturat dhe mbledhja e kontributit financiar mbi baza vullnetare, janë të firmosura nga kryetari i bordit, drejtuesja e kopshtit dhe prindi i cili ka derdhur këtë kontribut (kur nuk ka llogari bankare).				
		2.1.11. Shpenzimet e planifikuara kanë marrë në konsideratë arritjet e vitit të kaluar dhe janë me fatura tatimore.				
		2.1.12. Të ardhurat e grumbulluara janë transparente për gjithë të interesuarit.				
		2.1.13. Dokumentet për shpenzimet e të ardhurave janë transparente për gjithë të interesuarit				
		2.1.14. Në një vend të dukshëm është krijuar "Këndi i transparencës", me të cilin është njohur personeli i kopshtit dhe prindërit.				
		2.1.15. Shpenzimet e parashikuara janë plotësisht të justifikuara, sepse i shërbejnë realizimit sa më të mirë të veprimtarisë mësimore-edukative të kopshtit.				
		2.1.16. Procesverbalet e blerjeve janë firmosur nga kryetari i Bordit të Prindërve, drejtuesja e kopshtit dhe një mësuese.				
		2.1.17. Ka vendim të Bordit të Prindërve për pagesën e rojes (nëse kopshti ka roje) të shoqëruara me procesverbalet përkatëse të çdo muaji, të nënshkruara nga kryetari i Bordit të Prindërve, drejtuesja dhe roja.				
		2.1.18. Komisioni i blerjeve të vogla është krijuar me vendim të Bordit të Prindërve.				
		2.1.19. Procesverbalet e blerjeve nuk e kalojnë vlerën e 10.000 lekëve (të rinj)				
		2.1.20. Është hartuar lista me materialet që duhen për një fëmijë gjatë një viti shkollor (literaturë ndihmëse, ngjyra, letra, plastelinë, libra me përalla etj.).				

		2.1.21. Të gjithë artikujt e blerë kanë hyrë në librin e inventarit të kopshtit.				
		2.1.22. Personeli pedagogjik dhe ai ndihmës është në dijeni dhe i ka miratuar blerjet e kryera.				
		2.1.23. Drejtuesja e kopshtit dhe kryetari i Bordit të Prindërve kanë raportuar pranë DAR/ZA-së për shpenzimet e kryera.				
2. Kopshti menazhon donacionet e ndryshme me procedura korrekte.	2.2.1. Donacionet për kopshtin janë me dokumente të rregullta (procesverbal, fatura etj.).					
	2.2.2. Të ardhurat nga donacionet menazhohen nga drejtuesja e kopshtit, kryetari i Bordit të Prindërve dhe një përfaqësues i subjektit që ka derdhur të ardhurat.					
	2.2.3. Për këto donacione (në lekë ose materiale) është vënë në dijeni DAR/ZA-ja personeli i kopshtit dhe prindërit.					
	2.2.4. Është tërhequr mendimi i personelit dhe i prindërve për mënyrën e shpenzimit të këtyre të ardhurave.					
	2.2.5. Ka dokumente të rregullta për mënyrën e shpenzimit të donacioneve (fatura tatimore, procesverbale, vendim të Bordit të Prindërve për llojin e shpenzimeve etj.).					
	2.2.6. Procesverbalet e blerjeve janë firmosur nga kryetari i Bordit të Prindërve, drejtuesja e kopshtit dhe nga një përfaqësues i organizatës/individit që ka bërë donacionin.					
	2.2.7. Të ardhurat dhe dokumentet për shpenzimet e tyre janë transparente për gjithë të interesuarit.					
	2.2.8. Në një vend të dukshëm është krijuar "Këndi i transparencës", në të cilin janë përfshirë edhe të ardhurat nga donacionet apo nga të tretë..					
	2.2.9. Shpenzimet e kryera nga donacionet janë plotësisht të justifikuara, sepse i shërbejnë realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative të kopshtit.					
	2.2.10. Materialet që janë blerë me të ardhurat nga donacionet, janë përfshirë në librin e inventarit të kopshtit.					

		2.2.11. Të ardhurat nga të tretët (komuniteti i prindërve, bashkëpunime me OJF të ndryshme, fondacione, kompani biznesi etj.) menazhohen nga drejtuesja e kopshtit, kryetari i Bordit të Prindërve dhe një përfaqësues i subjektit që ka derdhur të ardhurat.				
--	--	--	--	--	--	--

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Dokumentacioni i kopshteve	1. Kopshti përdor një dokumentacion zyrtar sipas formateve të kërkuara nga institucionet e prore.	3.1.1. Drejtuesja e kopshtit ka plotësuar dosjet me dokumentet përkatëse, sipas formatit të kërkuar nga DAR/ZA-ja.				
		3.1.2. Drejtuesja ka dosjen e planeve vjetore të 2-3 viteve të fundit.				
		3.1.3. Plani ditore i drejtueses së kopshtit është hartuar në vijimësi.				
		3.1.4. Drejtuesja ka dokumentuar dhe ka zbatuar planin e vëzhgimit të orëve mësimore, sipas udhëzimeve të MASH-it.				
		3.1.5. Drejtuesja didaktike e kopshteve jopublike e ka dokumentacionin, sipas formatit të kërkuar nga MASH-i dhe DAR/ZA-ja.				
		3.1.6. Kopshtet jopublike janë pajisur me lejen për funksionimin e veprimtarisë së tyre, të lëshuar nga MASH-i.				
		3.1.7. Mësueset e çdo grupi kanë të plotë dokumentacionin, sipas formatit të kërkuar nga DAR/ZA-ja (plane vjetore, mujore, ditari, gjendjen sociale të grupit etj.).				
		3.1.8. Kopshti ka përpunuar të dhënat statistikore sipas formateve të DAR/ZA-së, MASH-it dhe i dërgon zyrtarisht në institucionet qendrore.				

STANDARDI

Kopshti menazhon me efektivitet personelin pedagogjik dhe ndihmës, në përputhje me normat dhe objektivat që duhet të realizohen brenda një viti mësimor (kalendarik). Stafi pedagogjik, stafi ndihmës, prindërit, komuniteti etj., janë përfshirë në të gjitha aspektet që shoqërojnë veprimtarinë mësimore-edukative në një kopsht. DAR/ZA-ja ka dijeni për efektivitetin e personelit, efektivitetin e financave, si dhe për dokumentacionin që duhet të ketë një institucion parashkollor. Kopshti ka parashikuar trajnime gjatë gjithë vitit me stafin pedagogjik, duke i dhënë përparësi trajnimeve për të cilat kanë më shumë nevojë mësueset. Kopshti bashkëpunon me specialistë të fëmijërisë së hershme për të zhvilluar kualifikimin e stafit.

NIVELI 1

Kopshti ka të gjithë personelin pedagogjik dhe ndihmës me arsimin përkatës. Janë zbatuar normat sipas udhëzimeve të MASH-it në krijimin e grupeve të fëmijëve, sipas formateve dhe kritereve profesionale. DAR/ZA-ja merr vazhdimisht informacion për shfrytëzimin në mënyrë efektive të të ardhurave që ka kopshti, si dhe për efektivitetin e personelit pedagogjik dhe atij ndihmës, në përputhje me normat zyrtare. Dokumentacioni i kopshtit është plotësuar në mënyrë të saktë. Të ardhurat e kopshtit janë transparente dhe janë përfshirë të gjithë të interesuarit për një menazhim të mirë të kopshtit. Kopshti zhvillon vazhdimisht trajnime për stafin pedagogjik si brenda institucionit, ashtu edhe jashtë tij.

NIVELI 2

Personeli pedagogjik dhe ndihmës i kopshtit është me arsimin përkatës. Grupet e fëmijëve janë krijuar duke patur parasysh grupmoshën dhe numrin e fëmijëve që duhet të ketë një grup. Personeli pedagogjik dhe ai ndihmës janë efektiv, sipas normave zyrtare të përcaktuara. Të ardhurat e kopshtit, në përgjithësi, menazhohen me efektivitet dhe në përputhje me nevojat reale të kopshtit. Shpenzimet e kryera janë transparente për gjithë të interesuarit, por në realizimin e shpenzimeve nuk janë përfshirë prindërit apo stafi i kopshtit. Dokumentacioni i kopshtit është në përputhje me udhëzimet e marra nga MASH-i dhe DAR/ZA-ja. Kopshti është i interesuar për të zhvilluar trajnime me stafin pedagogjik.

NIVELI 3

Kopshti bën përpjekje për të patur personelin pedagogjik dhe ndihmës me arsimin përkatës. Nuk është mbajtur parasysh kriteri i moshës në ndërtimin e grupeve të fëmijëve. Personeli pedagogjik dhe ai ndihmës nuk janë shpërndarë sipas ngarkesës së tyre dhe nevojave reale të kopshtit. Në planifikimin e shpenzimeve nga të ardhurat janë mbajtur parasysh nevojat reale të kopshtit, por shpenzimet janë spontane dhe sipas interesave të momentit. Dokumentacioni i kopshteve ka mangësi që bien ndesh me udhëzimet. Nuk vihen re përpjekje për një shfrytëzim me efektivitet të personelit dhe të financave në dispozicion të kopshtit. Nevojat për kualifikime dhe trajnime të stafit nuk janë përparësi e kopshtit.

NIVELI 4

Kopshti ka pa arsimin përkatës pjesën më të madhe të personelit pedagogjik dhe atij ndihmës. *Grupet e fëmijëve janë ndërtuar në mënyrë të rastësishme*, pa marrë parasysh kriteret zyrtare. Ka shumë mangësi në menazhimin e të ardhurave të kopshtit. “Këndi i transparencës” nuk funksionon. Në menazhimin e të ardhurave nuk është bashkëpunuar me stafin e kopshtit, prindërit apo të interesuar të tjerë. Dokumentacioni është me dobësi të theksuara dhe nuk janë zbatuar udhëzimet e dhëna nga MASH-i dhe DAR/ZA-ja. Kualifikimi i stafit nuk është i planifikuar, por zhvillohet në mënyrë të rastësishme.

FUSHA VI. BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI

Fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç kanë nevoja të ndryshme për kujdes, për t’u ushqyer, për t’u zhvilluar sipas kërkesave të kurrikulës, për t’i dashur. Të gjitha këto arrihen nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë mes prindërve, stafit mësimdhënës dhe sistemeve të tjera mbështetëse. Mbështetja nënkupton krijimin e një mjedisi të pastër, motivues dhe të sigurtë, brenda dhe jashtë kopshtit. Një drejtim i frytshëm i marrëdhënieve kopsht-komunitet është përfshirja e prindërve në mënyrë aktive në procesin e programeve edukative të kopshtit. Kurrikula e kopshtit përcakton pjesëmarrjen e vazhdueshme të prindërve, pasi që në fillim, ata duhet të jenë aleatët dhe mbështetësit e fëmijëve të tyre. Vetë kopshti duhet të bëjë maksimumin për përfshirjen e prindërve në veprimtarinë e tij. Kopshti, gjithashtu, kontribuon efektivisht në jetën e komunitetit dhe punon me të duke marrë pjesë në ngjarje e veprimtari lokale. Kur është e nevojshme, kopshti realizon edhe veprimtari të tjera

për të angazhuar anëtarët e komunitetit. Informacioni për gjithçka zhvillohet në kopsht, jepet nëpërmjet një larmie të gjerë formash komunikimi, si: takim i drejtpërdrejtë, fletëpalosje të ndryshme, bashkëbisedime ku pasqyrohet veprimtaria e kopshtit, video, foto, punime të fëmijëve etj. Duke qenë një marrëdhënie njerëzore, marrëdhëniet kopsht-familje kanë brenda tyre faktorë objektivë e subjektivë që ndikojnë mjaft në ecurinë e mëtejshme. Prindi dhe mësuesja janë dy partnerë me të njëjtën potencë në edukimin e fëmijës, partnerë që kanë një qëllim të përbashkët, që duhet të bashkëpunojnë, diskutojnë, shkëmbejnë informacione për të njëjtin qëllim, *fëmijën*.

Nga ana tjetër, një mbështetje për funksionimin sa më të frytshëm të kopshtit japin dhe qeverisja lokale, institucionet eprore të arsimit në nivel lokal dhe rajonal, si dhe institucione të tjera, të cilat përmbajtja e kurrikulës së arsimit parashkollor, i lidh natyrshëm me veprimtarinë e tyre.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me kopshtin përfshin **nënfushat**:

- I. Marrëdhënia e kopshtit me prindërit;
- II. Marrëdhënia e kopshtit me komunitetin;
- III. Marrëdhënia e kopshtit me DAR/ZA-në;
- IV. Marrëdhënia e kopshtit me të tretët;
- V. Marrëdhënia e kopshtit me pushtetin vendor.

I. Marrëdhënia e kopshtit me prindërit. Bashkëpunimi i kopshtit me familjen kontribuon në përgatitjen e fëmijës si qytetar i ardhshëm i familjes së madhe evropiane, me të drejta të barabarta. Partneriteti familje-staf edukativ në bazë të standardeve të përmbajtjes është shumë i rëndësishëm. Mësueset dhe fëmijët punojnë së bashku në partneritet për të siguruar mbështetje optimale dhe realizimin cilësor të progamit të edukimit të fëmijës dhe nevojat e tyre zhvillimore. Është shumë e rëndësishme për fëmijën të shikojë dhe të ndiejë se mësueset dhe prindërit kanë marrëdhënie harmonike. Në këtë mënyrë ndihet më i sigurtë, gjë e cila jep rezultate më të mira në zhvillimin e tij. Prindërit janë personat më të rëndësishëm në jetën e një fëmije, prandaj dhe pjesëmarrja e tyre në veprimtaritë e kopshtit është e domosdoshme. Bashkëpunimi i prindërve me mësuesen e kopshtit ndikon fuqimisht në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës. Për këtë, çdo kopsht duhet të ndërtojë një bashkëpunim efektiv me prindërit. Prindërit informohen në mënyrë të qartë për të gjithë ecurinë e fëmijëve të tyre gjatë ditës dhe procesit të të nxënies nëpërmjet lojës. Drejtoria e kopshtit mbështet dhe inkurajon Bordin e Prindërve për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore, duke krijuar kushte favorizuese për shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve të kopshtit, në funksionim të veprimtarisë edukative- mësimore.

II. Marrëdhënia e kopshtit me komunitetin. Me komunitet kuptojmë vendin ku rritet dhe jeton fëmija. Komuniteti ka ndikimin e vet në zhvillimin e fëmijës dhe luan rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të tij. Komuniteti ndodh që të ketë ndikim pozitiv apo negativ tek fëmija, ndodh që fëmija në komunitet të mësojë diskriminimin, paragjykimin, racizimin etj., por mund të ndodhë e kundërta, që fëmija gjen aty mundësitë, lojërat, respektin dhe dashurinë e të tjerëve, duke bërë që ai të zhvillohet si qytetar i denjë i një shoqërie demokratike. Ky bashkëpunim me komunitetin do të arrihet me anë të funksionimit të Bordit të Prindërve në secilin grup dhe Bordit të Prindërve të kopshtit, i cili luan rol të rëndësishëm në realizimin dhe organizimin e veprimtarive të kopshtit. Bordi i kopshtit do të funksionojë sipas kërkesave të Dispozitave Normative dhe udhëzimeve të DAR/ZA-së. Bordi i Prindërve të çdo grupi do të jetë zëri mbështetës për realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative brenda dhe jashtë kopshtit. Kopshti bashkëpunon efektivisht në jetën e komunitetit dhe punon me të duke marrë pjesë në ngjarje e veprimtari që organizohen në kopsht dhe jashtë tij.

III. Marrëdhënia e kopshtit me DAR/ZA-në. Marrëdhëniet e kopshtit me DAR/ZA-në duhet të bazohen në dokumentet e politikës kombëtare arsimore. Zakonisht në punën e kopshtit zënë vend, politikat e theksuara vjetore të MASH-it, DAR/ZA-së për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore-edukative dhe arritjen e synimeve dhe objektivave të kopshtit. Në çdo fundviti, drejtueset e kopshtit në bashkëpunim me mësueset, bëjnë analizën e veprimtarisë mësimore-edukative për të nxjerrë pikat e dobëta dhe të forta të procesit. Kopshtet kanë rregullore të orientuara nga rregullorja e DAR/ZA-së që respektojnë dhe përmbushin të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve, prindërve dhe stafit, por kujdesi ndaj tyre është shumë më tepër se kaq.

IV. Marrëdhëniet e kopshtit me të tretët. Në marrëdhënien e kopshtit me të tretët përfshihen disa aktorë që ndikojnë në përmirësimin e jetës së kopshtit. Kjo marrëdhënie lidhet dhe shfrytëzon muzeumet, parqet, bibliotekat, kopshtet zoologjike, OJF-të dhe burime të tjera në komunitet. Një kopsht sado i mirë të jetë, nuk mund të zhvillohet e të rritet duke mbetur brenda mureve të veta. Kopshti vendos lidhje me kopshtet e tjera, pushtetin vendor, grupe të tjera të interesit, si dhe OJF të ndryshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës. Kërkohej që kopshti të përdorë mirë përvojën e fituar nga ky bashkëpunim, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e tij, sidomos me OJF-të që merren me fushat e zhvillimit të fëmijëve. Rëndësi, në bashkëpunimin me të tretët, kanë dhe shkollat e përfshira në territorin e zonës së kopshtit, pasi në bashkëpunim me prindërit dhe stafin zhvillojnë takime të vazhdueshme për ta bërë sa më të lehtë kalimin e fëmijëve nga kopshti në shkollë.

V. Marrëdhënia e kopshtit me pushtetin vendor. Kopshti si institucion arsimor ka lidhje dhe bashkëpunon ngushtë me qeverisjen lokale, bashkinë apo komunën. Ky bashkëpunim gjithmonë duhet të karakterizohet nga mbështetja reciproke për mbarëvajtjen e procesit të të nxënies dhe arritjen e synimeve dhe objektivave të kopshtit. Pushteti vendor vepron në përputhje me Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin e funksionimit e qeverisjes vendore” dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 204, datë 26.03.1998, “Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal”.

Pushteti vendor kryen disa shërbime:

- Furnizimin me materiale;
- Rikonstrukcionin e institucioneve edukative;
- Mirëmbajtjen;
- Ngrohjen;
- Pajisjen me bazë materiale dhe mjete didaktike;
- Pajisjen me kënde sportive;
- Mjedise të gjelbëruara.

Pra, bazuar në ligj, çdo aktor ka rolin dhe përgjegjësinë e vet. E rëndësishme është që këto role të harmonizohen dhe të bashkëpunojnë, në mënyrë që kujdesi për mirëmbajtjen e kopshtit të jetë i vazhdueshëm dhe edukimi parashkollor jo vetëm të funksionojë në kushte normale, por ta shikojë veten në rritje të cilësisë së shërbimit.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Marrëdhënia e kopshtit me prindërit	1. Kopshti bashkëpunon me prindërit.	1.1.1. Prindërit janë të mirëpritur në kopsht në çdo kohë.				
		1.1.2. Prindërit janë pjesëmarrës në hartimin e planit vjetor të kopshtit dhe në veprimtarinë mësimore-edukative të tij.				
		1.1.3. Në kopsht, në fillim të vitit mësimor, zgjidhet Bordi i Prindërve.				
		1.1.4. Bordi i Prindërve jep një kontribut të rëndësishëm në menazhimin e kopshtit (mblidhet si rregull 1-2 herë në semestër, por edhe më shpesh në raste të veçanta).				
	2. Mësuesja mban kontakte të vazhdueshme me prindërit.	1.2.1. Mësueset bëjnë takime rutinë, në mënyrë të vazhdueshme me prindërit, për ecurinë dhe shëndetin e fëmijëve.				

	dërit për ecurinë dhe shëndetin e fëmijëve.	1.2.2. Metodrat që përdorin mësueset për të informuar prindërit janë të frytshme (komunikime verbale, këndi i komunikimit etj.).				
--	--	---	--	--	--	--

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Marrëdhënia e kopshtit me komunitetin	1. Kopshti respekton traditat dhe kulturën e komunitetit.	2.1.1. Kopshti mbështet dhe kontribuon për kulturën e komunitetit, vlerat dhe traditat e tij.				
		2.1.2. Kopshti informon komunitetin për synimet dhe arritjet e tij.				
		2.1.3. Kopshti njeherë kërkesat e komunitetit në lidhje me pritshmëritë e tyre				
		2.1.4. Kopshti përfshin edhe pakicat në jetën e tij.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Marrëdhënia e kopshtit me DAR/ZA-në	1. Kopshti ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR/ZA-në.	3.1.1. DAR-ZA-ja siguron burimet njerëzore, sipas nevojave që ka kopshti.				
		3.1.2. Politikat vjetore të MASH-it, DAR/ZA-së zënë vend në veprimtarinë e kopshtit.				
		3.1.3. Rregullorja e kopshtit përmbush të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve, mësueseve, stafit ndihmës, sipas orientimeve.				
		3.1.4. Kopshti bashkëpunon me DAR/ZA-në për kualifikimin e stafit të tij.				
		3.1.5. Kopshti plotëson në mënyrë korrekte informacionet që kërkojnë institucionet eprore, si: DAR/ZA-ja.				
		3.1.6. Kopshti delegon pranë DAR/ZA-së, problemet që nuk gjejnë zgjidhje.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Marrëdhënia e kopshtit me të tretët	1. Kopshti bashkëpunon me OJF-të dhe institucionet e tjera që ndikojnë në cilësinë e shërbimit të tij.	4.1.1. Kopshti bashkëvepron me OJF-të dhe me institucionet e tjera që ndikojnë në zhvillimin e arsimit parashkollor.				
		4.1.2. Kopshti bashkëpunon me çerdhet dhe shkollat që janë në zonë.				
		4.1.3. Kopshti bashkëpunon me klasat e para në shkollat e zonës.				
		4.1.4. Kopshti ndan mendime me prindërit për llojin e shkollës që mund të ndjekin fëmijët e tyre.				
		4.1.5. Kopshti bashkëpunon me kopshtet e tjera dhe shkëmben përvoja në edukimin e fëmijëve.				
		4.1.6. Kopshti përdor forma të ndryshme bashkëpunimi me institucionet e tjera.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Marrëdhënia e kopshtit me pushtetin vendor	1. Kopshti bashkëpunon me institucionet shtetërore të marrëdhënieve horizontale dhe vertikale.	5.1.1. Kopshti mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e pushtetit lokal.				
		5.1.2. Kopshti bashkëpunon me institucionet e pushtetit lokal dhe me prindërit për shlyerjen e detyrimeve financiare të prindërve (pagesat e ushqimit të fëmijëve etj.).				
		5.1.3. Pushteti vendor, në bashkëpunim me stafin e kopshtit të fëmijëve, mbështet familjet me vështirësi ekonomike, me aftësi të kufizuara, probleme sociale etj.				

STANDARDI

Drejtuesja dhe mësueset punojnë me ndershmëri, përkushtim dhe barazi, gjë që i bën të ndihen krenare për kopshtin e tyre. Sjellja e stafit me fëmijët dhe prindërit është shumë e mirë, duke krijuar respekt dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit profesional dhe personal. Marrëdhëniet mësuese-prindër janë shumë të mira. Mësueset zgjedhin metoda pune në përshtatje me nivelin e fëmijëve dhe me mjedisin fizik, në të cilin zhvillojnë veprimtarinë mësimore-edukative. Prindërit përfshihen në jetën e kopshtit, duke shprehur mendimet e tyre për probleme që ndikojnë në ecurinë e procesit të edukimit të fëmijëve. Kopshti mban lidhje të qëndrueshme me prindërit, pushtetin vendor dhe OJF të ndryshme.

NIVELI 1

Midis mësueseve, drejtueses dhe prindërve mbizotëron një frymë e lartë bashkëpunimi dhe respekti reciprok. Morali i stafit pedagogjik është i lartë, pasi gjenden forma efektive për nxitjen, inkurajimin dhe stimulimin e tyre. Mësueset janë krenare për kopshtin e tyre dhe vlerësojnë e respektojnë punën e paraardhësve. Puna në të gjitha nivelet ndërtohet e drejtohet nga barazia në mundësi me sensin e ndershmërisë. Në kopsht mbizotëron rregullia, pastërtia dhe një mjedis i pastër, komod dhe estetik. Krijohen kushte optimale të punës e të veprimtarisë së mësueseve dhe fëmijëve. Kopshti ofron mjedise të sigurta dhe organizon veprimtari edukative në funksion të mirëqënies dhe sigurisë së fëmijëve. Prindërit mbështetin jetën dhe veprimtarinë e kopshtit në mënyrë të planifikuar dhe me objektiva. Ndërmerren hapa të rëndësishëm, për t' i përfshirë ata në veprimtaritë jashtëkurrikulare. Lidhjet e drejtueses së kopshtit me bordin dhe prindërit janë shumë të mira dhe të qëndrueshme. Kopshti inkurajon prindërit për të njohur dhe për t' u përfshirë në jetën e kopshtit. Bashkëpunimi gjeneron përfitime thelbësore dhe vlerësohet prej të gjithëve. Kopshti ka zhvilluar lidhje të mira dhe efektive me kopshte dhe institucione të tjera.

NIVELI 2

Marrëdhëniet e fëmijëve dhe mësueseve janë të mira. Në përgjithësi, mësueset ndihen krenare dhe bëjnë përpjekje për të lartësuar emrin e kopshtit të tyre. Metodot e punës janë të mira. Bëhen përpjekje për të mbështetur marrëdhëniet në kopsht, punohet për edukimin dhe formimin e vlerave qytetare, por jo kurdoherë

japin rezultate pozitive. Kopshti bën përpjekje për të vendosur rregull e pastërti. Kushtet e punës janë në përgjithësi të mira. Prindërit, përgjithësisht, janë të përfshirë në mbështetjen e të mësuarit të fëmijëve të tyre. Ata e mbështetin jetën e kopshtit. Kopshti ndërmer hapa për t'i përfshirë prindërit në veprimtaritë jashtëkurrikulare. Lidhjet e drejtueses së kopshtit me bordin dhe prindërit janë të mira. Kopshti ka zhvilluar lidhje të kënaqshme dhe efektive me kopshte dhe institucione të tjera.

NIVELI 3

Marrëdhëniet e fëmijëve dhe mësueseve nuk janë efektive. Krenaria dhe sensi i identitetit janë në nivel të ulët. Morali i stafit në përgjithësi është i ulët. Në shumë raste mungon optimizmi dhe predominon inaktiviteti. Mësueset nuk janë të suksesshme në punët dhe veprimtaritë që kërkojnë bashkëpunim, respekt dhe konfidencialitet. Tërësia e veprimtarive përputhet rastësisht me prirjet e fëmijëve. Në kopsht mungon rregulli dhe pastërtia. Mjediset lënë shumë për të dëshiruar. Format për të krijuar një atmosferë të ngrohtë brenda kopshtit nuk janë efektive. Mjediset pothuajse janë të pasigurta dhe nuk ofrohet veprimtari edukative në funksion të mirëqenies dhe sigurisë së fëmijëve. Lidhjet janë sporadike dhe jopërfutuese. Janë ndërmarrë disa hapa për të gjetur se çfarë mendojnë prindërit për punën e kopshtit, por mendimet dhe ankesat e tyre nuk janë marrë parasysh. Informacioni që merret nga ana e prindërve është i kufizuar. Kopshti ka zhvilluar një shkallë të kufizuar lidhjesh me kopshtet e tjera. Marrëdhëniet e punës janë pjesërisht efektive.

NIVELI 4

Mësueset janë pesimiste në punën e tyre, me moral të ulët dhe pa perspektivë. Nuk përdoren lavdërimet dhe format e tjera të inkurajimit e të motivimit. Mësueset nuk janë të ndërgjegjshme për punën e tyre. Tërësia e veprimtarive nuk përputhet me prirjet e fëmijëve. Mjediset janë të pasigurta dhe nuk ofrohen veprimtari edukative në fushën e mirëqenies dhe të sigurisë së fëmijëve. Mungon rregulli dhe pastërtia. Mjedisi i punës lë për të dëshiruar. Mësueset nuk bashkëpunojnë me prindërit për t'i informuar ata për mbarëvajtjen e fëmijëve. Kopshti nuk ka bërë përpjekje për aktivizimin e prindërve në jetën e shkollës. Nuk ka zhvilluar lidhje me bordin, kopshtet dhe institucionet e tjera.

FUSHA VII. VLERËSIMI

Vlerësimi është një nga tetë fushat e standardeve të përmbajtjes në arsimin parashkollor. Synimi i këtij standardi është që të sigurojë një vlerësim sistematik efektiv të programeve të edukimit, në përmbushjen e qëllimeve të tyre për të gjithë fëmijët, familjet dhe personelin mësimor, që të arrihet një cilësi e qëndrueshme e kujdesit dhe e edukimit. Ky standard krijon hapësira që programet të kenë mundësi të përmirësohen dhe të rinovohen”.¹⁰

Në veprimtarinë e kopshtit dallojmë disa lloje vlerësimesh: vlerësimi i progresit të fëmijëve 3-6 vjeç; vlerësimi i mësimdhënies së mësueseve, vlerësimi dhe vetëvlerësimi i arritjeve të kopshtit në të gjitha fushat.

Nënfushat:

- I. Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve;
- II. Vlerësimi i mësueses;
- III. Vetëvlerësimi i kopshtit.

I. Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç bëhet për të përcaktuar nivelin e aftësive, njohurive dhe shprehive që do të fitojnë ata në kopsht, për të bërë krahasimin se çfarë dinin të bënin në fillim të vitit shkollor dhe çfarë dinë të bëjnë në fund të tij. Në këtë mënyrë përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta jo vetëm të programit, por edhe të punës së mësueseve, të metodave dhe teknikave të edukimit, të formave të nxitjes për përvetësimin e njohurive të reja, të përfshirjes së prindërve në realizimin e programit, të mënyrës së shfrytëzimit të mjedisit fizik të brendshëm dhe të jashtëm, të vendosjes së anës figurative në funksion të programit që zbatohet etj. Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve duhet të mbështetet tërësisht te objektivat e programit sipas grupmoshave, pra fëmijët duhet të vlerësohen për realizimin e objektivave të parashikuara në program.

II. Vlerësimi i mësueses në arsimin parashkollor është një dukuri komplekse, që buron nga vetë natyra e funksionimit të arsimit parashkollor dhe për shkak të grupmoshës së fëmijëve që frekuentojnë kopshtin (3 - 6 vjeç). Duke qenë se fëmijët e kësaj grupmoshe gjatë kohës që janë në kopsht jo vetëm mësojnë, por edhe ushqehen e flenë, atëherë kuptohet rëndësia e kompleksiteti që ka vlerësimi në arsimin parashkollor. Mësuesja në arsimin parashkollor është jo vetëm mësuese e grupit që drejton, por ajo kujdeset edhe për zhvillimin shëndetësor edhe për mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve. Ajo i mëson se si të hanë, të flenë, si të kujdesen për higjienën vetjake, si të fitojnë aftësitë dhe shprehitë për jetën etj.

1. Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor, Tiranë 2002, faqe 8-9.

III. Vetëvlerësimi i kopshtit. Vetëvlerësimi i një kopshti duhet të ndërtohet sipas konceptit që kompetencat të mos përqendrohen brenda një organi apo subjekti të vetëm vlerësues, pasi kështu do të kemi një vetëvlerësim real të të gjitha aspekteve të funksionimit të një kopshti. Duhet të bëhet ndarja e përgjegjësive të vlerësimit midis gjithë aktorëve që marrin pjesë në jetën e një kopshti. Gjithmonë duhen parashikuar mekanizma monitorimi dhe vlerësimi, të brendshme dhe të jashtme.

Procesi i vetëvlerësimit duhet të orientohet nga tri parime themelore:

1. Vetëvlerësimi e ndihmon kopshtin të përmirësohet;
2. Vetëvlerësimi është i thjeshtë dhe i integruar me menazhimin e përditshëm të kopshtit;
3. Kopshti i merr parasysh pikëpamjet e të interesuarve për veprimtarinë e tij dhe reflekton me ndryshimet përkatëse.

Duke qene se vetëvlerësimi është një proces gjithëpërfshirës nuk ka një formë të përcaktuar. Kopshtet mund të zgjedhin apo të ndjekin atë model që është më i përshtatshmi për to. Nga përvoja rezulton se kopshtet më të mira në vetëvlerësim krijojnë mundësi për matjen e ecurisë praktikisht. Partneret e përmirësimit të kopshtit, si: prindërit, DAR/ZA-ja, pushteti vendor, biznesi lokal etj., luajnë rol të rëndësishëm. Ata shtrojnë pyetje, sugjerojnë burime të dhënash dhe sfidojnë interpretimet e të dhënave të kopshtit. Kopshti mund t'i aktivizojë ata si lexues kritikë të planit të punës, por jo si autorë në hartimin e tij.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve	1. Mësuesja vlerëson arritjet e fëmijëve.	1.1.1. Vlerësimi me gojë i motivon fëmijët në procesin e të nxënit.				
		1.1.2. Vlerësimi bëhet sipas udhëzimeve të MASH-it dhe DAR/ZA-së.				
		1.1.3. Mësuesja vlerëson njohuritë e fëmijëve sipas fushave të zhvillimit.				
		1.1.4. Vlerësimi shoqërohet edhe me gjeste ose me simbole vlerësuese, në përshtatje me grupmoshën e fëmijëve.				
		1.1.5. Mësuesja mbledh informacion nga prindërit për të bërë vlerësimin e arritjeve të fëmijëve.				

		1.1.6. Mësuesja përdor vëzhgimin për të vlerësuar arritjet e fëmijëve.				
		1.1.7. Mësuesja vlerëson arritjet e fëmijëve nëpërmjet vlerësimit të dosjes me punët e tyre.				
		1.1.8. Mësuesja përdor teste/ lista kontrolli të përshtatura për të vlerësuar nivelin e përvetësimit të koncepteve të reja nga fëmijët për një periudhë të caktuar.				
		1.1.9. Mësuesja përdor vlerësimin me shprehje sintetizuese, në përputhje me grupmoshën e fëmijëve.				
		1.1.10. Mësuesja argumenton vlerësimin e bërë, bazuar në standardet e arritjes.				
		1.1.11. Mësuesja, gjatë vlerësimit, përdor një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për fëmijët.				
		1.1.12. Mësuesja nuk përdor fjalë fyese ose diskriminuese.				
		1.1.13. Mësuesja vlerëson aftësitë e fëmijëve për të punuar me të tjerë.				
		1.1.14. Mësuesja vlerëson aftësitë e fëmijëve për të ndarë lodrat me të tjerët, me dëshirën e tij.				
		1.1.15. Mësuesja vlerëson aftësitë e fëmijëve për të punuar në grup.				
		1.1.16. Mësuesja vlerëson fëmijën edhe për respektimin e rregullave të grupit.				
		1.1.17. Mësuesja bën vlerësim përmblendhës të arritjeve të fëmijëve 1 herë në tre muaj.				
		1.1.18. Mësuesja bën vlerësim motivues për të nxitur interesin e fëmijëve.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Vlerësimi i mësueses	1. Mësuesja vlerësohet për të gjitha aspektet e VME-së.	2.1.1. Përgatitja ditore e mësueses (plani ditor, plani vjetor dhe mujor, regjistri, fletorja e vëzhgimit dhe vlerësimit).				
		2.1.2. Mësuesja i ka të qarta objektivat për fëmijët.				
		2.1.3. Mësuesja jep udhëzime dhe shpjegime të qarta.				

	2.1.4. Mësuesja punon në grupe të vogla me fëmijët.				
	2.1.5. Mësuesja bën përsëritje sistematike dhe vlerësim të asaj që kanë kuptuar fëmijët.				
	2.1.6. Mësuesja realizon përfshirje aktive të fëmijëve në veprimtarinë mësimore-edukative.				
	2.1.7. Mësuesja përdor lloje të ndryshme të strategjive të mësimdhënies.				
	2.1.8. Mësuesja realizon në orën e mësimit bashkëpunimin midis fëmijëve.				
	2.1.9. Mjedisi figurativ i klasës/grupit/këndit dhe i kopshti është në funksion të të mësuarit.				
	2.1.10. Prindërit informohen rregullisht për ecurinë e fëmijëve.				
	2.1.11. Mësuesit komunikojnë me prindërit dhe i përfshijnë ata në veprimtarinë mësimore-edukative.				
	2.1.12. Mësuesja krijon kushte optimale për mësim, edukim dhe argëtim përmes ndërtimit të këndeve/grupeve dhe komunikimit pozitiv.				
	2.1.13. Mësuesja zbaton plan pune të posaçëm për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara).				
	2.1.14. Mësuesja mbikëqyr në vijimësi frekuentimin e fëmijëve në kopsht.				
	2.1.15. Mësuesja respekton rregullat e etikës kur i drejton pyetje fëmijëve.				
	2.1.16. Mësuesja nuk paragjykon përgjigjet e fëmijëve.				
	2.1.17. Mësuesja bën vlerësim të paanshëm.				
	2.1.18. Mësuesja publikon në vende të dukshme punimet e fëmijëve.				
	2.1.19. Mësuesja përdor teknika që fëmijët të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin.				
	2.1.20. Mësuesja punon vazhdimisht për nxitjen e aftësive dhe dhuntive krijuese të fëmijëve.				

		2.1.21. Mësuesja nxit aftësitë komunikuese të fëmijëve dhe ato që lidhen me gjuhën e folur.				
		2.1.22. Mësuesja realizon përfshirjen aktive të fëmijëve në mësim.				
		2.1.23. Mësuesja shfrytëzon mjedisin fizik të jashtëm dhe të brendshëm.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Vlerësimi i kopshtit	1. Kopshti realizon vetëvlerësimin.	3.1.1. Kopshti kryen vazhdimisht vetëvlerësimin.				
		3.1.2. Kopshti përdor për vetëvlerësim të njëjtat fusha apo instrumente që përdor edhe IKAP-i.				
		3.1.3. Kopshti bën vetëvlerësimin vjetor për 2-3 fusha që lidhen ngushtë me objektivat vjetorë, të vendosur në planin vjetor.				
		3.1.4. Secila nga mësueset e kopshtit përdor vetëvlerësimin e punës së saj, duke iu referuar disa pikave standarde.				
		3.1.5. Kopshti përgatit çdo vit raportin e vetëvlerësimit, duke përdorur një format të përcaktuar.				
		3.1.6. Në procesin e vetëvlerësimit është i përfshirë jo vetëm stafi pedagogjik, por edhe ai ndihmës.				
		3.1.7. Përvojat e suksesshme identifikohen gjatë dokumentimit të procesit të vetëvlerësimit.				
		3.1.8. Vetëvlerësimi është bërë në mënyrë të hapur, të ndershme dhe të sinqertë.				
		3.1.9. Informacioni i mbledhur nga procesi i vetëvlerësimit është real.				
		3.1.10. Në procesin e vetëvlerësimit janë marrë parasysh sugjerimet e prindërve, qeverisjes vendore dhe të të interesuarve të tjerë.				

		3.1.11. Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të vetëvlerësimit paraqesin realisht gjendjen dhe problemet e kopshtit.				
		3.1.12. Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të vetëvlerësimit përputhen me vlerësimin e bërë nga IKAP-i dhe DAR/ZA-ja.				
		3.1.13. Raporti i vetëvlerësimit ruhet për 1-2 vjet, aq sa ruhet edhe plani vjetor i tij.				
		3.1.14. Raporti i vetëvlerësimit dërgohet në DAR/ZA.				

STANDARDI

Mësuesja e kopshtit ka një plan të saktë për vlerësimin e fëmijëve, të cilin ua bën të njohur edhe prindërve. Vlerësimi bëhet vazhdimisht dhe përdoret vetëm si një mjet nxitjeje për të rritur nivelin e përvetësimit të njohurive të reja nga ana e fëmijëve. Mësuesja e kopshtit bën vlerësim të argumentuar me gojë, duke përdorur shprehje sintetizuese dhe nxitëse. Vlerësimi vë në dukje anët pozitive të fëmijës. Shprehjet e vlerësimit janë të qarta dhe të kuptueshme, pa fjalë fyese apo diskriminuese. Gjatë veprimtarisë mësimore-edukative, mësuesja e kopshtit vlerëson të gjitha veprimtaritë e fëmijës, si ato individuale dhe ato të punës në grup me fëmijët e tjerë. Mësuesja e kopshtit bën përpjekje për të nxitur vetëvlerësimin e fëmijëve, duke përdorur strategji të ndryshme. Kopshti bën herë pas here vetëvlerësimin e gjithë aspekteve të veprimtarisë së tij.

NIVELI 1

Mësuesja e kopshtit i ka të qartë dhe të matshëm objektivat dhe fushat me të cilat do të vlerësojë fëmijët. Ajo mban shënime gjatë procesit të vëzhgimit të veprimtarisë mësimore-edukative të fëmijëve, të cilat i përdor gjatë vlerësimeve që kryen. Vlerësimi përdoret vetëm si një mjet për nxitjen e fëmijëve në rritjen e rezultateve në vazhdimësi. Vlerësimi është i paanshëm, nuk paragjykon arritjet e fëmijëve dhe nxjerr në pah anët pozitive të tij. Mësuesja e kopshtit nxit vetëvlerësimin midis fëmijëve. Gjithashu, mësuesja e kopshtit përdor edhe figurat me simbole vlerësuese për vlerësimin e fëmijëve. Prindërit e fëmijëve informohen rregullisht për rezultatet e fëmijëve dhe për mënyrat e përdorura për vlerësimin e tyre. Kopshti kryen rregullisht vetëvlerësimin e veprimtarisë së tij.

NIVELI 2

Mësuesja e kopshtit ka objektiva të qartë për vlerësimin e fëmijëve. Ajo mban shënime të sakta për vlerësimin e fëmijëve sipas fushave të zhvillimit. Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve përdoret për të nxitur fëmijët për përvetësimin e njohurive të reja. Mësuesja e kopshtit përdor edhe vlerësimin me gojë, edhe vlerësimin me shprehje sintetizuese ose me simbole vlerësuese. Mësuesja nxit edhe vetëvlerësimin midis fëmijëve për punët e tyre individuale ose në grup, duke nxjerrë në pah anët pozitive të fëmijës. Prindërit e fëmijëve kanë dijeni për rezultatet e fëmijëve të tyre. Vlerësimi është i paanshëm dhe joparagjykes. Shprehjet e përdorura nga mësuesja për vlerësimin janë të qarta dhe të kuptueshme për fëmijët. Kopshti kryen vetëvlerësimin e veprimtarisë së tij.

NIVELI 3

Mësuesja e kopshtit e ka të qartë vlerësimin që do të bëjë, sipas fushave të zhvillimit. Ajo mban shënime, jo në mënyrë ritmike, gjatë vëzhgimit të fëmijës. Mësuesja e kopshtit përdor të gjitha llojet e vlerësimit: me gojë, me vendosjen e simboleve vlerësuese apo vetëvlerësimin e fëmijëve, por nuk bën gjithmonë argumentimin e tij. Në shumicën e herëve, vlerësimi i përdorur nga mësuesja nxjerr në pah më shumë mangësitë e fëmijë se sa anët pozitive të tij. Në disa raste, vlerësimi shërben si mjet presioni e diskriminimi. Prindërit e fëmijëve janë njohur me arritjet e fëmijëve të tyre, por nuk janë të qartë për mënyrën se si është kryer vlerësimi. Kopshti kryen ndonjëherë vetëvlerësimin e veprimtarisë së tij.

NIVELI 4

Mësuesja e kopshtit nuk ka një program të qartë vlerësimi, por shpeshherë e bën atë në mënyrë të rastësishme. Përdor të gjitha llojet e vlerësimit, por pa e argumentuar atë. Mësuesja e kopshtit paragjykon arritjet e fëmijëve duke krijuar paqartësi tek ata dhe prindërit e tyre. Vlerësimet e mësueses nuk janë të rregullta. Ajo nuk mban shënime për vëzhgimet e kryera gjatë veprimtarisë mësimore-edukative. Prindërit e fëmijëve nuk janë të informuar për vlerësimet e rezultateve të fëmijëve të tyre; kanë dijeni për rezultatet e fëmijëve, por nuk janë të qartë për mënyrën e vlerësimit. Vlerësimet nuk janë ritmike, por sporadike dhe të pamotivuara. Kopshti kryen rrallë vetëvlerësimin e veprimtarisë së tij.

FJALORTH

Aftësi psiko-motore nënkupton kryerjen e një aftësie fizike me anë të dorës, këmbës etj.

Analiza SWOT nënkupton përcaktimin e 4 elementeve: pikat e forta të kopshtit; pikat e dobëta të kopshtit; mundësitë për ndryshimin e gjendjes dhe rreziqet që mund të hasen.

Arritje nënkupton se çfarë njohuri duhet të fitojnë fëmijët gjatë periudhës së kopshtit.

Bashkëveprimi është procesi i personave që i përgjigjen njëri-tjetrit.

DAR-i është Drejtoria Arsimore Rajonale.

Fëmijë me nevoja të veçanta nënkupton fëmijën që ka vështirësi fizike, mendore, emocionale ose vështirësi të tjera.

Fëmijë me prirje të veçanta nënkupton fëmijët që kanë rezultate të larta në fusha të ndryshme.

Fusha emocionale përfshin sjellje, besime dhe vlera.

Fusha njohëse nënkupton një proces mendor; dija ose mbajtja e informacionit; gjykimet ose vlerësimet.

Fusha psiko-motore nënkupton një prej tri kategorive mësimore që i referohet ndjeshmërisë dhe lëvizshmërisë, pra aspekteve të të mësuarit.

Grupe interesi nënkupton të gjitha subjektet e interesuara dhe që kontribuojnë me qëllim që kopshti të jetë cilësor.

Grupet e interesit nënkupton të gjitha subjektet e interesuara që kontribuojnë në zhvillimin e kopshtit.

KDF-ja është Konventa e të Drejtave të Fëmijëve.

Komunitet i kopshtit nënkupton grupe njerëzish që jetojnë në një zonë të caktuar dhe lidhen nga interesa e qëllime të përbashkëta për zhvillimin e arsimit në zonën e tyre.

Komuniteti i prindërve nënkupton jo vetëm prindërit që kanë fëmijët në kopsht, por edhe prindërit e tjerë që jetojnë rreth e rrotull kopshtit dhe janë të interesuar për jetën dhe veprimtarinë e tij.

Konfidencialiteti nënkupton diçka që mbahet e fshehtë dhe nuk u tregohet të tjerëve; diçka që duhet ta dinë vetëm disa njerëz të caktuar e të ngarkuar për një punë.

Kualifikimi nënkupton shkallën e përgatitjes shkencore e profesionale të mësuesve.

Menazhimi nënkupton aftësinë për të organizuar.

Menazhimi i kopshtit nënkupton aftësinë për të organizuar dhe kontrolluar jetën dhe aktivitetet e kopshtit.

Metoda e të mësuarit me projekt nënkupton metodën mësimore të drejtuar ose të kontrolluar nga vetë nxënësit. Metoda përqendrohet në përbushjen e një detyre, e cila kërkon që nxënësi të përdorë e të zbatojë njohuritë dhe shprehitë e fituara gjatë procesit mësimor në situata të reja ose të ndryshme.

Metoda të mësimdhënies nënkuptojnë tërësinë e mënyrave dhe rrugëve, të planifikuara nga mësuesi, për të transmetuar njohuri.

Miniprojekti ose projekti përfshin aktivitete të veçanta me qëllim realizmin e objektivave të caktuara dhe përforcimin e njohurive të fituara.

Mjedisi fizik nënkupton tërësinë e kushteve fizike që krijojnë një atmosferë të përshtatshme për ecurinë e procesit mësimor.

Mjetet didaktike nënkuptojnë tërësinë e mjeteve që përdor mësuesja në funksion të lehtësimit të procesit të përvetësimit të njohurive të reja.

Ndërveprim nënkupton metodën mësimore me të cilën mësuesja dhe fëmijët bisedojnë, veprojnë dhe bashkëpunojnë për të nxënë nga njëri- tjetri.

Plan ditar nënkupton disa shënime të renditura në radhë logjike, të cilat duhet të ndiqen nga mësuesja dhe që sigurojnë arritjen e objektivave nga fëmijët.

Planifikimi nënkupton përcaktimin sistematik të mënyrës, me të cilën do të arrihen objektiva të caktuar.

Prioritete janë pikat të cilat zgjidhen si përparësi, pasi është bërë analiza.

Programi mësimor është dokumenti ku paraqitet përmbajtja e fushës dhe mënyra si realizohet ajo. Në të përcaktohen qëllimet, objektivat, konceptet dhe linjat kurrikulare.

Punë në grup nënkupton bashkëpunimin midis drejtueses, stafit pedagogjik, stafit ndihmës dhe prindërve.

Simbole vlerësuese nënkupton një grup shenjash që përdoren si mjet vlerësimi të tilla, si: ☺;etj.

Standard arritjeje nënkupton nivelin e përbushjes së standardeve të përmbajtjes nga fëmijët.

Standard përmbajtjeje nënkupton nivelin e njohurive, aftësive e shprehive të fëmijëve sipas fushave.

Standarde nënkupton nivele të matshme që duhen arrirë nga fëmijët në kopsht.

Veprimtaria mësimore-edukative është tërësia e veprimtarisë që zhvillohet në kopsht për të siguruar mirëqënien fizike, emocionale, psikologjike të fëmijës dhe njëkohësisht siguron zhvillimin njohës të fëmijës.

Vetëvlerësimi nënkupton një proces gjatë të cilit kopshti (individit: mësuesja, fëmija etj.) rishikon punën e tij, me qëllim përmirësimin në të ardhmen.

Vëzhgim i veprimtarisë mësimore-edukative nënkupton gjykimin e vlerave të diçkaje për një qëllim të

dhënë, duke përdorur kritere të caktuara.

Vlerësimi është procesi gjatë të cilit përcaktohen vlerat mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga procesi i matjeve. Elementi kryesor i vlerësimit është gjykimi, i cili e dallon nga matja. Që vlerësimi të jetë i vërtetë, duhet të bazohet në matjet e sakta dhe të besueshme.

ZA-ja është Zyra Arsimore.

BIBLIOGRAFIA

- Administrimi dhe Menazhimi i Arsimit, Tiranë, 2003.
- Anne Alitolppa-Nitamo & Mohamed Moallin, “*Roli i prindërve në edukimin e fëmijës*”, Vaestoliiton Kotipuu, Finlandë.
- Edukimi parashkollor, Tiranë, 2003.
- Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, Tiranë, 1992 (Viti i ratifikimit nga Shqipëria).
- Ligji Nr. 7776, datë 22.12.1993, ndryshuar në Ligjin Nr. 8399, datë 09.09.1998, “Për buxhetin Lokal”.
- Ligji Nr.8379, datë 29.07.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”.
- MASH & Save the Children, *Manual inspektimi i plotë i shkollës*, Tiranë, 2005.
- MASH, Programet mësimore për grupmoshat 3-4, 4-5, 5-6 vjeç, Tiranë, 2003-2004.
- MASH., Udhëzimi Nr.26, datë 07.09.2007.
- MASH, Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010.
- Mato, E., Kamani, P., “*Në kërkim të njohjes*”, Tiranë, 2000.
- Mato, E., Sina, E., “*Gati për në shkollë*” (5-6 vjeçarët) udhëzues për klasat përgatitore, Tiranë, 2008.
- Plani afatmesëm i shkollës, Tiranë, 2007.
- Rregullorja higjieno-sanitare për “*Ndërtimin dhe funksionimin e kopshteve të fëmijëve*”.
- Standardet e arritjes për arsimin parashkollor, Tiranë, 2002.
- Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor, Tiranë, 2001.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2005-2015, Tiranë, 2005.
- UNICEF, “*Manual në ndihmë të psikologut në shkollë*”, Tiranë, 2006.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 204, datë 26.03.1998, “*Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal*”.
- Vendimi Nr. 204 i Këshillit të Ministrave, datë 09.07.1998, “*Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal*”.

NË VEND TË MBYLLJES....

Udhëzuesi “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit” ka si qëllim të ndihmojë mësueset dhe drejtueset e kopshteve për të zbatuar sa më mirë kurrikulën me të gjithë elementet e saj, sipas standardeve zyrtare të përmbajtjes dhe të arritjes, por dhe të mbështesë një bashkëpunim dhe menazhim të frytshëm të institucionit-kopsht, duke përfshirë në këtë proces të gjithë stafin e tij.

Në qendër të vëmendjes ky botim ka gjithnjë fëmijën, kujdesin për të, por në mënyrë të veçantë mirërritjen dhe edukimin e tij në një mjedis fizik, social dhe psikologjik të përshtatshëm, gjë e cila i jep krenari dhe identitet një kopshti.

Si institucioni përgjegjës i inspektimit, IKAP-i do ta përdorë këtë botim si një material që, së pari do të nxitë, do të përmirësojë dhe do të sigurojë një shërbim cilësor të kopshtit dhe asnjëherë për qëllime të mirëfillta kontrolli apo keqdashëse.

Në udhëzues gjenden shumë tregues dhe instrumente. Asnjëherë ato nuk mund të përdoren të gjitha në një kohë. Vlera e tyre parësore është që secila mësuese apo drejtuese kopshti t’i lexojë dhe të identifikojë se ku është me përmbushjen e tyre, në mënyrë që të përmirësojë dhe të përsosë më tej aftësitë dhe kompetencat profesionale si mësuese dhe drejtuese.

Çdo kopsht i përdor këta tregues dhe instrumente sipas objektivave të tij afatgjatë dhe vjetorë, për të bërë vetëvlerësime dhe verifikime se në ç’ gjendje është, duke përcaktuar edhe rrugët për përmirësimin e tij në të ardhmen.

Ndërkaq, IKAP-i do të përpiqet sa më shumë të instalojë në çdo kopsht kulturën e vetëvlerësimit, në mënyrë që të rrisë dhe të përmirësojë në vijimësi cilësinë e shërbimit arsimor që kopshti ofron.

Kopshti mund të marrë në konsideratë të paktën, dy fusha dhe tregues të tyre që lidhen ngushtë me synimet dhe objektivat e tij, për t’i patur objekt të vetëvlerësimit gjatë një viti mësimor.

Kjo është një rrugë sfiduese, por që kërkon pasion, përkushtim në mënyrë që ju mësuese dhe drejtuese ta ktheni kopshtin tuaj në një mjedis realisht profesional, ku fëmijët zhvillohen, ndihen mirë dhe janë të gatshëm për të vijuar të motivuar dhe me dëshirë shkollën.

Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit/ Autorë: Pranvera Kamani, Robert Gjedia etj.; red. shkenc. Majlinda Xhamo - Tiranë:
Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, 2011
95f; 21x21cm. - (Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar)
Shtypur në shtypshkronjën KRISTALINA - KH